

BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, FETARE, SHKENCORE
vëllimi 9, nr. 2

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL
volume 9, no. 2 / 2025

Të gjitha temat e botuara në “Buletin” janë të skanuara me programin
Inspera originality, dhe nuk janë konstatuar plagjiat.

Baza e të dhënave dhe indekset ku skanohet revista:



Boton: **Fakulteti i Studimeve Islame**

Dekani

Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani

Redaktor përgjegjës

Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma

Redaksia

Dr. Ajni Sinani

Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati

Prof. Dr. Fahrush Rexhepi

Prof. Ass. Dr. Zija Abdullahu

Prof. Ass. Dr. Musa Vila

Këshilli redaktues ndërkombëtar

1. Prof. Asoc. Dr. Diane Chapman, North Carolina State University, USA.
2. Prof. dr. Elez Osmani, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri.
3. Prof. Ass. Dr. Feim Gashi, Kırklareli University, Turkey.
4. Prof. Asoc. Dr. Muhamed Ali, University of Sharjah, United Arab Emirates.
5. Prof. Ass. Dr. Jashar Sherif, University of Thessalonik, Greek.
6. Prof. Ass. Dr. Hajrudin Hodžić, Faculty of Pedagogy in Bihać, Bosnia and Herzegovina.
7. Prof. Asoc. Dr. Ziber Lata, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, Maqedonia e Veriut.
8. Dr. Eduard Caka, studiues nga Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
9. Dr. Behlul Kanaqi, profesor në Medresenë “Mehmed Fatih” - Mali i Zi.
10. Prof. Asoc. Dr. Khalif Muammar A. Harris, Faculty of Social Sciences and Humanities Universiti Teknologi Malaysia.

Sekretar i redaksisë

Mr. Vedat Shabani

Redaktor gjuhësor

Prof. Dr. Ferid Selimi

Redaktor teknik dhe ballina

Nuhi Simnica

Shtypi

“Printing press”- Prishtinë

Adresa

@ Fakulteti i Studimeve Islame

Rr. Bajram Kelmendi Nr.174, P.O.Box.10000, Prishtinë

Tel dhe Fax: 038-243-887

www.buletini.net www.fsi-edu.net buletini@info.net facebook.com/buletiniFSI
p-ISSN 3007-3677 e-ISSN 3078-7467 CEOOL



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, FETARE, SHKENCORE
vëllimi 9, nr. 2

SCIENTIFIC RELIGIOUS JOURNAL
volume 9, no. 2 / 2025

p-ISSN 3007-3677

e-ISSN 3078-7467



KDU 28(05)

Prishtinë
2025

Përmbajtja

EDITORIALI	7
Urtësia, gjuha dhe thirrja: Vështrime Islame mbi trashëgiminë shpirtërore dhe intelektuale shqiptare	9
ARTIKUJT	21
Sprova e njeriut dhe objektivat e saj sipas Kuranit fisnik <i>Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati</i>	23
Umeri r.a., model strategjik për misionin dhe strategjinë e thirrjes islame në një shoqëri të drejtë dhe tolerante (583-644) <i>Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma</i>	35
Dy fjalë rreth metodologjisë së identifikimit të saktësisë së hadithit <i>Dr. Behlul Kanaqi</i>	61
Komentimi i Kuranit nga Hafiz Ali Korça <i>Dr. Azmir Jusufi</i>	73
Myftiu në Malin e Zi me seli në Podgoricë (1887-1912) sipas dokumenteve arkivore <i>Mr. Ali Bardhi</i>	89
Kontributi i Daut Efendi Boriçit për Gjuhën Shqipe <i>Ademir Xama</i>	103
KRONIKË	115
Aktivitete e Fakultetit të Studimeve Islame <i>Mr. Vedat Shabani</i>	117

EDITORIALI

Urtësia, gjuha dhe thirrja: Vështrime Islame mbi trashëgiminë shpirtërore dhe intelektuale shqiptare

Në historinë e shqiptarëve, Islami nuk ishte as është thjesht një besim fetar, por një sistem vlerash, që ka formësuar jetën shpirtërore, institucionale dhe kulturore të shoqërisë. Nga periudha osmane e deri në Rilindjen Kombëtare dhe më tej, dijetarët myslimanë shqiptarë kanë dhënë kontribute të çmuara në zhvillimin e mendimit, gjuhës, arsimimit dhe ndërgjegjësimit kolektiv.

Ky editorial shqyrton ndikimin e trashëgimisë islame në formimin e identitetit shpirtëror dhe intelektual të shqiptarëve, duke theksuar rolin e dijetarëve, institucioneve fetare dhe të literaturës islame në ndërtimin e një vetëdije të thellë kulturore. Nëpërmjet një analize historike dhe konceptuale, trajtohen elementet përbërëse të kësaj trashëgimie dhe rëndësia e saj në sfidat bashkëkohore.

Trashëgimia islame në trojet shqiptare përfaqëson një ndërthurje të pasur mes besimit fetar dhe ndërgjegjës kombëtare. Ajo nuk ishte vetëm një sistem besimi, por një bosht rreth të cilit është formuar mendimi, arsimi dhe vetëdija qytetare. Dijetarët shqiptarë myslimanë ishin bartës të dijes dhe të identitetit tonë, qoftë fetar apo kombëtar. Figurat si: Hoxha Tahsini, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Daut Boriçi, etj., luajtën rol qendror në ndërlidhjen e dijes fetare me edukimin dhe vetëdijen kombëtare. Ata shkruan në shqip, interpretuan tekstet klasike dhe përgatitën breza të rinj në frymën e vlerave islame dhe përgjegjësisë kombëtare. Këta dijetarë nuk ishin vetëm teologë, por edhe pedagogë, publicistë dhe përkthyes, duke kontribuar në një rilindje islame me karakter kombëtar.

Nga ana tjetër Institucionet Islame, si qendra të trashëgimisë, Myftinitë, Medresetë dhe xhamitë nuk ishin vetëm vende adhurimi, por qendra të edukimit dhe të dijes. Ato përçonin jo vetëm tekstet fetare, por edhe një kulturë dialogu, morali dhe disipline. Gjatë periudhave të represionit politik, këto institucione luajtën rol mbrojtës për identitetin fetar dhe ruajtjen e traditës orale dhe të shkruar.

Në këtë kahje të zhvillimit, vlen të theksohet roli që pati edhe literatura e përkthyer në shqip, ku veçohet përkthimi i Kuranit, i haditheve dhe i literaturës klasike islame. Kjo literaturë klasike islame në gjuhën shqipe nuk ishte thjesht akt gjuhësor, por një proces përfshirës që i dha besimtarëve shqiptarë qasje të drejtpërdrejtë në tekstin burimor. Ky proces e lidhi popullin me burimet e shenjta në mënyrë të ndërgjegjshme dhe një karakter unik, islamit shqiptar. Trashëgimia jonë ka krijuar platformë stabile për të ardhmen. Në një botë gjithnjë e më të sekularizuar dhe të globalizuar, vlera e trashëgimisë islame qëndron në aftësinë e saj për të ofruar stabilitet etik, orientim shpirtëror dhe qëndrueshmëri kulturore. Rindërtimi i lidhjes me këtë trashëgimi kërkon një qasje të re pedagogjike dhe një interpretim bashkëkohor, që e mban të gjallë thelbin pa e ngurtësuar formën. Po aq domethënës është rasti i Hafiz Ali Korçës (1873-1956), i cili me komentimin e tij të Kuranit, solli një qasje të re në interpretim: më afër nevojave të kohës, më e kuptueshme për lexuesin shqiptar dhe pa devijuar nga thelbi i mesazhit hyjnor. Ai përpiqej ta bënte Kuranin të afërt me jetën e përditshme, duke e kthyer në një mual jete për besimtarin shqiptar. Vepra e tij “Tefsiri i Kuranit” është ndër të paktat tefsire të plota në gjuhën shqipe.

Nga historia jonë islame, me virtyt të Urtësisë, kemi modelin e drejtësisë dhe të strategjisë islame, Halifin i dytë të Islamit, Umer ibn el-Hattab r.a., që përfaqëson një kulm të urtësisë politike dhe shpirtërore. Ai ndërtoi një model drejtësie të bazuar mbi barazi, transparencë dhe ndjeshmëri shoqërore, duke qenë gjithashtu strateg i zgjuar në përhapjen e

Islamit nëpër territore të ndryshme. Ndër vendimet e tij më të spikatura ishin:

- Ndarja administrative e provincave;
- Vendosja e sistemit të taksave;
- Ndërtimi i infrastrukturës publike; dhe
- Kujdesi për jomuslimanët brenda shtetit islam;

Kjo urtësi strategjike nuk kishte për qëllim pushtetin, por shërbimin ndaj Zotit dhe njerëzve.

Ai gjithashtu krijoi sistemin e regjistrimit civil. Vendosi rrogat për nëpunësit publik dhe forcoi sistemin e qeverisjes së decentralizuar. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i urtësisë së tij ishte ndjeshmëria sociale: Umeri shpesh dilte natën për të parë gjendjen e qytetarëve dhe ndihmonte personalisht të varfrit. Në këtë kuptim, urtësia nuk ishte vetëm teorike, por jetësore dhe vepruese.

Ky model ndikoi edhe më vonë në qasjen e dijetarëve shqiptarë, që në rrethana koloniale, nacionaliste ose komuniste, u përpoqën të ruanin esencën e drejtësisë islame.

Urtësia e Halifit Umer është reflektuar në figura të tilla, që nuk u dorëzuan përballë presioneve kohore, por e ruajtën zërin e së vërtetës dhe u angazhuan për të mbrojtur të drejtën, edukimin dhe përhapjen e fesë.

Në rrafshin kombëtar, në mes të shumë figurave, që lanë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin dhe ngritjen e identitetit gjuhësor, ishte Daut Efendi Boriçi (1825-1896) që ishte një prej figurave qendrore në përpjekjet për të institucionalizuar gjuhën shqipe, në një kohë kur ndalimi i saj zyrtar kishte për qëllim ta zbriste popullin shqiptar në injorancë. I formuar në Shkollën e Lartë të Stambollit dhe i frymëzuar nga parimet islame të dijes, ai e pa gjuhën si mjet të domosdoshëm për të përhapur njohjen e fesë dhe kulturës. Boriçi zhvilloi një përpjekje të gjerë për ta bërë shqipen gjuhë të shkollës dhe të administratës, duke qenë gjithashtu pjesëmarrës aktiv në Kongresin e Manastirit. Ai shkroi tekste edukative dhe zhvilloi një qasje pedagogjike, që ndërthurte parimet e dijes islame me përparimin kombëtar. Në këtë mënyrë, ai u bë shembull i atij, që

mund të quhet një “dijetar rilindës”, që bashkoi mendimin fetar me nevojat arsimore dhe gjuhësore të kohës. Kuptimi i gjuhës si akt fetar nuk ishte i panjohur në traditën islame: Imam Shafi’u ka theksuar rëndësinë e njohjes së gjuhës për kuptimin korrekt të Kuranit. Për Daut Boriçin, shqipja ishte një urë për të afruar shqiptarët me fenë dhe një mjet për të shpëtuar një popull nga asimilimi.

Ligjërimi islam në trojet shqiptare ishte i institucionalizuar. Thirrja islame (da’ve) në trojet shqiptare nuk u bë në mënyrë spontane, por u institucionalizua. Një shembull domethënës është Myftinia në Malin e Zi me seli në Podgoricë (1887-1912), e cila sipas dokumenteve arkivore kishte rol aktiv në ruajtjen e jetës fetare në një kontekst të vështirë politik. Kjo myftini ndihmonte në emërimin e imamëve, kontrollin e mësimdhënies fetare dhe ruajtjen e lidhjes shpirtërore me qendrat osmane. Përveç kësaj, myftinia kishte një rol edukativ dhe moral, duke shpërndarë libra, duke organizuar ligjërata publike dhe duke mbështetur imamët e zonave të largëta. Ajo ishte një strukturë, që ruante autonominë shpirtërore të komunitetit mysliman shqiptar në Mal të Zi, në një kohë sfiduese.

Sprova e njeriut dhe metodologjia e hadithit

Në qendër të përpjekjes intelektuale islame qëndron sprova si koncept: çdo njeri kalon nëpër sfida, që kanë për qëllim ta testojnë në bindjen dhe moralin e tij. Kjo sprova lidhet ngushtë me njohjen e dijes së saktë. Pikërisht këtu hyn në lojë metodologjia e hadithit, një sistem rigoroz, që verifikon zinxhirin e transmetuesve (isnad) dhe përmbajtjen (matn). Dijetarët myslimanë, përfshirë edhe ata shqiptarë, janë përpjekur që përmes shkencës së *mustalah al-hadith* të garantojnë, që çdo thënie e Profetit të jetë e dokumentuar dhe e saktë. Kjo përpjekje nuk ishte thjesht teknike, por thellësisht etike dhe shpirtërore, pasi mbrojtja e hadithit do të thoshte mbrojtje e vetë fesë. Në këtë kontekst, shumë dijetarë shqiptarë kanë shkruar vepra apo kanë përkthyer literaturë të rëndësishme hadithore në shqip, me qëllim që masa të ketë akses në dije të pastër

dhe të bazuar në burime autentike. Kjo ndërlidhet me konceptin kuranor se sprovat shërbejnë për të dalluar të drejtën nga e gabuara. “*Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoji durimtarët. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: “Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm te Ai kthehem!” Të tillët janë ata që kanë bekime prej Zotit të tyre dhe mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit.* (El-Bekare, 155-157).

Trashëgimia islame në trevat shqiptare është më shumë se një strukturë rituale.

Ajo është një univers vlerash që përfshin urtësinë e udhëheqësve si Umeri;

Pasionin për gjuhën dhe identitetin kombëtar të rilindësve si Boriçi;

Qartësinë metodologjike të hafëzëve si Ali Korça; dhe

Seriozitetin institucional të myftinive në kontekste të vështira.

Kjo trashëgimi meriton jo vetëm ruajtje, por edhe rilindje intelektuale. Duhet që brezat e rinj të frymëzohen nga modelet e dijes dhe karakterit, që këta burra përfaqësonin. Në kohën kur identitetet rrezikohen nga globalizimi i zbrazët, kthimi te urtësia, gjuha dhe thirrja – siç i koncepton Islami – mund të shërbejë si një platformë për rigjallërimin moral dhe kombëtar. Rigjallërimi i kësaj trashëgimie kërkon përkthim bashkëkohor të urtësisë të së kaluarës në gjuhën e realitetit të sotëm. Kjo përfshin reformim të edukimit fetar dhe ndërthurje të dijes klasike me teknologjinë dhe hapje të dialogut me kulturat e tjera, duke ruajtur thelbin islam të dijes, gjuhës dhe thirrjes.

Ky numër i Revistës përfshin 6 artikuj kërkimorë. Punimi i parë është i Prof. Ass.Dr. Lulzim Esati me titull “*Sprova e njeriut dhe objektivat e saj sipas kuranit fisnik*” ku autori analizon sprovat që janë një ligj hyjnor e që përfshin çdo njeri dhe nuk janë të rastësishme apo pa qëllim.

Ato përmbajnë urtësinë e Zotit dhe përcaktimin e Tij në univers, jetë dhe histori, duke ndjekur veprimet e njeriut. Këto sprova janë të vazhdueshme, të përgjithshme dhe të qëndrueshme. Ato nuk janë gjithmonë një formë ndëshkimi apo poshtërimi, por një test nga Zoti për njeriun e që për objektivat ka pastrimin, edukimin dhe fuqizimin e tij në tokë. Edhe psikologët janë të mendimit se; kalimi i njeriut nëpër periudha të vështira sjell përfitime befasuese. Pas kohëve të vështira, shumë njerëz përjetojnë rritje psikologjike pozitive. Këtë, psikologët e quajnë "Fenomeni i Feniksit". Ky studim synon të nxjerrë, objektivat kryesore të sprovës së njeriut, duke u referuar ajeteve fisnike të Kuranit. Në fund të këtij punimi, autori konkludon se ligji i i sprovës është mbuluar me drejtësinë hyjnore nga Krijuesi i plotfuqishëm, duke mos përjashtuar as kënd nga ky test. E mira e saj është se ajo godet sipas forcës së besimit. Sa do që neve na duken të dëmshme sprovat, ato sjellin përfitime të mëdha. I mprehin shkathtësitë e besimtarit, forcojnë moralin e tij, dhe afrojnë atë me Krijuesin e tij. Pra, sipas Kuranit fisnik, këto janë objektivat parësore të sprovës. Për këtë dëshmon edhe fjala e Allahut xh.xh: *Thuaj: "Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na ka caktuar Allahu; Ai është ndihmëtar ynë". Prandaj, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët. (Et-Tevbe, 51).* Arsyeya është, fjala: (لَنَا - për ne), është përdorur në vendë të fjalës: (عَلَيْنَا- mbi ne). Që do të thotë se këto sprova nuk janë ngarkesë mbi ne, siç mendojmë ne, por janë për të mirën tonë. Pra, për ne! E kjo e dhënë se sprovat janë për të mirën e njeriut, po vërtetohet edhe nga psikologët bashkëkohorë dhe nga ekspertët e edukimit.

Në vijim Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma sjell artikullin "*Halifi Umer r.a., si model për strategjinë e thirrjes islame në një shoqëri të drejtë dhe tolerante*" ku vihet në pah analiza për kontributin e Omerit r.a. në shërbim të thirrjes islame, duke shqyrtuar impaktin e tij në ngritjen dhe forcimin e institucione shtetërore si dhe përhapjen e islamit në territore të reja, duke synuar avancimin dhe komunikimin e vlerave etike dhe sociale të vetë islamit. Aktiviteti i tij si reformator administrativ, lider e thirrës (*da'i*) mbetet mostër për thirrjen islame në çdo kohë dhe kontekst. Nën

drejtimin e tij, Islami njohu një shtrirje të gjerë, ku fuqizimi i thirrjes islame ishte në fokusin qendër të të gjitha politikave të Omerit, r.a. Mësimet dhe shembulli i tij ende vazhdojnë të mbeten frymëzim për udhëheqësit dhe thirrësit në të gjithë botën islame, duke përkujtuar ata për peshën dhe vlerën e drejtësisë së njëmend, modestinë dhe përkushtimin e devotshmërinë ndaj Krijuesit fuqiplotë. Ky artikull shkencor analizon dhe sjell aspekte kyçe të aktivitetit të tij, duke u mbështetur në burime historike dhe shkencore. Vlen të theksohet që, periudha e halifatit të drejtë (*hulefai rashidijn*) zgjati nga viti (11 h. - 40 h.), dhe përgjatë kësaj periudhe, metodologjia dhe metoda në thirrjen islame shënonte një kontinuitet të asaj pejgamberike. Kjo metodologji stabilizoi parimet e saj të ndërtuara në metodologjinë kuranore, e cila kishte përcaktuar metodologjinë e thirrjes dhe qasjen ndaj të thirrurve, pavarësisht kategorive të tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se, ai përdori autoritetin e tij politik, shoqëror dhe fetar për të afirmuar aktivitetet e thirrjes islame (da'va). Për të parë peshën dhe rëndësinë e tij në kuadër të vlerave dhe thirrjes islame, e kuptojmë më së miri nga hadithi, që e ka thënë Muhamedi a.s e që transmetohet nga Ukbe b. Amir. "Nëse do të kishte një pejgamber pas mej e, ai do të ishte Umer b. El Hatab. Roli i Umer ibn el-Hattabit në përhapjen dhe përforcimin e thirrjes islame ishte gjithëpërfshirës. Ai përdori urtësinë, drejtësinë dhe përkushtimin për të ndërtuar një shtet të forte, që siguronte mësimin dhe përhapjen e Islamit. Reformat dhe organizimet e Umerit r.a. pasqyrojnë një metodologji gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të thirrjes islame, duke dëshmuar përkushtimin e tij ndaj zhvillimit të fesë dhe forcimit të strukturave të shoqërisë islame. Veprimtaria e tij si reformator, udhëheqës dhe thirrës mbetet model për da've në çdo kohë dhe kontekst.

Punimi i tretë me titull "Dy fjalë rreth metodologjisë së identifikimit të saktësisë së hadithit" nga autori Dr. Behlul Kanaqi, shpalos dhe hedh dritë mbi burimin e dytë të islamit, hadithin dhe metodologjinë e identifikimit të saktësisë së hadithit. Me ardhjen e revelatës, jeta e Pejgamberit

a.s., ndryshoi, duke marrë një kuptim tjetër. Ai tashmë ishte ngarkuar me detyrën e thirrjes në fenë islame. Si i tillë çdo gjë që vepronte apo thoshte, përbënte një rëndësi të veçantë për sahabët. Ata bënë kujdes që çdo gjë, që dëgjonin drejtpërdrejtë apo dhe anasjelltas nga Muhamedi a.s., ta kuptonin ashtu siç duhet, ndërsa në raste të ndonjë dyshimi ta vërtetonin, duke pyetur vetë atë a.s.. Ky kujdes i treguar në kohën e Pejgamberit, me kalimin e kohës u shndërrua në një sistem, që ka të bëjë me identifikimin e saktësisë së transmetimeve, që i përshkruheshin Hz. Pejgamberit. Sipas këtij sistemi, hadithet identifikohen dhe klasifikohen, duke u emërtuar me terme *sahih*, *hasen*, *daif* apo *mevdu*. Ky proces ndërtimi i sistemit të metodologjisë së identifikimit të hadithit është zhvilluar në përputhje me rrethanat dhe kushtet e krijuara gjatë historisë, duke u ripërtërirë kohë pas kohe. Kështu që praktikatat e përdorura në fillim për identifikimin e haditheve të sakta, me kalimin e kohës janë sistematizuar, duke marrë formën që kanë sot. Në fillimet e para për ndonjë mëdyshje rreth ndonjë hadithi, është pyetur Pejgamberi a.s., ndërsa më vonë sahabët dhe tabiinët e kështu me radhë, duke arritur në një shkallë, në të cilën përpjekja për identifikimin e saktësisë së hadithit ka kërkuar një sistem më të sofistikuar dhe kompleks. Si pasojë, janë bërë formulime dhe janë përcaktuar kritere me qëllim identifikimi të hadithit të saktë, duke u nisur nga senedi/zinxhiri dhe metni/teksti i vetë hadithit. Kriteret e përcaktuara në lidhje me senedin si pikë referimi kanë marrë vijueshmërinë e senedit dhe besueshmërinë e raviut, gjegjësisht transmetuesit. Ndërsa kriteret e përcaktuara në lidhje me tekstin si pikë referimi kanë marrë Kur'anin, sunnetin *sahih*, logjikën e shëndoshë, faktet historike dhe shkencore. Si fjalë përmbyllëse mund të themi se praktikatat e dijetarëve të hershëm gjithmonë u kanë shërbyer si shembull dijetarëve të mëvonshëm në përdorimin e kriterëve për identifikimin e saktësisë së hadithit.

Në vazhdim kemi paraqitur punimin e radhës nga autori Dr. Azmir Jusufi me temë: “*Komentimi i kuranit nga Hafiz Ali Korça*”. Një fjalë, që zgjon vazhdimisht kureshtjen e njerëzve, e cila lexohet, mësohet, studio-

het dhe analizohet thellë. Si të gjitha kombet, që e kanë ndie nevojën për Kurandin, ashtu edhe shqiptarët, që nga dekada e fundit e shekullit XIX dhe vitet e hershme të shekullit XX, shfaqën interesim në fushën e komentimit të Kuranit. Kështu që ky interesim nuk ka të ndalur deri më sot. Një nga figurat kryesore në fushën e komentimit të Kuranit në gjuhën shqipe është edhe Hafiz Ali Korça, e që është edhe objekt i këtij punimi. Metafora është një krahasim i shkurtuar në të cilin objekti (*imazhi*) i krahasimit, grimca dhe vetia e përbashkët janë hequr. Pra, metaforë është një fjalim i transferuar (nga greq. metafora-transferim), në të cilin ka një ndryshim në kuptimin e një fjale ose një përdorim të pazakontë të një fjale. Ajo e pazakontë mbështetet në vëzhgimin e ngjashmërive ndërmjet dukurive. “Të përdorësh mirë metaforat do të thotë të jesh në gjendje të vëresh ngjashmëritë”, vuri në dukje Aristoteli. Përdorimi i metaforës i jep gjuhës dinamizëm dhe freski, prandaj është mjeti më shprehës i fjalës poetike. Vetë Kurani thotë se ai ia mëson njeriut “atë që ai nuk e di”, dhe për theksimin e tyre, realiteteve të pa njohura ishte e nevojshme metafora. Hafiz Ali Korça ishte i prirur dhe i përkushtuar për të komentuar rregullat fetare në frymën e kohës dhe nevojave të popullit të tij, në çka treguan faqet e këtij punimi. Gjatë jetës dhe veprës së tij, ai luftoi me pasion për një të nesërme më të mirë të popullit shqiptar në sensibilizimin fetar, duke besuar se një popull, që humb besimin, do të humbasë edhe atdheun e tij dhe se këta dy faktorë janë të lidhur ngushtë. Ai u ndesh me vështirësitë e sistemit dhe të rendit shoqëror të asaj kohe, thujse gjatë gjithë jetës së tij ishte nën mbikëqyrjen e elitës politike dhe njerëzve në pushtet. Por, asnjëherë nuk u dorëzua dhe nuk devijoi nga rruga e drejtë. Ishte këmbëngulës në synimin dhe dashurinë ndaj rregullave fetare dhe ndaj interpretimit të mesazheve fisnike nga Kurani Famëlartë.

Në vijim autori Mr. Ali Bardhi sjell studimin e tij empirik të titulluar “*Myftiu në Malin e Zi me seli në Ulqin (1881-1887) sipas dokumenteve arkivore*”. Në këtë artikull, vijuar nga numri i kaluar, kemi trajtuar çështjet, që ndërlidhen me institucionin e Myftinisë nga zhvendosja e tij nga

Ulqini në Podgoricë e më pas në Tivar (1887-1912) me theks në çështjen e emërimit të myftiut, xhamitë, mejtepet, etj., në bazë të dokumentacionit arkivor dhe studimeve të publikuara. Institucioni i Myftinisë i formuar në kuadër të nenit 27, të Kongresit të Berlinit, me të cilin Perandorisë Osmane i lejohej, që të vendoste hierarkinë fetare në Malin e Zi dhe për rrjedhojë myftinjë të emëruan nga Shejhu'l-Islami në Stamboll dhe u miratuan nga krajli i Malit të Zi. Në qershorin e vitit 1912 po ju vinte fundi, pasi krajli në mënyrë të njëanshme emëroi myfti kadiun e Tivarit. Perandoria Osmane e kundërshtoi vendimin e njëanshëm, por fakti se në këto momente situata politike në rajon ishte përkeqësuar mjaftë, pasi po përgatiteshin luftërat ballkanike, lindi një situatë e re me të cilën vendimi i krajli Nikollës mbeti më në favor. Vlen për t'u përmendur, që selia e myftiut edhe pse ishte transferuar në Podgoricë, që nga viti 1887, Ulqini akoma ruante prestigjin e vet tek institucionet e perandorisë Osmane, pasi një gjë të tillë shihet edhe nëpërmjet një dokumenti të arkivit osman të datës, 22.07.1325 h./ 31.08.1906 m., në të cilin shënohet "Ülgün müftüsü Hilmi Efendi" që d.m.th. "Myftiu i Ulqinit Hilmi Efendi. Referuar këtij dokumentacioni arkivor shihet se në këtë interval kohor në Mal të Zi janë emëruar këta myfti: Salih ef. Hyli (mars? 1881-1885?), Hasan Ismet Efendi (shtator 1887-prill 1889), Mustafa Hilmi Tikveshlija (prill 1889-maj, 1911), Mehmet Murat Efendi Podgorica (gusht, 1911-maj, 1912) dhe nga qershori i vitit 1912 u emërua Ali Murteza Karagjuzoviq, deri në abrogimin e Myftinisë së Malit të Zi nga Mbretëria SKS. Përveç kësaj, selia e myftiut të Malit të Zi deri në vitin 1887, ishte në Ulqin, e cila pas shumë ngjarjeve u zhvendos në qendrën e dytë islame, në Podgoricë, në kohën e Hasan Ismet Efendiut, e cila zgjati deri në qershorin e vitit 1912, kur u zhvendos në Tivar, në kohën kur u krajli në mënyrë të njëanshme emëroi myfti, kadiun e Tivarit, Murteza Karagjuzoviqin.

Në fund të këtij numri të revistës "Buletini" kemi artikullin e autorit Ademir Xama (student në nivelin Master në FSI) i cili sjell dëshmi të reja shkencore në lidhje me "*Kontributi i Daut Efendi Boriçit për Gjuhën Shqipë*". Mulla Dauti kishte një detyrë në arsim. Ai fillon karrierën si mësues,

e më pas në vitin 1865, si drejtor i shkollës Ruzhdije, e më pas nga 1870 - 1879, si inspektor i arsimit fillor në Vilajetin e Shkodrës. Duket se Mulla Dauti gjatë detyrave si mësues, drejtor, e më pas si inspektor i arsimit, konstaton nevojën, që populli kishte për shkrim dhe lexim të gjuhës shqipe. Edhe pse në Shkodër në ato vite sipas dëshmimeve flitej shqip dhe kur ishte nevoja edhe osmanisht, arabisht dhe persisht. Ndikim tek Mulla Dauti duket se kishin njerëzit e dijes siç ishte Hasan Tahsini, me të cilin u takua para se të kthehej në Shqipëri gjatë studimeve të tij në Stamboll. Ai abetaret e tij i bazon në shkronjat e gjuhës osmane-arabe, ku dhe krijon edhe 7 shkronja të tjera për nevoja të gjuhës shqipe. Në kuadrin e mësimave për edukimin atdhetar, arsimor e qytetar, që përmbanin tekste mësimore, është edhe porosia e dhënë në mënyrë urdhërore: “*...xen me shkruet shqip*”. Kjo do të thotë se Daut Efendi Boriçi njeht si gjuhë mësimi gjuhën amtare, shqipen. Kështu në atë kohë, kur Shqipëria ishte e pushtuar, ai vë turqishten si gjuhë të dytë, duke shkruar: “*...edhe turçen xen*”. *Së fundi*: Botimi i një abetareje në gjuhën shqipe më 1861, ose më 1869, si tekst i litografuar, me tirazh të konsiderueshëm, kopjet e të cilit i gjetëm pas më shumë se një shekulli në disa familje dhe në fondet e bibliotekave, të bindin se në shkollat e trevës së Shkodrës dhe territoreve, që mbulonte D. Boriçi, si drejtues i vijaletit të Shkodrës, është përdorur abetarja e tij. Si dhe krejt në fund të revistës “Buletini” prezantojmë kronikën e aktiviteteve të Fakultetit të Studimeve Islame në periudhën 1 korrik 2024-31 dhjetor 2024, të përgatitur nga autori Mr. Vedat Shabani.

Lexues të nderuar!

Revista “Buletini” që nga numri i kaluar është indeksuar dhe pajisur me numrin ISSN 3027-5113 (Print) nga Qendra ISSN në Paris, si dhe më 26.12.2024, është indeksuar nga po e njëjta Qendër edhe në versionin online me numër ISSN 3078-7467. Gjithashtu është në rrugë të mirë të anëtarësohet edhe në platformat e revistave të indeksuara me kredibilitet të lartë ndërkombëtar. Në këtë ritëm, revista “Buletini” më 16.12. 2024,

është indeksuar edhe në platformën CEEOL (Central and Eastern European Online Library) me qendër në Frankfurt am Main (Gjermani). Platforma CEEOL përmban revista akademike, libra, dhe dokumente kërkimore nga një gamë e gjerë disiplinash, duke përfshirë shkencat humane, sociale dhe studimet kulturore, historike dhe zhvillimeve politike në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Dhe po ashtu në këtë vazhdë, kemi aplikuar edhe për antarësim në Platformën kërkimore EBSCOhost, e cila është një platformë kërkimore online, e lehtë për t'u përdorur, që përdoret nga mijëra institucione dhe miliona përdorues në mbarë botën. Me baza të dhënash cilësore dhe veçori të avancuara kërkimi, EBSCOhost ndihmon studiuesit e të gjitha fushave të gjejnë informacionin që u nevojitet. Këtë ia kemi borxh lexuesit, studentëve tanë si dhe qarqeve akademike. Me këtë rast redaksia vazhdon të mbetet e përkushtuar të bëjë zgjerimin dhe krijimin e hapësirave për hulumtues e studiues të rinj ku do të ofrohet kontribut në disiplinat e saj të përfaqësuara në avancimin e teorive, epistemologjisë, pedagogjisë dhe metodave, por gjithmonë, duke ruajtur frymën e traditës së themelimit dhe objektivave së saj.

Për fund, shpresën dhe ndihmën e kemi nga Krijuesi fuqiplotë, i Cili jep sukses dhe pranueshmëri të vizionit të Revistës në mesin e komunitetit shkencor edhe më gjerë.

Prishtinë, qershor 2025

Redaktor Përgjegjës:

Prof. Ass. Dr. Rexhep SUMA

Profesor Asistent në Fakultetin e Studimeve Islame, Prishtinë

E-mail adresa: rexhep.suma@fsi-edu.net;

Orcid.org/0009-0009-4920-2838

ARTIKUJT

Sprova e njeriut dhe objektivat e saj sipas Kuranit fisnik

Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati*

Abstrakt

Sprovat janë një ligj hyjnor, që përfshin çdo njeri dhe nuk janë të rastësishme apo pa qëllim. Ato përmbajnë urtësinë e Zotit dhe përcaktimin e Tij në univers, në jetë dhe në histori, duke ndjekur veprimet e njeriut. Këto sprova janë të vazhdueshme, të përgjithshme dhe të qëndrueshme. Ato nuk janë gjithmonë një formë ndëshkimi apo poshtërimi, por një test nga Zoti për njeriun, që për objektivat ka pastrimin, edukimin dhe fuqizimin e tij në tokë. Edhe psikologët janë të mendimit, se; kalimi i njeriut nëpër periudha të vështira sjell përfitime befasues. Shumë njerëz përjetojnë rritje psikologjike pozitive pas kohëve të vështira. Psikologët, këtë e quajnë "Fenomeni i Feniksit". Ky studim synon të nxjerrë, objektivat kryesore të sprovës së njeriut, duke iu referuar ajeteve fisnike të Kuranit.

Fjalët kyçe: *Sprova, objektivat, Kuran, psikologji, edukim.*

* Autori Prof.Ass.Dr. Lulzim Esati, Fakultetin e kreu në Universitetin Al Az-har në Kajro më 1995. Temën e magjistraturës e ka mbrojtur në Universitetin e Alul Bejtit në Mafrak të Jordanisë më 1999. Në 2004 mbrojtë temën e doktoraturës "Zotimi në Kuran dhe Sunet", në Universitetin Islamik Ndërkombëtar në Malajzi. Punon në Fakultetin e Studimeve Islame që nga viti 2005 e këtej, ndërsa ligjëron lëndët e Tefsirit. Është autor i dy librave: Studime praktike në komentimin tematik të Kuranit dhe Personalitete në Kuranin Famëllartë. Dhe tani e mban pozitën e prodekanit në FSI.

Abstract

Trials represent a universal divine law that applies to all human beings and are neither arbitrary nor without purpose. They reflect the wisdom and decree of God manifested throughout the universe, human life, and history, in accordance with human actions. These trials are ongoing, comprehensive, and enduring. They are not necessarily a form of punishment or humiliation, but rather a divine test intended to purify, educate, and empower the human being on earth. Psychological research likewise affirms that enduring hardship can yield unexpected benefits. Many individuals report positive psychological growth following periods of adversity—an experience known in psychology as the "Phoenix Phenomenon." This study seeks to explore the core objectives of human trials by examining selected verses from the Qur'an.

Keywords: Trial, purpose, Qur'an, psychology, education.

Në Kuran, ka shumë ajete, që theksojnë rëndësinë e ligjit të sprovës në jetën e besimtarit dhe qëllimet e saj në shlyerjen e mëkateve dhe lidhjen me Zotin, qoftë kjo sprovë me fatkeqësi, sëmundje, fëmijë apo të gjitha llojet e tundimeve.

Në përputhje me ajetet e mëposhtme të Kuranit, kur Allahu i Madhërisëm në Kuran, thotë:

﴿إِنَّا خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ نُطْفَةٍ أَمْشَاجٍ نَبْتَلِيهِ فَجَعَلْنَاهُ سَمِيعًا بَصِيرًا﴾

Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkë dyzuar për të sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë. (El-Insan, 2)

﴿الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ﴾

Ai është, që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju sprovuar se cili prej jush është më vepër mirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkate falësi. (El-Mulk, 2)

Sprovat janë ligji i Zotit për krijesat e Tij. Siç shihet edhe më lart, sqarimi me ligjin e sprovës, është në përputhje me fjalët e Allahut të Lartësuar: **"Ne ju sprovojmë me të keqen dhe të mirën si provë, dhe tek Ne do të ktheheni."** (El-Enbija, 35)

Kjo tregon se, për të dalluar se kush është mirënjohës dhe i durueshëm në të dyja gjendjet, Allahu i sprovon robërit e Tij, si me vështirësi dhe fatkeqësi, ashtu edhe me begati dhe mirësi.

﴿وَهُوَ الَّذِي جَعَلَكُمْ خَلَائِفَ الْأَرْضِ وَرَفَعَ بَعْضَكُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِيُبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ ۗ إِنَّ رَبَّكَ سَرِيعُ الْعِقَابِ وَإِنَّهُ لَغَفُورٌ رَحِيمٌ﴾

Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë dhe lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët, për t'ju sprovuar në atë që u dha. All-llahu është ndëshkues i shpejtë, është që falë e Mëshirues. (El-En'amë, 165)

{Dhe Ai i ka ngritur disa prej jush mbi të tjerët në shkallë} të nderit dhe furnizimit {që t'ju testojë në atë që ju ka dhënë} nga begatia e parasë dhe prestigjit, si e falënderoni për atë begati dhe si sillet fisniku me të përvojaturit, i liri me robin dhe i pasuri me të varfërinë.

﴿أَحْسِبَ النَّاسُ أَنْ يُتْرَكُوا أَنْ يَقُولُوا آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ﴾

A menduan njerëzit të thonë: "Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë?" (Ankebut, 2).

Shejh el-Gazali, si hyrje të kësaj sureje "el-Ankebut", që fillon më këtë ajet më sipër, thotë: "sprovat janë natyre e kësaj bote, nëpër të cilat kalojmë si nëpër një urë dhe dalim nga kjo jetë në jetën tjetër për të parë rezultatet e asaj që kemi bërë dhe asaj që kemi lënë mangët, nëse kemi shpëtuar apo dështuar, nëse do të nisemi për në Xhenet apo për në Xhehenem! Këto sprova mund të jenë nga më të rëndat, por, edhe nga më të lehtat, në varësi nga natyra e njeriut, fuqia e tij dhe preokupimi.... Tela-shet e jetës janë në përpjesëtim me synimet jetësore".¹

¹ Muhamed el-Gazali, *Komenti Tematik i Kuranit famëlartë*, përktheu nga gj. Arabe: Sadush Tahiri, (Shkup: Logos-A, 2007), f. 378.

﴿أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُدْخَلُوا الْجَنَّةَ وَلَمَّا يَأْتِكُمْ مَثَلُ الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلِكُمْ ۗ
 مَسَّتْهُمُ الْبَأْسَاءُ وَالضَّرَّاءُ وَزُلْزِلُوا حَتَّى يَقُولَ الرَّسُولُ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ مَتَى
 نَصُرُ اللَّهَ ۗ أَلَا إِنَّ نَصْرَ اللَّهِ قَرِيبٌ﴾

Po ju menduat se do të hyni në Xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre, që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: “Kur do të jetë ndihma e All-llahut?” Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e Allahut është afër!”. (El-Bekare, 214).

Katade dhe Suddi kanë thënë se ky ajet ka zbritur gjatë Betejës së Hendekut, kur myslimanët përjetuan vështirësi të mëdha, si lodhje, vështirësi, nxehtësi, frikë, të ftohtë, kushte të këqija jetese dhe lloje të ndryshme të mundimeve, ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar: **“dhe zemrat arritën në fyt”** (El-Ahzab, 10).² Më të vërtetë, që pas kësaj sprove të madhe kur të gjithë ata, që ishin pjesë e kësaj sprove të tmerrshme, menduan se nuk ka shpëtim dhe durimi i tyre u sos. Ndodhi ajo, që thotë Allahu fuqiplotë: **Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e Allahut është afër!**. Pas sprovës së madhe, vjen lehtësimi i madh. Ky lehtësim ishte fitorja e myslimanëve pa luftë dhe pa u përplasur me armikun. Siç njofton Allahu i plotfuqishëm në Kurani: **O ju që keni besuar, përkujtonie të mirën e All-llahut ndaj jush, kur juve ju erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri, që ju nuk e shihnit.** (El-Ahzab, 9). E sa e madhe ishte kjo sprovë, dhe sa e papërballueshme ishte, njoftojnë këto dy ajete: **Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshti, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojlojta për All-llahun.** (El-Ahzab, 10). **Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët, dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë.** (El-Ahzab, 11).

² Ali Ibën Ahmed, el-Vahidi v, 468h. *Esbabu Nuzul*, (Demam: Darul Islah, botimi II, 1992), f. 67.

Kjo që i goditi sahabet r.a., në krye me Pejgamberit s.a.v.s., tregon në mënyre praktike për stabilitetin e ligjit të sprovës dhe pandryshueshmërinë e tij. Nga ana tjetër tregon shtrirjen e tij në të gjitha shtresat e shoqërisë, siç edhe tregon mos përjashtimin e asnjë individi kushdo qoftë ai, çfarëdo statusi të ketë, qoftë edhe i dërguari Allahut xh.xh., dhe më i dashuri i Tij, Muhamedi s.a.v.s. Syneti i Pejgamberit a.s. na bën me dije, dy gjëra lidhje me ligjin e sprovës;

1. Nga ky ligj, nuk bën përjashtim askush çoftë ai pejgamber.
2. Sa më lartë që njeriu ngritet për nga statusi i tij në shoqëri, ky ligj e shtrëngon aq më tepër.

Dëgjoni se ç'thotë hadithi për këtë: Transmetohet nga Mus'ab bin Sa'd bin Ebi Vekas, nga babai i tij, se ai ka thënë: "E pyeta: 'O i Dërguari i Allahut, cilët njerëz janë më të sprovuar?' Ai u përgjigj: 'Pejgamberët, pastaj ata, që u ngjajnë më shumë atyre, e pastaj ata, që u ngjajnë më shumë atyre. Njeriu sprovohet sipas forcës së fesë së tij. Nëse është i fortë në fenë e tij, sprovat e tij janë më të ashpra, dhe nëse është i dobët në fenë e tij, sprovohet sipas forcës së fesë së tij. Sprovat vazhdojnë mbi robin derisa ta lënë atë të ecë mbi tokë pa asnjë mëkat.'"³

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Seid el-Hudri, thuhet: "Profetët." Ebu Seidi pyeti: "Pastaj kush?" Profeti tha: "Pastaj dijetarët." Ebu Seidi pyeti: "Pastaj kush?" Profeti tha: "Pastaj njerëzit më të mirë".⁴

Ky hadith tregon se sprovat dhe vështirësitë janë pjesë e natyrshme e jetës së besimtarëve, veçanërisht të atyre me besim të fortë dhe se këto sprova shërbejnë për të pastruar mëkatet e tyre. Ajetet e Kuranit fisnik, që u përmendën më lart, tregojnë, që ky ligj i Allahut fuqiplotë, është pjesë e jetës së njeriut. kushdo çoftë ai.

Tani do ta sjellim ajetin fisnik, që tregon fushat, që godet ky ligj në jetën e njeriut, më së tepërmi, e në mënyrë të veçantë besimtarin. Allahu xh.xh. thotë:

³ Shihabuddin Ahmed ibën Ali, ibën Muhamed, ibën Haxher el-Askalani, *Fet'hul Bari*, (Bejrut: Darul Ihja et-Turath el-Arabi, botimi: IV 1988), vëll. X, f. 116.

⁴ Ibid. f. 116.

﴿وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ
وَالثَّمَرَاتِ﴾

Ne do t'ju sprovovjmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet. (El-Bekare, 155).

Pra, këto janë fushat, që i ka zgjedhur sprova për ta goditur njeriun zakonisht, në këtë jetë:

1. Frikë (mungesë e sigurisë).
2. Uri.
3. Humbje të pasurisë.
4. Humbje të jetës (vdekja).
5. Humbje të fryteve (bereqetit).

Edhe pse, sprovat janë prej ma të ndryshme në këtë jetë, siç kemi sëmundjet e shumta, etj. Por këto lloje të sprovës janë, që godasin shoqërinë në formë të rëndomtë.

Pas tyre, renditen këto sprova, thotë i Lartëmadhërishmi:

﴿إِنَّمَا أَمْوَالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ فِتْنَةٌ﴾

S'ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë provë – (Tegabun, 15).

Imam Rraziu, gjatë komentimit të fjalës së Allahut: “*Ne ju sprovovjmë me të keqen dhe të mirën si provë*” thotë: Ka disa çështje për t'u shqyrtuar këtu: Çështja e parë: Sprova nuk realizohet veçse me përgjegjësinë (taklif). Ky ajet tregon për ekzistencën e përgjegjësisë dhe se Allahu i Lartësuar nuk është mjaftuar me urdhrat (farzet) dhe ndalimet (haramet), edhe pse në to ka vështirësi, por Ai e ka sprovuar njeriun me dy gjëra:

1. Atë që e ka quajtur të mirë, që janë begatitë e kësaj bote, si shëndeti, kënaqësia, gëzimi dhe arritja e dëshirave.
2. Atë që e ka quajtur të keqe, që janë dëmet e kësaj bote, si varfëria, dhimbjet dhe vështirësitë e ndryshme që i ndodhin njeriut.

Allahu i Lartësuar ka sqaruar se robi, përveç përgjegjësisë, lëviz mes këtyre dy gjendjeve, në mënyrë që të falënderojë për dhuratat

dhe të durojë në sprova, dhe kështu shpërblimi i tij të rritet nëse vepron siç duhet.

3. Sprova me epshe dhe kënaqësi; si pasuria, pozita sociale, fama, ku njeriu testohet në aftësinë e tij për të kontrolluar vetën dhe për të mos u ndjekur nga epshet e ndaluara.
4. Sprova me dije; njeriu mund të testohet me dijen, se apo afrohet me të te Allahu xh.xh., apo mos bëhet dija shkak për largimin e tij nga rruga e drejtë.
5. Sprova me adhurim dhe bindje; njeriu testohet në sinqeritetin e tij në adhurim dhe bindje ndaj Allahut dhe në mos e bën këtë për t'u dukur dhe për t'u treguar para tjerëve.
6. Sprova në trazira dhe konflikte, si luftërat, trazirat sociale ose përhapja e korrupsionit, ku njeriu testohet në qëndrueshmërinë e tij në të vërtetën.

Objektivat e sprovës sipas Kuranit fisnik

1. Rritjen e vendosmërisë te besimtarët. Kjo mund të kuptohet nga fjala e Allahut xh.xh:

﴿لَتَبْلُوَنَّ فِي أَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ وَلَتَسْمَعَنَّ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا أَذًى كَثِيرًا وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ﴾ [آل عمران: ١٨٦].

Ju me siguri do të viheni në provë me pasurinë tuaj dhe me jetën tuaj dhe ju do të dëgjoni shumë fyerje nga ana e atyre që u është dhënë Libri para jush dhe nga paganët. Nëse jeni durimtarë dhe i druani Zotit, me të vërtetë, ajo është vendosmëri (e madhe) në vepër.

Nuk është çdo person, që pranon fenë e Allahut i sinqertë. Por, prova për këtë është përballja me të pëlqyeshmen dhe të papëlqyeshmen; sepse dashuria e vërtetë (për Allahun) është ajo, që nuk zvogëlohet me ashpërsinë dhe nuk rritet me mirësinë. Nëse dashuria mbetet e

qëndrueshme gjatë sprovave, atëherë kjo tregon se ai është e sinqertë.

2. Dërgimi i fatkeqësisë bëhet për të ngritur gradat e besimtarëve durimtarë. Kjo kuptohet nga fjala e Lartëmadhërishmit:

﴿وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ
وَالنَّمَرَاتِ وَبَشِيرِ الصَّابِرِينَ﴾

Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoji durimtarët.

Allahu i Lartësuar ka sprovuar profetët dhe të dërguarit, të cilët nuk janë mëkatarë apo fajtorë, prandaj nuk mund të mendohet se sprovat e tyre janë ndëshkim për ta. Allahu ia ka falur të Dërguarit të Tij (paqja qoftë mbi të) mëkatet e mëparshme dhe të mëvonshme, megjithatë ai ishte ndër njerëzit më të sprovuar. Kjo ishte gjendja e shumicës së profetëve, për t'i ngritur në shkallë më të larta.

3. Zbritja e sprovave për t'i dëlirë besimtarët dhe për t'i dalluar të sinqertët nga gënjeshtarët.

﴿وَلِيَبْتَلِيَ اللَّهُ مَا فِي صُدُورِكُمْ وَلِيُمَحِّصَ مَا فِي قُلُوبِكُمْ﴾

Në mënyrë që All-llahu të provojë atë që është në zemrat e tuaja (sinqeritetin, ose hipokrizinë) dhe që të pastrojë atë që është në zemrat tuaja. (Ali Imran, 154).

Sprovat që i godasin besimtarët në disa raste shërbejnë për t'i pastruar ata. Sipas al-Kashaniut, sprovimi është një kamxhik nga kamxhikët e Zotit, me të cilin Ai i drejton robërit e Tij drejt Vetës së Tij, duke i pastruar ata nga cilësitë e egos së tyre, duke shfaqur përsosmëritë, që ata bartin dhe duke i shkëputur ata nga krijesat për t'i lidhur me të Vërtetin. Fjala e Pejgamberit a.s. "Asnjë profet nuk është dëmtuar siç jam dëmtuar unë", sikur do të thotë: Asnjë profet nuk është pastruar siç jam pastruar unë.

Siç bën me dije edhe ky ajet fisnik:

﴿مَا كَانَ اللَّهُ لِيَذَرَ الْمُؤْمِنِينَ عَلَىٰ مَا أَنْتُمْ عَلَيْهِ حَتَّىٰ يَمِيزَ الْخَبِيثَ مِنَ الطَّيِّبِ﴾

Allahu nuk i le besimtarët në gjendjen që ndodheni ju (tash të përzier – muslimani i vërtetë me hipokritin) përderisa të mos e ndajë të keqin prej të mirit. (Ali Imran, 179).

Sprovat shërbejnë për të dalluar të ligun, që mohon, zemërohet dhe e humb shpresën, nga i miri, që beson, është i kënaqur dhe duron.

4. Zbritja e sprovave shërben për të pastruar besimtarët dhe për të shlyer mëkatet e tyre.

﴿وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فِيمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ﴾

Çfarëdo e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqia), e për shumë të tjera Ai u falë. (Shura, 30).

Fatkeqësitë që u ndodhin njerëzve janë për t'ua shlyer mëkatet atyre, por sa u përket profetëve, ato janë vetëm për ta ngritur gradën e tyre, sepse janë të pagabueshëm nga mëkatet dhe shkeljet. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Çfarëdo që i ndodh një myslimani nga lodhja, sëmundja, shqetësimi, trishtimi, dëmi apo brenga, madje edhe shpimi nga një gjemb, përveçse Allahu me të i shlyen mëkatet e tij”. (Buhariu, 5642). & (Muslimi, 2573).

Ky hadith tregon se çdo vështirësi, që përjeton një besimtar, shërben si shlyerje për mëkatet e tij.

5. Sprovat u dërgohen njerëzve që ata të kthehen dhe t'i drejtohen me përunjësi Allahut.

Një nga arsytet pse Allahu dërgon sprova, është për të ndëshkuar njerëzit për disa nga mëkatet e tyre, me shpresën se kjo do t'i frenojë; të kthehen nga devijimi dhe të përmirësojnë gjendjen e tyre, përmes pendimit dhe përunjës ndaj Allahut të Lartësuar.

﴿وَلَنُذِيقَنَّهُمْ مِنَ الْعَذَابِ الْأَلِيمِ الَّذِي يَدْعُونَ لَكَ بِالْعَذَابِ الْأَكْبَرِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ﴾

Ne do t'u shijojmë atyre dënimin më të shpejtë (në dynja) para dënimit të madh (në Ahiret), ndoshta do të tërhiqen (prej të këqijave). (Sexhde,21).

“Kur qëllimi përfundimtar i shijimit të tyre i ndëshkimit, është kthimi i tyre i dëshiruar - dhe ky kthim i dëshiruar është kthimi te Allahu përmes pendimit dhe përluljes - atëherë ndëshkimi më i vogël i referohet ndëshkimit të kësaj bote, që u bie atyre për t’i frikësuar dhe paralajmëruar, në mënyrë që të pendohen, dhe jo ndëshkimit shkatërrues apo ndëshkimit pas vdekjes. Në këtë rast, ndëshkimi më i madh i referohet ndëshkimit të Ditës së Gjykimit. Kuptimi është: “Beto hem se do t’u japim të shijojnë një pjesë të ndëshkimit më të vogël (siç janë thatësitrat e vështira, sëmundjet, vrasjet dhe të ngjashme) para ndëshkimit më të madh në Ditën e Gjykimit, me shpresë që të kthehen te Ne me pendim për shirkun dhe mohimin e tyre”.

﴿ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ لِيُذِيقَهُمْ بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ﴾

Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të kësaj të keqeje që e bënë, ashtu që tërhiqen (nga të këqijat). (Rrum,41).

Fjala "لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ" në arabisht, në shqip përkthehet si “që ata të kthehen”. Kjo shprehje ka dy interpretime kryesore:

1. **Të kthehen te e vërteta:** Sipas interpretimit të Ibrahimit, kjo nënkupton që, njerëzit të kthehen drejt së vërtetës dhe të ndjekin rrugën e drejtë.
2. **Të pendohen nga mosbesimi:** Sipas Ibn Abbasit, kjo do të thotë që, njerëzit të pendohen për mosbesimin e tyre dhe të pranojnë besimin e vërtetë.⁵

Këto interpretime tregojnë që, qëllimi i ndëshkimeve të vogla në këtë botë është që, njerëzit të reflektojnë dhe të kthehen te Zoti me pendim dhe besim të sigurtë.

⁵ Ali Ibën Muhamed, el-Maverdi, *EN-Nuketü vel-Ujun*, (Bejrut: Darul Kutub el-Ilmiye, 2002), v. III, f. 234.

Cilat janë dobitë e sprovave të njeriut gjatë jetës sipas psikologëve?

Përfitime befasues nga kalimi nëpër periudha të vështira: Në psikologji, ekziston një term për këtë proces - rritja post-traumatike - që i referohet përfitimeve dhe zhvillimit personal, që vijnë pas përjetimit të një krize. Siç e quan psikologjia Shilagh Mirgain, ky është “Fenomeni i Feniksit”, duke sugjeruar se një jetë e re lind nga mbetjet e mënyrës së vjetër të të qenit. Hulumtimet kanë zbuluar se deri në 70 për qind e njerëzve përjetojnë rritje psikologjike pozitive pas kohëve të vështira, si një ndjenjë më e thellë e vetvetes dhe qëllimit, një vlerësim më i madh për jetën dhe të dashurit, dhe një kapacitet të shtuar për altruizëm, empati dhe dëshirë për të vepruar për të mirën e përgjithshme.⁶

Sfidat e jetës i referohen vështirësive dhe pengesave të ndryshme, që individët hasin gjatë jetës së tyre, të cilat shpesh shërbejnë si prova të qëndrueshmërisë dhe karakterit. Këto vështirësi mund të shfaqen në forma të ndryshme, si humbje personale, probleme shëndetësore, vështirësi financiare ose konflikte në marrëdhënie. Përballimi i këtyre sfidave mund të çojë në rritje personale, empati më të madhe për të tjerët dhe një kuptim më të thellë të pikave të forta dhe të dobëta të dikujt. Duke kapërcyer sprovat e jetës, njerëzit shpesh dalin me mësim të vlefshme dhe me një perspektivë të re mbi jetën.⁷

Pra, qëllimi i një sprove është të zhvillojë karakterin tonë, të nxjerrë në pah qëndrueshmërinë, vendosmërinë dhe durimin. Nuk ndihesh mirë kur e kalon, por përfundimisht, jep rezultate të mira. Ne do të donim, që gjithçka të përfundojë shpejt, por zakonisht nuk funksionon kështu.⁸

Mexhid El-Kilani⁹ thotë: Sprova është një edukim përmes përvojës, qëllimi i së cilës është të kuptosh të mirën dhe të shijosh bukurinë e saj

⁶ <https://www.uwhealth.org/news/surprising-benefit-going-through-difficult-times>

⁷ <https://psychologyfanatic.com/life-trials/>

⁸ [https://a-deeper-walk.com/The Purpose of Trials](https://a-deeper-walk.com/The-Purpose-of-Trials).

⁹ (1932 - 24 tetor 2015), mendimtar, historian dhe edukator nga Jordania. Diplomë Master në Edukim nga Universiteti i Jordanisë dhe doktoraturë në Edukim nga Universiteti i Pittsburgh në Pensilvani-USA.

dhe të kuptosh të keqen dhe të zbrapset nga shëmtia e saj. Nëpërmjet kësaj arrihet një qëllim i rëndësishëm i sprovës, që është të kuptosh madhësinë e bekimeve hyjnore mbi këtë lloj sprove. Sepse kur një person testohet nga një situatë e caktuar dhe më pas ndjek metodat e duhura për t'u përballur me të, ai zhvillon një përvojë të saktë të natyrës të situatave të përkohshme dhe të gjërave kozmike dhe di metodat e duhura për t'u përballur me to. Kur ai gabon në këto metoda të sakta, ai e kupton rrezikun e devijimit nga ligjet e gjërave dhe i di efektet e këqija të metodave të gabuara. Rezultati i gjithë kësaj është përparimi i racës njerëzore.¹⁰

Përfundimi

Në fund të këtij punimi, kolaudojmë, që ligji i i sprovës është mbuluar me drejtësinë hyjnore nga Krijuesi i plotfuqishëm, duke mos përjashtuar askënd nga ky test. E mira e saj është se ajo godet sipas forcës së besimit. Sado që neve na duken të dëmshme sprovat, ato sjellin përfitime të mëdha. Mprehin shkathtësitë e besimtarit, forcojnë moralin e tij dhe afrojnë atë me Krijuesin e tij, dhe këto janë objektivat parësore të sprovës sipas Kuranit fisnik. Për këtë dëshmon edhe fjala e Allahut xh.xh:

قُلْ لَنْ يُصِيبَنَا إِلَّا مَا كَتَبَ اللَّهُ لَنَا هُوَ مَوْلَانَا ۗ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ

Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na ka caktuar All-llahu; Ai është ndihmëtar yni”. Prandaj, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët. (Teube, 51). Arsyeja është, fjala: (لَنَا - për ne), është përdorur në vend të fjalës: (عَلَيْنَا - mbi ne). Që do të thotë se këto sprova nuk janë ngarkesë mbi ne siç ne mendojmë, por, janë për të mirën tonë, pra, për ne. E kjo e dhënë se sprovat janë për të mirën e njeriut, po vërtetohet edhe nga psikologët bashkëkohorë dhe nga ekspertët e edukimit.

¹⁰ <https://www.islamweb.net/ar/article/230401/>

Umeri r.a., model strategjik për misionin dhe strategjinë e thirrjes islame në një shoqëri të drejtë dhe tolerante (583-644)

Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma*

Abstrakt

Ky artikull shkencor nxjerr në pah analizën me mundin dhe kontributin e udhëheqësit të muslimanëve, Umerit r.a. i cili tërë jetën ia kushtoi fushës së thirrjes islame, duke vë në theks të veçantë ndikimin e tij në ngritjen dhe fuqizimin e institucioneve publike-shtetërore si dhe komunikimin e vlerave islame në ambientet e reja, duke objektivizuar avancimin dhe shtrirjen e vlerave morale e sociale të vetë Islamit si fe. Aktiviteti i tij si reformator administrativ, lider e thirrës (da'i) mbetet mostër për thirrjen islame në çdo kohë dhe kontekst. Nën drejtimin e tij, Islami njohu një shtrirje të gjerë, ku fuqizimi i thirrjes islame ishte në fokusin qendër të të gjitha politikave të Umerit, r.a. Mësimet dhe shembulli i tij ende vazhdojnë të mbeten frymëzim për udhëheqësit dhe

* Autori Prof. Ass. Dr. Rexhep Suma, studimet master i ka kryer në drejtimin teologji në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, ndërsa doktoratën ka përfunduar në Universitetin Ndërkombëtarë-Fakulteti i Studimeve Islame – në Novi Pazar më 2021, në lëmin e daves. Është profesor në Fakultetin e Studimeve Islame. **Email:** rexhep.suma@fsi-edu.net, **Orcid ID:** 0009-0009-4920-2838.

thirrësit në të gjithë botën islame, duke i përkujtuar për peshën dhe vlerën e drejtësisë së njëmendët, modestinë dhe përkushtimin e devotshmërinë ndaj Krijuesit fuqiptotë. Ky artikull shkencor analizon dhe sjell aspekte kyçe të aktivitetit të tij, duke u mbështetur në burime historike dhe shkencore.

Fjalë kyçe: *Umeri, daveologji, reformator, model, drejtësi.*

Abstract

This academic article explores the strategic role and enduring legacy of ‘Umar ibn al-Khaṭṭāb (RA) in advancing the Islamic mission (da‘ēah) within the framework of a just and tolerant society. As a pivotal leader in early Islamic history, ‘Umar (RA) dedicated his life to institutionalizing and expanding the principles of Islam through comprehensive administrative reforms and public engagement. His governance exemplified the integration of Islamic moral and social values into newly emerging societies, while ensuring the institutional strength of the Muslim polity. His approach to da‘ēah—rooted in justice, humility, and devotion—remains a paradigmatic model for contemporary Islamic leadership. The article draws upon primary historical sources and modern academic literature to examine his strategic methods, leadership ethics, and institutional contributions, offering a framework for da‘ēah that is both principled and effective in diverse socio-political contexts.

Keywords: *‘Umar ibn al-Khaṭṭāb, Islamic da‘ēah, governance, reform, justice, leadership model.*

Hyrje

Periudha e halifatit të drejtë (*hulefai rashidijn*) zgjati nga viti (11 h. deri në 40 h.), dhe përgjatë kësaj periudhe, metodologjia dhe metoda në thirrjen islame shënonte një kontinuitet të asaj pejgamberike. Kjo metodologji stabilizoi parimet e saj të ndërtuara në metodologjinë kuranore, e cila kishte përcaktuar metodologjinë e thirrjes dhe qasjen ndaj të thirrurve, pavarësisht kategorive të tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se, Umeri r.a., kalifi i drejtë, përdori autoritetin e tij politik, shoqëror dhe fetar për të afirmuar aktivitetet e thirrjes islame (da'va). Për të parë peshën dhe rëndësinë e tij në kuadër të vlerave dhe thirrjes islame, e kuptojmë më së miri nga hadithi, që e ka thënë Muhamedi a.s., e që transmetohet nga Ukbe b. Amir që pasqyron madhësinë e figurës së tij. “*Sikur të kishte qenë një pejgamber pas meje, ai do të ishte Umer ibn el-Hattabi (r.a.),*” Ixhtihadi i tij i jashtëzakonshëm ishte i orientuar në funksion të thirrjes islame, ndërsa ekspansioni drejt territoreve të reja nuk përbënte një qëllim në vetvete, por një formë strategjike e shtrirjes së mesazhit islam. Ky proces u udhëhoq dhe u motivua drejtpërdrejt nga vizioni dhe angazhimi i thellë i Umerit (r.a.) për ta përçarur Islamin në shoqëri të reja përmes drejtësisë, dijes dhe institucionalizimit të vlerave fetare. Kjo periudhë e lavdishme e thirrjes islame veçanërisht u karakterizua dhe u fokusua në dy elemente thelbësore:

1. Udhëzimi dhe drejtimi i muslimanëve drejt vendimeve të Allahut xh.sh., dhe udhëzimeve të Profetit a.s., në çdo aspekt fetar dhe jetësor, përmes hutbeve të xhumasë, festave dhe të rasteve të tjera; si dhe
2. Komunikimi i mesazhit të fesë islame në ambientet e jomuslimanëve, duke vënë në funksion forma dhe metoda e edhe mjete në kuadër të thirrjes islame. Sahabët a.s. përhapnin dhe komunikonin thirrjen islame në vendet e sapo pushtuara, derisa banorët e tyre ta pranonin islamin me dëshirë dhe liri të plotë.

Figura poliedrike dhe karizmatike e Umerit r.a. është prezantuar nga fusha historike, apo edhe si figurë me influencë të jashtëzakonshme në

masë, me virtytet e tij të njohura si: drejtësia e edhe e vërteta, por pak ose aspak nga këndi i ndërlidhjes së davetologjisë dhe mundit të tij jetësor në këtë sferë. Është njëri ndër personalitetet islame, që gjatë sundimit të tij në periudhën kohore 634–644, jo vetëm që dha kontribut në konsolidimin e institucioneve dhe të strukturave shtetërore, por po ashtu ngriti një sistem të organizuar, që e përkrahu thirrjen islame dhe shpërndarjen e mesazhit të islamit edhe jashtë gadishullit arabik. Kur vdiq Ebu Bekri r.a. amanetin e udhëheqjes së myslimanëve dhe thirrjes islame iu besua Umerit r.a. i cili ndoqi rrugën e halifit të parë në thirrjen islame si në mjediset myslimane dhe jomyslimane. Umer el-Faruk r.a., shquhej për drejtësi, zgjuarsis dhe aftësi të sistemimit dhe të organizimit. Gjatë kohës së halifatit të Umerit r.a., thirrja islame i zgjeroi kufijët e saj duke ngërthyer në këtë mes edhe aspekte të reja në mënyrën e organizimit si dhe fushë të edukimit dhe arsimit, që si rezultat u reflektuar me një zhvillim të madh e të qëndrueshëm social si dhe ngritjen e vetëdijes së myslimanëve në aspektin kulturor, fetar e segmente tjera të jetës në përgjithësi. Në vijim do të cekim disa nga nismat dhe projektet e tij kryesore në këtë sferë janë siç vijon:

Përkushtimi individual i Umerit r.a. në thirrje dhe ligjërime publike

Umeri r.a. kontribuoi drejtpërdrejt në udhëzimin e myslimanëve përmes hutbeve dhe këshillave publike, duke mbajtur qëndrime të qarta dhe vendimtare. Në mesin e hutbeve të tij më të spikatura ishte edhe ajo ku ai ua përkujtonte masës së se Allahu xh.sh., kishte shpallur ndalimin e alkoolit, duke theksuar se ai mund të përftohet nga pesë burime kryesore: rrushi, hurmat, gruri, mjalta dhe elbi.

Qyteti i Medinës u bë qendër e diturisë, shkencës dhe fetvasë

Përkushtimi i halifit Umer r.a., ndaj dijes dhe komunikimit sa më të saktë dhe më të mirë të daves, bëri që qyteti i Medinës të shpallej epiqendër e dijes, e fetvasë dhe kryeqytet të shtetit islam. Pas shtrirjes së vlerave islame edhe jashtë gadishullit arabik dhe fitoreve të një pas njëshme, qyteti i Medinës vazhdoi të mbetej qendër kryesore pasi që ishte edhe vendqëndrim i shokëve të Muhamedit a.s. Me largpamësinë e një lideri hz Umeri vazhdoi të mbajë raporte të afërta dhe të ngushta me shumë sahabë dijetar për të marr nga dituria, urtësia e këshillat e tyre. Kjo formë e sjelljes së Umerit r.a. e bënte qytetin e Medinës një institucion shkollor për përgatitjen formimin dhe avancimin e dijeve fetare e pse jo edhe në sferën e gjyqësisë. Burime arkivore të ndryshme historike dokumentojnë se përgjatë kësaj periudhe janë rexhistruar mbi 130 sahabij që ofronin dhe përgjigjeshin në pyetjet e masës nga aspekti i fikhut (fetva).

Mësim dhe udhëzim për ushtritë

Halifi Umer el Faruk, nga largpamësia, që zotëronte, caktonte një dijetarë dhe fikhist për çdo ushtri, që dilte në ekspedita, për t'i mësuar ushtarët çështjet e fesë, normat juridike dhe leximin e Kuranit. Ai vazhdoi me po të njëjtin pasion si paraardhësi i tij, Ebu Bekr, r.a., dhe realizoi fushatat e tij të përgatitura me kujdes, të ngjashme me ato të Ebu Bekrit. Në vitin e 14-të të Hixhresë, ai dërgoi një ushtri nën komandën e Sa'd ibn Ebi Vekkasit, r.a., për pushtime të mëtejshme. Formacioni ushtarak i udhëhequr nga Sa'd ibn Ebi Vekas (r.a.) në betejën e Kadisijes në Irak, arriti të mposhte me vendosmëri komandantin e njohur persian Rrustum dhe ushtrinë e tij të fuqishme. Pas kësaj, Sa'di, r.a., në vitin e 16-të të Hixhresë, hyri triumfalisht në Persi, El-Medain. Nën udhëheqjen brilante të Huzejfe ibn el-Jemanit, r.a., persianët u mundën në betejën e Nihavendit. Menjëher pas kësaj fitoreje, qyteti i Esfahanit ra nën kontrollin e myslimanëve dhe, brenda një periudhe të shkurtër, thirrësit e Islamit

(da'itë) filluan veprimtarinë e tyre të organizuar në qytetet e anës së Ho-rasanit.!

Mbështetja financiare për dijetarët dhe mësuesit

Ai ia kishte vënë obligim vetvetes për ta ngritur dhe fuqizuar fushën e arsimit dhe fushën e thirrjes islame, duke ndarë paga dhe buxheti shtetëror për kategorinë e dijetarëve, mësuesve dhe ata, që përçonin fetva. Pos kësaj edhe mësuesit e fëmijëve në qytetin e Medinës merrnin një pagë mujore prej 15 dërhëmësh, gjë që krijonte stabilitet financiar e ekonomik për këto personalitete të respektuara në shoqëri.

Ndërtimi i xhamive dhe organizimi i tyre

Umeri me vizionin e tij prej strategu, i shkroi dhe urdhëroi sahabi-un, Ebu Musa el-Eshariut r.a., në Basra (Irak) për të ngritur xhami për çdo fis dhe një xhami qendrore për faljet e namazit të xhumasë, ku të gjithë tuboheshin në një të vetme për të forcuar unitetin dhe radhët e muslimanëve. Përpjekja maksimale dhe përkushtimi i plotë për të arritur në shpjegimin dhe interpretimin e Islamit (*ixhtihad*) si dhe kuptimi i fesë (*fikhu*) kanë përbërë dhe krijuar një rol e etapë të jashtëzakonshme në sferën e predikimit islam përgjatë shekujve të parë, e sidomos ixhtihadi i Umerit r.a. që pati rol kyç në forcimin dhe përhapjen e themeleve të saj.

Në prag të kalimit në ahiret, halifi Ebu Bekër Es-Sidiku u përball me shqetësimin se pas largimit të tij mund të shpërthenin ndasi dhe tensione brenda bashkësisë myslimane. Për të shmangur një vakuum në radhët e institucionit udhëheqës dhe për të garantuar stabilitetin social në komunitet, ai e pa të arsyeshme të propozojë Umer b. Hatabin si pasardhës të tij në detyrën e halifit. Për këtë mendim, ai kërkoi mendimin e disa prej sahabëve më të njohur për dijen dhe devotshmërinë e tyre, si Abdurrahman b. Avfi, Osman b. Affani, Said b. Zejdi dhe Usejd b. Hudejri, përfaqësues nga radhët e muhaxhirëve dhe ensarëve. Pas diskutimeve të gjera, shumica e tyre dhanë mbështetjen për këtë zgjedhje, megjithëse disa shprehën rezerva për shkak të natyrës së rreptë dhe të drejtë të

Umerit. Në një rast, njëri prej sahabëve të pranishëm ia drejtoi pyetjen Ebu Bekrin: "Çfarë do t'i thuash Zotit kur të të pyesë përse zgjodhe Umerin si pasardhësin tënd?"

"E emërova përgjegjës mbi ta më të mirin nga mesi i tyre - do t'i them, u përgjigj Ebu Bekri r.a". Vetëm një ditë pasi që halifja Ebu Bekër ndërroi jetë, ai u varros afër Pejgamberit a.s, në anën tjetër masa vijonte të vinin në xhami tek Umeri r.a. për t'i shpreh besatimin dhe njohur si halife. Kjo ditë ishte 23 Xhumadel-Ahireh të vitit 13H (634). Kështu të gjithë myslimanët mbështetën njëzëri zgjedhjen e Umerit si halife të tyre. Pas vdekjes së Ebu Bekrit r.a., barra e drejtimit të shtetit islam dhe përgjegjësisë së predikimit të thirrjes islame ra mbi halifin e dytë të besimtarëve, Umer b. Hatabin. Krahas angazhimit të Umerit r.a. më ngritjen dhe fuqizimin institucioneve publike islame, ai nga ana tjetër po ashtu bënte përpjekje të përforconte edhe një rend vlerash në kuadër të një sistemi të mirë organizuar, që do ta mbështesnin thirrjen islame dhe komunikimit e mesazhit të Islamit kudo që ishte nevoja. Ai tashmë vetëm se kishte trashëguar nga halifja paraprak ngritjen dhe rritjen e zgjerimin duke ngritur e fuqizuar edhe më lartë drejt transformimit administratës publike dhe anës shpirtërore të sistemit të vlerave të mirë-fillta islame.

Në fokus të udhëheqjes ishin parimet e drejtësisë, barazisë dhe të thirrjes islame aktive për në Njësimin e Zotit fuqiptotë. Halifi Umer, që e trashëgoi Ebu Bekrin më 634, në fillim të sundimit të tij, u vetëquajt "*Halife i Halifit të të Dërguarit të Zotit*", por shpejt, ngaqë ky emërtim u konsiderua të ishte tepër i gjatë dhe i vështirë, ai vendosi të quhej thjesht "*Halife*", dhe që nga koha e Umerit, periudhë kjo e pushtimeve të mëdha, ky titull i thjeshtë filloi të merrte rëndësi aq të madhe. Umer b. Hatabi është si i pari udhëheqës mysliman që mbajti titullin "Emiru'l mu'minin" (udhëheqës i besimtarëve), dhe kështu ai vendosi një precedent në kuadër të strukturës politike dhe administrative të hilafetit islamë.

Duke studiuar personalitetin e Umerit r.a., dhe jetën e tij si publike ashtu edhe familjare lehtë është të arrihet tek përfundimi se ai shënoi

sukses dhe të arritura si në fushën ushtarake si komandant ashtu edhe në fushën e edukimit dhe daves. Karakterizohej me një vendosmëri dhe karakter të hekurt dhe mbrojtës i flakët i së vërtetës, kishte marr ofiqin nga vetë i Dërguari a.s. “El Faruk” që në përkthim d.m.th. (ndarës i të vërtetës nga gënjeshtër). Ky është personaliteti i halifit të dytë të besimtarëve. Njeri që ka urdhëruar për në drejtësi por drejtësinë e ka pas moto të jetës me të gjithë pa dallim besimi apo race. Faqet e historisë ndajnë mjaftë raste ku njerëz në saje të drejtësisë së Umerit kanë përqaftuar vlerat e Islamit. Kjo cilësi e tij përbente një pikë qendrore në përqaftimin e Islamit nga jo myslimanët sikur që ishte poashtu edhe një nga karakteret më të forta dhe më të rëndësishme të daves.

Umeri ishte nga fisi i Adi b. Ka’bit, që ishte një ndër dhjetë fiset fisnike të kurejshëve dhe dallohej për diturinë, urtësinë dhe intelektin e tij. Dituria dhe urtësia e këtij fisi bëri që shumë pjesëtarë të tij të mbajnë pozita të ambasadorëve në qytetet e tjera dhe të arbitrave në konflikte. Babai i Umerit, ishte udhëheqësi fisi, që shquhej për inteligjencë, respekt dhe guxim. Halifja Umer. r.a., u lind më vitin 586. Ai nga radhët e njerëzve të pakët të kurejshitëve që arriti të mësoj dhe lexoj.

Kur Muhamedit a.s. filloi t’i zbriste revelata sipas arkivave historike atëherë ishin vetëm 17 persona që dinin leximin. Umeri r.a po ashtu kishte një fizik të fortë dhe këtë aftësi fizike e kishte përdorur gjithnjë në drejtësi dhe për mirëqenien e njerëzimit, sikurse që shquhej si kalorës i pamundshëm dhe këtë ia ofronte gjatësia dhe forca e tij.

Sipas historianit Ibn Is’haku, gjenealogjia e Umerit duket kështu: “Ai ishte, Umer b. el-Hattab b. Nufejl b. Abdil-Uzza b. Rijah b. Abdullah b. Kart b. Rezah b. Adijj b. Ka’b b. Lu’ej b. Galib, Emiru’l mumininë, Ebu Hafs el Kureshi el Adevi, el faruk. Nëna e tij quhej Hajthema bint Hisham b. Mugire b. Abdullah b. Amr b. Mahzum”, . Hz Umeri u lind 13 vjet pas ndodhisë së Elefantit. Ishte nga pjesëtarët e udhëheqësisë së Mekës. Ai ka qenë ambasador i Kurejshëve. Kështu në rastet kur zhvillohej ndonjë luftë ndërmjet tyre apo ndonjë fisi tjetër e dërgonin për bisedime. Umeri tregoi mosdurim dhe urrejtje të madhe për daven e Muhamedit

a.s. kur filloi ta përhapte në Mekë por edhe ndaj muslimanëve të rinj. Mirëpo drita e së vërtetës ishte më e fortë se ndjenja e urrejtjes që e kishte kapluar andaj ai është një nga ata sahab që ka përqafuar Islamit që herët. Ai kaloi në Islam që në vitin e gjashtë të fillimit të shpalljes, ku atëherë sipas mendimit të Ibn Xhevziut i kishte 27 vjet, kurse sipas Imam Sujutiut kishte afro 35 vjet. Në këtë periudhë Islamit e kishin përqafuar katër dhjetë burra dhe njëmbëdhjetë gra dhe lajmi i pranimit të islamit nga Umeri jashtëzakonisht gëzoi muslimanët dhe ai lajm mori dhenë.

Transmetohet nga Davud b. Husejni se dhe Ez-Zuhri të këndë thënë: Pasiqë Umeri e përqafoi Islamit, zbrit melek Xhibril dhe tha: “O Muhammed! Gëzim i madh është në mesin e banorëve të qiellit me rastin e kalimit të Umerit në Islam”]. Ndërsa sahabiu tjetër, Abdullah b. Mes’udi paskësh thënë: Që nga dita kur Umeri kaloi në islam, ne kemi patur ndjenjën e të qenurit më të fortë. Ejjub b.Musa thuhet se i Dërguari a.s. ka thënë: Zoti xh.sh. vendosi të drejtën në gjoksin e Umerit r.a.. Umeri është Faruk, ngase me të i Lartësuarin ndanë të drejtën të vërtetën(hak) nga e kota (batili). Ukbete b. Amiri transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: Ka patur para jush njerëz, të cilët frymëzonin pa qenë të dërguar? Epo qëse ka të tillë në mesin tuaj, ai është Umeri., Ai është në mesin e dhjetë të përgëzuarve me xhenet dhe njëri ndër katër halifët e drejtë dhe njëri nga dhëndurët e Muhamedit a.s. si dhe njëri nga më të diturit nga radhët e sahabeve si dhe më esoterik. Përqafimi i Islamit nga ana e Umerit r.a. përfundimisht arriti të ndryshoj edhe kahen e thirrjes islame si në radhët e besimtarëve por edhe në vetë qytetin e Mekës.

Islami i tij përbën një rol të ri në kuadër të thirrjes islame pasiqë arriti të dalë nga etapa e periudhës së fshhtë të thirrjes islame dhe kalimi në periudhën e thirrjes publike dhe kjo shënon një risi dhe përbën një forcë shtesë në kuadër të misionit të komunikimit të Islamit. Me kontributin dhe angazhimin e tij arriti të ruaj institucionin e shtetit dhe institucionin e thirrjes islame. Ndhimoi davetologjinë, duke lënë trashëgimi në fushën e daves, duke transmetuar 539 hadithe nga Muhamedi a.s.

Hazreti Umeri r.a. u martua me disa gra, si: Zejneb bint Madh'in r.a., e cila e lindi Hafsane (gruan e të Dërguait a.s.), Abdurrahmanin dhe Abdullahun, kurse më pas arriti të martohej me Xhemile bint Thabit b. Ebi el-Aklah el-Ensarije, e cila i lindi djalin, Asimin. Më vonë u martua me Atike bint Zejd b. Amr ibn Nufejl b. Adij, e cila i lindi Ijadin. Në mesin e grave që u u martua me to ishte edhe Umu'l Kulthum vajza e Ali b Ebi Talibit që me të pati edhe dy fëmijë: Zejdin si dhe Rukijen.

Umeri ishte model në sjellje dhe moral për predikuesit e Islamit

Tregon Ibn Umeri se kur Umeri r.a. shfaqte nervozizm, poqëse afër tij gjendej dikush që të kujtonte Krijuesin, apo do ta frikësonte duke ia kujtuar atij ndëshkimin e rreptë nga Zoti xh.sh., apo nëse lexohej ndonjë ajet i Kuranit, ai menjëherë do tu largonte nga ajo, që kshihet menduar se do ta bënte. Esmaiu rrëfen se disa besimtarë shkuan ta takonin Abdurrahman b. Afi r.a, dhe iu lutën që të shkonte njëherë tek Umeri r.a. ku t'i kërkonte të shfaqte sjellje më të buta me masën. Ata madje i kujtuan se edhe vajzat pas perdes ndjenjë frikë nga zëri i Umerit. Kur Abdurrahman b. Afi ia përcolli Umerit r.a. këto brenga, vetë Umeri r.a. iu drejtua: "Për Zotin, sikur ta dinin ata sesa shumë dhembshuri dhe mëshirë ushqej unë ndaj tyre, në të vërtetë, ata do të m'i kishin marrë edhe këto rroba, që kam në trup." Për karakterin dhe personalitetin e tij të fuqishëm, Sead b. Vekasi transmeton se Muhamedi a.s. në një rast iu drejtua Umerit: "Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im në qoftëse se ti je në një rrugë, djalli i do ta shmangte atë rrugë në të cilën ecë ti." Pos kësaj Umeri r.a. nuk tregonte ashpërsi në çdo çështje. Rreptësia e tij nuk prekte fundin e gjërave po shërbente si mjet në shërbim të interesit kolektiv e daves islame dhe në këtë aspekt më mirë do të ishte të quhej vendosmëri e përpiktë.

Transmetohet nga Abdullah b. Umer se i Dërguari a.s. thoshte: "Më i vlefshmi brenda umetit tim është Ebu Bekri. *Më i vendosuri (ashpëri) në çështjen e Allahut është Umeri. Më i ndrojturi prej tyre është Uthmani. Më i*

dijshmi në këndimi e Kuranit është Ubej b. Ka'bi. Më i dijshti në cështjet e trashigimisë shquhet Zejd b. Thabiti. Kurse më i dijshti në cështje të hallallit dhe haramit është Muadh b.Xhebel. Dije se çdo umet ka amanetin e vet, dhe amanetmbajtësi i këtij umeti është Ebu Ubejde el-Xherrah.” Umeri r.a. si personalitet gëzonte disa veçori të rralla si në: drejtësi, menaxhim, kreativitet, përgjegjësi sociale, drejtësi, etj, dhe ajo, që e karakterizonte si kriter vendimtar, ishte imani i tij i patundur, i cili dominonte mbi sjelljen, mendimet, e emocionet. Ai kishte një natyrë “ushtarake” që në formën më të përsosur është çelësi më i vërtetë për të kuptuar personalitetin e Umerit, bazuar në gjithçka që përcillet dhe japin studimet mbi figurën e tij. Shfaqte guxim, përpikëri, sinqeritet, rigorozitet, xhelozit për ruajtjen e çështjes së nderit, ndihmonte të tjerët kishte besimin e thellë në të drejtën dhe synonte rezultate në kuadër të fushës së përgjegjësisë së tij.

Kalimi në Islam mbështetje e madhe e thirrjes islame

Muhamedi a.a ishte lutur që thirrja islame të forcohej me njërin nga dy burrat më me ndikim ndër mekasit e asaj kohe, Hamzën apo Umerin. “O Zot, përforcoje Islamit me njërin prej këtyre dy burra që janë më të respektuarit tek Ti.” Islami i Umer b. Hatabit r.a. ishte një shpallje për hyrjen e thirrjes islame në një epokë të re; ajo ishte epoka e dinjitetit, fuqisë dhe madhësisë. Kjo mund të argumentohet me disa fakte të tvijim. Transmetohet nga Suhejb Rrumi, r.a., i cili kishte thënë” Kur Umeri kaloi në Islam, feja u përforcua dhe ftesa për të ishte publike. Ishim të ulur përballë Qabesë në grupe njerëzish,, kryejtëm Tavafin rreth Qabesë dhe u mbronim nga ata që na keqatrajtonin. Por edhe arrinim që t’i kthejmë disa sulme të tyre.” Kurse në lidhje më këtë cështje sahabiu tjetër Abdullah Mes’udi thoshte: “Përqaftimi i Islamit nga ana e Umerit shënonte një fitore, kurse emigrimi i tij refketonte ndihmë dhe qeverisja e tij prodhonte mëshirë.”

a./ Forcimi i faktorit islam dhe islami publik

Përqafimi i Islamit nga ana e Umerit r.a. shkaktoi një valë kënaqësie dhe guximi si dhe ofroi një forcë emocionale e morale në ballafaqim me faktorin apo me kampin e pabesimtarëve. **Emri dhe karizma e tij krijonte qëndrueshmëri dhe autoritet, gjë që impresiononte, si dhe frymëzonte kampin mysliman dhe kauzën e tyre.** Me kalimin e Umerit në Islam, tanimë ishin pjekur kushtet, që thirrja islame të kalonte në fazën e organizimit sekret e thirrje sekrete në fazën e organizimit sekret dhe thirrje publike. Ky element bëri që Umeri t'i prijë myslimanëve dhe për herë të parë të arrijnë të organizohen e të falen publikisht në Qabe, dhe kjo përkthehet si sfidë e hapur ndaj kurejshëve, të cilët ishin shndërruar në gogol mbi jetën e myslimanëve.

b./Koncepti i drejtësisë reflektoi frikë tek idhujtarët

Personalitetin e vet, Umeri, r.a, e kishte sendërtuar mbi bazën e drejtësisë dhe ndershmerisë, që më pas kjo prodhoi një model të sjelljes si dhe shtrirjes së vlerave të tilla edhe në krahun tjetër të shoqërisë mekase.

S'do mend se kjo çështje shkaktoi një lloj pasigurie në radhët e idhujtarve, sepse ata e dinin mirë fuqinë e figurës së halifit të myslimanëve, Umerit.r.a.. Pranimi i Islamit nga Umeri ishket shkak që të ulej dhuna e presioni i paparë mbi myslimanë. Faktikisht kjo edhe solli dobësim në mesin e idhujtarëve kurse ishte një rreze shprese për frymim mët ëlirë të thirrjes islame e sidomos në takimt dhe bisedat që zhvilloheshin me mysafirët që vinin në Meke për vizitë Qabesë.. Kur Umeri dëshironte të urdhëronte diçka ose të ndalonte diçka, që kontribuonte në dobinë dhe suksesin e shoqërisë islame, ai fillonte së pari me familjen e tij. Me kujdes dhe seriozitet trajtonte zbatimin e këtyre urdhrave në shtëpi, duke u dhënë atyre mësim dhe duke i kërcënuar me pasojat e kundërshtimit të tij. Salim b. Abdullah b. Umer, thoshte: “Në ligjërimet e tij në mimber, Umeri kur shihte një te keq e ndalonte me ligjërim publik, dhe këtë e bënte edhe në mesin e familjes së tij dhe ua bënte t qartë për pasojat e

veprimit ët një të keqe. Po betohem me Allahun, nëse gjej dikë prej jush, që e ka bërë, do t'ia shtoja dënimin.” Ky veprim dëshmon mençurinë dhe thellësinë e kuptimit të Umerit për rolin e tij si udhëheqës. Ai e kuptonte se njerëzit vlerësojnë besueshmërinë dhe autoritetin e një udhëheqësi në bazë të veprimeve dhe sjelljes së tij të përditshme, veçanërisht në lidhje me ata, që janë më të afërmit, si familja. Kështu, ai krijoi një shembull të fortë dhe të qartë për ndjekësit e tij, duke treguar që gjithçka, që kërkonte nga shoqëria, duhej të fillonte nga familja e tij, e cila ishte modeli i parë i zbatimit të etikës dhe të parimeve islame.

Udhëhoqi familjen përpara njerëzve të tjerë

Duke studiuar figurën e Umerit r.a. gjejmë se nga karakteristikat më të theksuara të vizionit përkushtimit dhe mençurisë së tij në udhëheqjen dhe drejtimin e shoqërisë ishte prioriteti dhe fokusi i tij i veçantë në familjen e tij. Kur Umeri dëshironte të urdhëronte myslimanët për diçka, siç mund të ishte ndalimi i një veprimi të caktuar përmirësues për umetin, fillonte me familjen e tij. I mbante afër dhe i udhëzonte për të zbatuar rregullat, që do të vinin më pas për shoqërinë. Ky ishte një proces i mençur, i cili tregon përgjegjësinë e një udhëheqësi për veprat e tij personale dhe ndikimin, që ai do të kishte në familjen dhe ndjekësit e tij. Ibn Salimi b. Abdullah b. Umeri, tregon se kur Umeri ngjitej në minber dhe ndalonte ndonjë veprim, mbledhte familjen dhe thoshte: “ Unë ua ndalova njerëzve këtë e këtë veprim. Masa ju shikon juve dhe iu pason mu ashtu siç shpezët që iu turren mishit, andaj nëse dikush nga ju bën një veprë negative ndaj tyre o të pasojë dënimi i dyfishtë.”

Ky qëndrim i Umerit r.a. pasqyron një udhëheqje të qëndrueshme, të bazuar në integritet dhe unifikim të veprimeve të brendshme dhe të jashtme, duke nënkuptuar se një lider duhet të jetë shembull i drejtpërdrejtë për ata, që i drejton.,,

Jeta e Umerit r.a. ishte model për një thirrës si nga tiparet e tij që kishte jashtë me masën po ashtu edhe brenda gjirit familjar.. Ai karakterizohet me një përvujtëri të plotë ndaj Krijuesit, e cila nuk ishte e ndikuar

nga fuqia, pozita ose nderimi, që gëzonte si udhëheqës i myslimanëve. Guximin, forcën dhe qëndrueshmërinë e tij ndaj parimeve islame e dinin mirë armiqtë e tij. Por nga ana tjetër, Umeri r.a. kishte edhe tiparet e njeriu të kujdesshëm, butë, i dashur e i afërm me njerëz dhe pranonte edhe kritikën konstruktive dhe në këtë aspekt ka trashëguar shumë shembuj të mirë në përballje me kritikët: “Ata që më tregojnë dobësitë e mia, mbeben individët më të dashur tek unë”. Ky mendim flet për shpirtin e tij të ndershëm dhe gatishmërinë për të përmirësuar veten e tij, përpara Allahut. Me këtë Umeri deshi të përçon mesazhin se fuqia e tij e brendshme dhe devotshmëria ndaj Allahut ishin ato, që e bënë të fortë dhe të respektuar, ndërsa përvujtëria ishte çelësi i udhëheqjes së tij të vërtetë.

Qëndrueshmëria dhe mençuria e tij në komunikimin e Islamit

Karakteri i Umerit r.a. segmentohej në vlerën e bindjes ndaj mësimave të shëndosha islame duke refuzuar asabsolutisht nënshttrimin ndaj veseve dhe traditave të këqija për hirë të aparençës së përkohshme. Kjo gjë atij nuk i bënte përshtypje fare në raport me primet hyjnore. Kur kaloi pranë Xhabijës në rrugën për në Iliá (Jerusalem) dhe qëndroi me njerëzit atje, disa i thanë: “Ti je mbreti i arabëve dhe kjo është një tokë ku devetë nuk janë të përshtatshme. Sikur të vishje rroba më të reja (duke aluduar në këmbësorë e arnuar që veshte ai) e pse edhe mos të kalëroje mbi një kalë shumë herë më të fortë dhe më të bukur. Kështu do të ishte më i madh në sytë e romakëve.” Por Umeri r.a. u përgjigj: “Neve si popull na ka nderuar Allahu me islam. Nuk kërkojmë asgjë tjetër për nderë nderim. Kafsha me të cilën udhëtonte Umeri, u lodh atëherë i sollën një kalë të bukur dhe e hipën mbi të. Por kur kaloi filloi të ecë në mënyrë krenare, Umeri u tha atyre, që ishin me të: “Ndal, ndal!” Më pas, zbriti nga kalë, e goditi lehtë në fytyrë dhe tha: “Mos e mësoftë Allahu atë, që të ka mësuar ty! Kjo është prej mendjemadhësisë. Nuk e kisha menduar se njerëzit do të hipnin mbi djajtë. Ma sillni devenë time! Dhe kështu zbriti nga kalë, hipi përsëri mbi devenë e tij dhe nuk hipi më mbi një kalë

të tillë.” Në këtë vazhdë, Umeri r.a., ndodhej në një vend me ujë (lumë apo kënetë). Zbriti nga deveja e tij, hoqi këpucët, i mbajti me dorë dhe kaloi nëpër ujë, duke tërhequr devenë pas vetes. Ebu Ubejde r.a., me këtë rast thoshte: “Sot ke bërë diçka të madhe në sytë e njerëzve të tokës; ke bërë këtë dhe atë” (duke nënkuptuar veprimin si të pavend për një lider). Umeri u ndje keq nga kjo sjellje dhe papritur e goditi lehtë atë në gjoks duke i thënë: Ah, sikur tjetër kush ta thoshte këtë thënie, o Ebu Ubejde! Ju ishit individët më të ulët, dobët dhe shumë herë më të vegjël. Pastaj Allahu ju nderoi me Islamin. Dhe kurdoherë që kërkonti madhështi (krenari) jashtë Islamit, Allahu do t’ju poshtërojë.”. Ky tregim pasqyron bindjen e thellë të Umerit për fuqinë dhe madhësinë, që buron nga Islami, duke i kujtuar të tjerëve, se nderi dhe fuqia e vërtetë janë të lidhura vetëm me Islamin. Ky qëndrim tregon për përvullësinë dhe thjeshtësinë e Umerit, duke refuzuar çdo shenjë mendjemadhësie ose krenarie të rremë, që mund të vinte nga përdorimi i një kali të bukur për zbukurim apo imponim. Ai qëndroi i përkushtuar ndaj modestisë islame, duke e parë atë si një vlerë të rëndësishme në jetën dhe udhëheqjen e tij.

Fjalimi i parë i Umer b.Hatab-it r.a.si halif

Pasi u zgjodh në pozitën e udhëheqësit të myslimanëve, Umeri mbajti fjalimin e tij të parë publik, që për shumë predikues duhet të jetë model në komunikimin e tyre para masës-xhematit. Ai iu drejtua njerëzve, duke thënë: “O ju njerëz! Jam informuar që ju frikësoheni prej meje. Dëgjoni fjalën time. Kur isha me Pejgamberin a.s. isha robi dhe shërbëtori i tij, e Pejgamberi a.s. ishte njeriu më i butë dhe bujar. Mendova ta vendosja ashpërsinë time pranë butësisë së Pejgamberit a.s., të isha shpatë e zgjatur në dorën e tij; nëse dëshironte, më nxirrte nga këllëfi e nëse donte, më linte. Ai veptoi si deshi e unë isha ashtu tërë kohën pa ndryshuar, derisa e mori Allahu. Ai vdiq i kënaqur me mua. Pas tij erdhi Ebu Bekri. Unë isha shërbëtori dhe krahu i tij. Thashë të bashkoja ashpërsinë time me butësinë e tij. Këtë e bëra qëllimisht. Isha shpatë e zgjatur në dorën e tij; nëse dëshironte, më nxirrte nga këllëfi e nëse dëshironte, më

shtinte në këllëf. Isha kështu derisa e mori Allahu e ai ishte i kënaqur me mua. Kurse tani, kur unë jam Halifi juaj, dijeni që ajo ashpërsi është dobësuar, por duhet ta dini, që këtë ashpërsi timen do ta tregoj sërish kundër të gjithë mizorëve dhe të padrejtëve. Nuk do t'u hap rrugë të padrejtëve mbi të dobëtit. Pasha Allahun, nëse dikush nga të padrejtët cenon dikë nga të drejtët dhe fetarët, do ta vendos faqen e tij në dhe, pastaj do t'ia vë këmbën time mbi faqe, derisa të marr hak. Pastaj do ta vendos faqen time në dhe, që mbi të, të shkelin të drejtët, fetarët dhe të dobëtit, si mëshirë e butësi ndaj tyre. Ju keni tek unë çështje, për të cilat e kam kushtëzuar vetën në dobinë tuaj. Së pari, të mos marr prej jush pasuri për vete dhe për familjen time. Së dyti, t'u shtoj pasurinë dhe rrëskun. Së treti, të mos ju dërgoj shpesh në luftëra. Nëse ju dërgoj, unë do të jem në vend të babait të fëmijëve tuaj dhe të familjeve tuaja. Së katërti, ju mund të më urdhëroni në të mirë e të më ndaloni nga e keqja. Më këshilloni, ngase do të ankojem tek Allahu në Ditën e Kiametit!" Në këtë çast të gjithë ata, që ishin në xhami thanë "Allahu ekber". Unë jam vetëm njëri prej jush, përveçse Allahu më ka vënë mbi supë një barrë më të rëndë. si dhe.... Ky fjalim përshkruan drejtësinë dhe vendosmërinë e Umerit, duke reflektuar qasjen e tij në qeverisje, e cila karakterizohej nga barazia, drejtësia dhe zbatimi i fuqishëm i ligjeve të Zotit. Po ashtu ky fjalim publik vuri baza të rëndësishme. Pika e fundit në fjalimin e tij ishte që nëse nuk e urdhëronin në të mirë, nuk e ndalonin nga e keqja dhe nuk e këshillonin, do të ankohej tek Allahu xh.sh.. Ndjenja e përgjegjësisë së hazreti Umerit dhe vetëdijesimi gjithnjë për llogaridhënien para Allahut xh.sh. në Ditën e Gjykimit bëri, që të jetë i saktë dhe shumë i ashpër në ndërmarrjen e ndonjë veprimi. Umeri ishte shumë i kujdesshëm, veçanërisht në emërimin e liderëve. Liderët e zgjedhur nga Umeri ishin shumë të kujdesshëm. Ai kishte zakon të testonte performancën e guvernatorëve (*valinjve*) të tij, duke i emëruar në baza *ad-hoc* për dy apo tre muaj para emërimit të tyre të rregullt. Po ashtu ishte gjithashtu shumë i angazhuar për kualitet të lartë, nëse jo performance perfekt në çdo veprim të jetës. Namazin nuk e fillonte derisa të sigurohej që të gjithë

njerëzit prapa tij ishin në vijë të drejtë, dhe kishte caktuar një person të veçantë për këtë detyrë. Thënia e mësipërme tregon, që Umer el Faruk ishte i ashpër vetëm për hir të fesë së Allahut. Veç kësaj, Umeri vërente pak butësi në udhëheqësin e tij, Ebu Bekrin dhe dëshironte të ekuilibronte atë, me ashpërsinë e tij. Në fakt, Ebu Bekri iu përgjigj Abdurrahman b. Avfit, duke i thënë: “Ai vepron kështu (është i ashpër) pasi që sheh që unë jam i butë, dhe nëse më pason mua, do të heq dorë nga një pjesë e madhe e saj (e ashpërsisë)”. Ky argument është përsëritur nga vetë Umeri gjatë fjalimit të tij të inaugurimit, kur tha që ashpërsia e tij do të ulej. Gjithashtu tha që ashpërsia do të mbetej sa i përket mëkatarëve dhe të ligjve, megjithatë do të jetë më i butë me njerëzit e mirë dhe të sinqertë sesa ata janë me njëri-tjetrin. Gjatë lidërshiptit të tij, Umeri shfaqti nivel të lartë shpirtbutësie ashtu siç ishte zotuar. Në të vërtetë, ishte shumë i ekuilibruar në trajtimin e tij me njerëzit. Është transmetuar se ka thënë: “Mos jeni të butë deri në atë pikë, që të shtrydheni, dhe të mos jeni të ashpër deri në atë pikë sa të jeni të shkatërruar”. Umeri ishte trim dhe i guximshëm. Guximi i tij është demonstruar qartë gjatë betejave, në të cilat mori pjesë, qofshin ato para apo pasi që u bë mysliman. Gjithashtu, ai deklaroi Islamin publikisht, duke sfiduar kështu tiraninë e kurjeshve. Si halife i myslimanëve që ishte, namazin e kuptonte si çështje prioritare për secilin predikues, në mënyrë që edhe ata të jenë shembull për rrethin ku jetojnë dhe veprojnë. Përpos namazeve farze, Umeri r.a. falte edhe shumë namaz nate (*nafile*). Eslemi tregon se Umri r.a. sa kishte mundësi, natën e kalonte, duke falur tehexhud (namaz nate); mandej gjysmën tjetër të natës i zgjonte edhe pjesëtarët e tjerë të familjes, duke thënë: ‘namazi!.. “veç kësaj, u këndonte atyre ajetin; “*Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet. Dhe...*”.

Ndërtimi i institucioneve të shtetit Islam dhe fuqizimi i daveit

Umeri r.a. themeloi qeverisjen e parë sistematike Islame, duke arritur të organizojë provinca dhe duke emëruar valinj të ndershëm e të devotshëm. Ndau shtetin në rajone të mirë administruara, duke siguruar, që mesazhi Islam me efqiencë të transmetohej me drejtësi dhe pa korrupsion. Kjo organizim ishte një bazë e rëndësishme për shpërndarjen e mësimave Islame në territoret e pushtuara nga myslimanët. Shembujt historik tregojnë, që mbante nën mbikëqyrje të afërt punën e tyre dhe i ndëshkonte ata, që e tepronin ose vepronin në kundërshtim me ligjet e drejtësisë Islame. Kjo disiplinë e fortë administrimi siguroi mbështetjen e shoqërisë për thirrjen Islame, si një model drejtësie dhe mirëqenieje. Gjatë periudhës së sundimit të tij për herë të parë u bë regjistrimi i popullsisë. Po ashtu në këtë periudhë u formua institucioni i komunitetit “*el hisbe*” e cila mbronte të drejtat e konsumatorëve nga keqpërdorimi i tregtarëve. Me këto hapa dëshironte të vendoste sistem, i cili do të reflektonte jetësimin e Islamit në praktikë.

Krijimi i regjistrave (divanit) forcoi fushën e predikimit të Islamit

Gjatë periudhës së sundimit të tij, Umeri r.a. në kuadër të konsolidimit dhe ngritjet e institucioneve shtetërore Islame me vizionin e tij largpamës, reformoi dhe themeloi librin e regjistrave ose siç njihet në terminologji Divan, i cili në vete ishte një sistem regjistrash për administrimin e burimeve financiare shpërndarjen e zekatit e ushqimeve në përputhje me sheriatin. Ky sistem ekonomik garantonte shpërndarjen e barabartë të të mirave materialeve-burimeve dhe siguronte financimin e ngritjes dhe forcimit edhe të fushës së predikimit të islamit. Divanin e Shamit e shkroi në gjuhën romake. Divanin e Irakut në gjuhën perse dhe kështu kishte vazhduar deri në kohën e Abdulmelik b.Mervanit në Sham

dhe Haxhaxh b.Jusuf në Irak, pasi që në të dy vendet, Divanet u shkruan në gjuhën arabe.

Përhapja e Islamit në territore të reja dhe caktimi pagë atyre që merren me predikimin e Islamit

Umeri r.a. me vizionin e tij prej një udhëheqësi strategjik, synoi që thirrja islame të depërtojë edhe te popujt e tjerë, që edhe ata të shijojnë frytet e mesazhit të fundit si dhe për të ofruar një çlirim shpirtëror. Kështu gjatë sundimit të tij, shteti Islam u zgjerua në drejtim të Persisë, vendeve të Shamit dhe të Egjiptit. Në këto territore, vendosi administratorë dhe dijetarë (thirrës) për të mësuar popullatën e re mbi Islamin dhe vlerat e tij. Në këtë drejtim, guvernatorin e Egjiptit, sahabiun Amr b. el Asi dhe Halid b. Velid-it në drejtimin e Shamit i urdhëroi që objektivi kryesor i tyre të jetë në thirrjen Islame dhe të ofrojnë Islamin për popullatën vendase në formën më të mirë dhe të favorshme dhe të respektoheshin besimet e komuniteteve të tjera.¹ si dhe². Në vitin 14 h u çlirua Damasku, më 15 h u çlirua Jordania, 20h Egjipti, 22h Azerbejxhani etj. Umeri r.a., ndërtoi një sistem ekonomik të fuqishëm përmes zekatit dhe financimit të mirëfilltë të aktiviteteve, që mbështesnin da'ven. Krijoi një fond të veçantë për thirrësit Islam dhe për njerëzit që sapo kishin përqaftuar Islamin, duke siguruar mbështetje për ta në fazat e para të edukimit islam. Në këtë aspekt, siguroi respekt dhe mbështetje për jo-muslimanët në territoret e sapo pushtuara. Gjatë këtyre zgjerimeve, promovoi politikën e tolerancës ndaj jo-muslimanëve, duke garantuar lirinë e besimit dhe duke i inkurajuar të mësonin për Islamin përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me dijetarët myslimanë. Marrëveshja e tij me banorët e Jerusalemit në vitin 638 (15h) tregon qasjen e tij paqësore dhe përkushtimin për mbrojtjen e të drejtave të popullatës lokale. Ja teksti i marrëveshjes.

¹ Ahmed b. Jahja el-Beladhuri, *Futuhu'l-Buldan* (Bejrut: Mektebetu'l-Hilal, 1988), f.79.

² Ahmed b. Ali b. Abdulkadir Ebu'l-Abas el-Husejni Tekijudin el-Makrizi, *El-Mevazi ve'l-Itibar bi Dhikri'l-Hitati ve'l-Athar* (Bejrut: Daru'l-Kutub el-Ilmije, 1998), f.160.

Me emrin e Allahut, të Gjithë mëshirshmit, Mëshirëplotit

Ky është dokumenti që shërbëtori i Allahut, Umer bin Hatabit, udhëheqësi i besimtarëve, u ka dhënë banorëve të Elia-s (Jerusalemit), duke u garantuar atyre siguri për: Veten e tyre, pasuritë e tyre, kishat e tyre, kryqet e tyre, për të sëmurët dhe të shëndetshmit prej tyre, si dhe për të gjithë komunitetin e tyre. Sipas këtij dokumenti, kishat e tyre nuk do të banohen nga myslimanët dhe nuk do të shkatërrohen. Nuk do të pakësohet asgjë prej tyre, prej pronave të tyre, prej kryqeve të tyre, apo prej pasurive të tyre. Nuk do të detyrohen të ndryshojnë fenë dhe askush prej tyre nuk do të dëmtohet. Asnjë hebre nuk do të lejohet të banojë bashkë me ta në Jerusalem. Në këmbim, banorët e Jerusalemit do të paguajnë taksën e caktuar (xhizja) njësoj si banorët e qyteteve të tjera. Ata janë të detyruar të largojnë nga qyteti romakët dhe elementët kriminalë. Ai që largohet, do të jetë i sigurt për jetën dhe pasuritë e tij derisa të arrijë në një zonë të sigurt. Ai që qëndron, do të jetë i sigurt dhe do t'i nënshtrohet kushteve të njëjta si banorët e Jerusalemit. Ata që dëshirojnë të ndjekin romakët, mund ta bëjnë këtë, duke marrë me vete pasuritë, kishat dhe kryqet e tyre, pa pengesë, derisa të arrijnë në vendin e sigurt. Banorët lokalë, që ndodheshin në Jerusalem para konfliktit mund të: Qëndrojnë, duke iu përmbajtur kushteve të njëjta, si banorët e Jerusalemit. Ndjekin romakët. Kthehen në vendlindjet e tyre. Nuk do t'u merret asgjë derisa të përfundojnë të mbjellat e tyre. Ky dokument është i garantuar me: Besëlidhjen e Allahut, Amanetin e të Dërguarit të Allahut, Amanetin e halifëve dhe të gjithë besimtarëve, me kusht që banorët e Jerusalemit të përmbushin detyrimet e tyre për taksën e caktuar (xhizja).

Prezent gjatë kësaj marrëveshjeje ishin sahabët e medhenj, si Halid b.Velidi, Amr b. el-As, Abdurrahman b.Auf dhe Muavije ibn Ebi Sufjan. Kjo marrëveshje mbetet një prej dokumenteve të para ndërfitare në historinë islame. Kjo tregon një qasje tolerante dhe thirrje të drejtpërdrejtë drejt paqes dhe dialogut. Ky model frymëzoi shumë njerëz të përqafonin Islamin. Faktikisht kjo marrëveshje dhe kjo formë e komunikimit me të tjerët duhet të jetë model për gjuhën dhe veprimet e thirrësve në misio-

nin e tyre, duke mos tejkaluar caqet dhe mbillet urrejtje mes pjesëtarëve të komuniteteve fetare. Ushtria Islame nën drejtimin e halifit, Umeri, shërbeu jo vetëm për zgjerim territorial, por edhe si mjet për të përçarur mesazhin e drejtësisë dhe paqes Islame. Ai inkurajoi shpërndarjen e mësimëve Islame mes ushtarëve për të siguruar, që fushatat ushtarake ishin të ndërtuara mbi parime Islame. Disa burime historike përmendin se në territore të reja si Persia dhe Egjipti, forcat myslimane nën Umerin preferonin të arrinin marrëveshje paqësore me popullsinë vendase, duke i inkurajuar të pranonin Islamin, jo me forcë, por me bindje. Përmes politikave të tij të tolerancës, Umeri r.a. siguroi që jo-muslimanët nën qeverisjen Islame të kishin të drejta të barabarta dhe mbrojtje të plotë. Taksa e caktuar (*xhizja*) konsiderohej si një formë solidariteti ekonomik për ata që zgjidhnin të mos përqafonin Islamin. Kjo qasje largoi paragjykimet dhe afroi shumë njerëz drejt Islamit. Mes tjerash që la trashëgimi dhe porosi predikuesve të Islamit (daves) është edhe kjo perlë e hazreti Umerit r.a. *“Mos shikoni në namazin e askujt, dhe as në agjërimin e tij, por shikoni atë që, kur flet, është i sinqertë, kur iu besohet diçka, e përmbush atë, dhe kur ndodhet përballë një dëshire, e shmang atë.”* Prandaj, Umeri r.a., po ashtu, duke paralajmëruar ata, që injorojnë punën e tyre dhe nuk japin mundim me pretendimin se ata janë nga ata, që besojnë në besim të plotë: *“Ju nuk mbështeteni në Allahun, por në pasurinë e të tjerëve. Të vërtetët që mbështeten te Allahu janë ata që hedhin farën në dhe pastaj mbështeten tek Allahu.”* Në një ditë, njëri nga ata e lavdëroi një person tjetër në praninë e Umerit r.a. dhe Umeri e pyeti nëse kishte udhëtuar bashkë me të, kishte jetuar pranë tij ose kishte punuar me të në një biznes. Ky person iu përgjigj “jo” për çdo pyetje. Atëherë Umeri r.a. i tha: *“Për Allahun, ti nuk e njeh atë.”* Ai bënte një jetë tejet interesante, që gjithnjë e ka mbajtur të lidhur me gjithmonë me natyrën dhe sjelljet e një individi, nivelin e tij shpirtëror dhe marrëdhëniet me të tjerët. Ai besonte se këto aspekte tregojnë nëse një person ka një karakter të shëndetshëm apo jo. Duke u shprehur në këtë mënyrë, Umeri r.a. tha: *“Më të dashurit për ne janë ata që, derisa nuk i shohim, kanë emrin më të*

mirë. Kur i shohim, më të dashurit për ne janë ata që kanë moralin më të mirë. Kur i vlerësojmë, më të dashurit për ne janë ata, që janë më të sinqertët në fjalë dhe më të mëdhenjtë në mbajtjen e amanetit.”

Ndihma ndaj të konvertuarve në Islam

Një ndjesi të veçantë Umeri në kuadër të administrimit të shtetit Islam shfaqti edhe më një kategori njerëzish të cilët e përqafonin Islam. Ai arriti të siguronte mbështetje të veçantë për të sapo konvertuarit, duke ofruar arsimim Islam dhe mbështetje ekonomike. Kjo masë përmirësoi besimin dhe përkushtimin e tyre ndaj Islamit. Po ashtu në këtë kuadër, dërgoi edhe 2 mësues dhe dijetarë në territoret e reja për të përhapur mësimet Islame. Për shembull, caktoi Uthman b. Affanin të shpërndante dijen Islame në Basra dhe Kufa, ndërkohë që vendet e tjera, iu besuan sahabëve të tjerë me përvojë në dave.

Puna sociale dhe promovimi i vlerave Islame

Umer el Faruk në historinë e davetologjisë dhe të historisë islame njihet me ofiqin *Umeru'l Faruk*, sepse sundoi me drejtësi dhe ishte i drejtë me të gjithë, e edhe me të afërmit e vet. Përveç që e forcoi drejtësisë shariatike, siguroi që të gjithë qytetarët e shtetit Islam, myslimanë apo jo, të kishin të drejta të barabarta dhe t'u garantohej drejtësi. Ky shembull praktik ishte një mjet i fuqishëm për promovimin e thirrjes Islame. Në këtë vazhde, Umeri me ndjenjën e prijësit dhe përgjegjësit para masës, ofroi ndihmë për skamnorët. Me këtë përkushtim dhe kujdes për skamnorët dhe të pafuqishmit, shpërndau ushqime e ndihma në rajonet ku kishte nevojë. Themeloi shtëpi strehuese dhe fonde publike për jetimët dhe gratë e veja, duke treguar që Islami është një fe, që vë në qendër mëshirën dhe drejtësinë shoqërore. Muhamedi a.s, e ka lavdëruar zgjuarsinë dhe intuitën e Umerit r.a., duke thënë: “*Allahu xh.sh., e ka vendosur të vërtetën dhe drejtësinë në gjuhën dhe zemrën e Umerit*”

Ndërtimi i institucioneve dhe infrastrukturës së thirrjes Islame

Halifi Umer r.a. themeloi shumë xhami dhe institucione arsimore në territoret e pushtuara, duke siguruar, që popullatat e reja të edukoheshin mbi Islamin dhe të angazhoheshin në ibadet. Andaj ndërtimi i xhamive të reja në Medinën e ndritshme, në vendet e Shamit dhe në Irak, u bë një prioritet për hazreti Umerin r.a.. Ai urdhëroi që këto xhami të shërbenin jo vetëm si vende adhurimi, por edhe si qendra për arsimimin dhe orientimin shpirtëror të myslimanëve dhe të konvertuarve të rinj. Gjatë mandatit të tij u ndërtuan qytetet, si Kufa e Basra në Irak, organizoi vendin në shtet apo në provinca, themeloi institucione të reja siç janë: organet e rendit, burgjet, zyra për ankesa nga populli, agjencia e grumbullimit të taksave, e cila ishte e pavarur nga guvernatorët (valitë); adoptimi i një kalendarit të ri, duke filluar nga data e emigrimit apo e hixhretit, themeloi *bejtu'l malin*, i pari vendosi faljen grupe të teravive (me xhematë) kjo ndodhi më Ramazan të vitit 14h, duke vendosur dy prijës (imamë), i pari filloi t'u jepte shpërblime atyre që mësonin Kuranin përmendësh. I pari që e shtyu Mekami Ibrahimin, vendin, që Ibrahim as e përdorte për ndërtimin e murit të Qabesë. Mekami në atë kohë ishte thuasë i ngjitur me murin e Qabesë. I pari që kufizoi numrin e këshillit legjislativ, që më parë ishte i hapur, patrulloi dhe vendosi patrullime natën, që interesohen edhe natën për gjendjen e popullsisë. Përdori shkopinj për t'i edukuar njerëzit. Pas vdekjes së tij thoshin: "Shkopi i Umerit është më i rëndë se shpata juaj". I pari që caktoi ndëshkimin me 80 shkopinj për ata që pinë alkool, themeloi divanin, instalimi i një kanali, që lidh lumin Nil me Detin e Kuq, etj.

Kodifikimi i shariatit për shoqërinë islame

Puna e Umerit për të unifikuar zbatimin e ligjit Islam (shariatit) ishte jetike për përhapjen e mesazhit të Islamit. Për të siguruar që thirrja islame të mbështetej mbi drejtësinë dhe barazinë, ndërmoi masa, që ligji të ishte universal dhe i pandikuar nga privilegjet shoqërore. Për shembull, incidenti kur Umeri ndëshkoi djalin e një guvernatori për sjellje të padrejtë, dëshmon angazhimin e tij për drejtësinë. Ky akt ndikoi pozitivisht në perceptimin e Islamit si fe e barazisë dhe mëshirës. Drejtësia e Umerit u kthye në shembull ideal për thirrjen islame. Historia tregon raste kur ai përmbysi vendime të padrejta ndaj jo-muslimanëve apo shtresave të ulëta të shoqërisë, duke përmbushur kështu urdhëresën hyjnore: *“Nëse gjykoni midis njerëzve, gjykoni me drejtësi”*. Një rast i njohur është ndëshkimi i një prej valinjve të tij, që tregoi arrogancë dhe padrejtësi, duke u kthyer në një mësim të drejtë për të gjithë funksionarët e shtetit Islam. Umeri, r.a., është një personalitet i shquar, që mishëroi drejtësinë dhe përkushtimin ndaj saj, në mënyrën më të lartë. Ai njihej jo vetëm për faktin se urdhëronte drejtësinë, por edhe për vetë drejtësinë e tij të pashoqe. Drejtësia e tij u bë faktor vendimtar në pranimin masiv të Islamit nga jobesimtarët dhe një nga shtyllat më të rëndësishme të thirrjes Islame. Ky standard i lartë drejtësie ishte rezultat i dijes së jashtëzakonshme, që Umeri, r.a., kishte përvetësuar në “shkollën” e të Dërguarit a.s.. Abdullah b. Mes’udi, r.a., ka thënë: *“Nëse dija e Umerit do të vendosej në njërën anë të peshës, dhe dija e gjithë botës në anën tjetër, dija e Umerit do të mbizotëronte. Me vdekjen e Umerit, u humbën nëntë të dhjetat e dijes!”*

Në veprën e tij, Imam El-Gazali transmeton një bisedë ku Ibn Mes’udi, r.a., u pyet: “Si mund të pohosh këtë, kur ndër ne janë ende shumë sahabë të njohur?” Ai u përgjigj: “Me këtë, nuk po nënkuptoj fetvatë, rregullat fikih dhe informacionet e zakonshme. Umeri kishte njohuri për Allahun dhe e kishte njohur Atë, më mirë se kushdo tjetër.”

Kalimi në amshim i Umerit r.a.

Umeri r.a. kur ishte duke e falur namazin e sabahut dhe pasi u tha njerëzve të drejtoheshin, filloi. Posa tha tekbinin (Allahu ekber) u therr nga Ebu Lu'luë el Mexhusij apo Ebu Lu'lu'a Firuz, apo Firuz Nahavandi, një sasanian nga Persia. Një nga tabiinët, Amr b. Mejmuni e ilustron këtë rast, duke thënë: Isha në këmbë në rreshtin e dytë dhe mes meje e prijesit të besimtarëve ishte vetëm Abdullah b. Abasi. Drita në xhami ishte e zbehtë. Umeri dha tekbinin në fillim të namazit dhe para se të lexonte Fatihan, doli mexhusi dhe e goditi me thikë gjashtë herë. Umeri bërtiti: "Më vrau qeni!". Më pas, ai, që e goditi vazhdoi ikjen nëpër njerëz, duke i goditur me thikë, ku trembëdhjetë veta i theri, e nëntë prej tyre vdiqën. Kur e pa dikush, i hodhi një rrobë për ta zënë, dhe ky në atë moment e pa që u zu, e theri veten. Umeri i plagosur e mori për dore Abdurrahman b. Aufin dhe e nxori përpara të printe në namaz, duke falur shkurt namazin me suren El Kevther dhe el Asr.

Ai u plagos të mërkurën kur kishin mbetur tre apo katër ditë nga muaji i Dhul-hixhes (muaji i fundit i kalendarit hënor) të vitit 23 h., dhe u varros ditën e parë të Muharremit të vitit 24 h. Periudha e sundimit të tij zgjati 10 vjet, e pesë muaj e njëzetënjë ditë. Zejd b. Eslemi tregon nga i ati se Umeri vdiq kur mbushi të gjashtëdhjetat apo gjashtëdhjetetri. Muhamed b. Umeri thotë: Ky është versioni më i qëndrueshëm për mua nga të gjitha versionet e transmetuara.. Umeri r.a e kishte lënë amanet që namazin e xhenazes t'ia falte Suhejb b. Amër. Ai u varros afër Muhamedit a.s. Koka e Ebu Bekrit u vendos te supet e të Dërguarit a.s. ndërsa koka e Umerit tek ijët (beli) i tij.

Konkluzione

Roli i Umer ibn el-Hattabit në përhapjen dhe përforcimin e thirrjes islame ishte gjithëpërfshirës. Ai përdori urtësinë, drejtësinë dhe përku-shtimin për të ndërtuar një shtet të fortë, që siguronte mësimin dhe përhapjen e Islamit. Reformat dhe organizimet e Umerit r.a. pasqyrojnë

një metodologji gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të thirrjes islame, duke dëshmuar përkushtimin e tij ndaj zhvillimit të fesë dhe forcimit të strukturave të shoqërisë islame. Veprimtaria e tij si reformator, udhëheqës dhe thirrës, mbetet model për da've në çdo kohë dhe kontekst. Umeri e themeloi administratën qendrore islame mbi parime të meritokracisë dhe besnikërisë ndaj Islamit. Ai caktoi valinj, (gubernatorë) që kishin si detyrë kryesore jo vetëm administrimin e territoreve të pushtuara, por edhe përhapjen e Islamit dhe thirrjen për besim. Ai arriti të forcojë dhe të zgjeronte, duke planifikuar që thirrja islame të bënte përparime të mëdha dhe të arrinte rezultate të jashtëzakonshme. Në të vërtetë, ky ishte një vazhdim i pandërprerë i aktiviteteve brilante të thirrjes islame të paraardhësit të tij, Ebu Bekr el-Siddik, r.a. Umeri r.a. vazhdoi vetëm rrugën e Ebu Bekrit, r.a. dhe ndërmori veprime, që do t'i siguronin një kujtim të lavdëruar deri në Ditën e Kiametit. Ai mbetet gjithashtu thirrësi i jashtëzakonshëm, i cili, përmes dashurisë për fenë e Krijuesit, urtësisë dhe metodave të bukura ka shënuar rezultate të jashtëzakonshme.

Dy fjalë rreth metodologjisë së identifikimit të saktësisë së hadithit

Dr. Behlul Kanaqi*

Abstrakti

Me ardhjen e revelatës, jeta e Pejgamberit a.s., ndryshoi duke marrë një kuptim tjetër. Ai tashmë ishte ngarkuar me detyrën e thirrjes në fenë islame. Si i tillë çdo gjë që vepronte apo thoshte, përbënte një rëndësi të veçantë për sahabët. Ata bënë kujdes, që çdo gjë që dëgjonin drejtpërdrejt apo dhe anasjelltas nga Muhamedi a.s., ta kuptonin ashtu siç duhet, ndërsa në raste të ndonjë dyshimi ta vërtetonin, duke pyetur vetë, atë a.s.. Ky kujdes i treguar në kohën e Pejgamberit me kalimin e kohës u shndërrua në një sistem, që ka të bëjë me identifikimin e saktësisë së transmetimeve, që i përshkruheshin Hz. Pejgamberit. Sipas këtij sistemi hadithet identifikohen dhe klasifikohen, duke u emërtuar me terme sahih, hasen, daif apo mevdu.

Fjalët kyçe: *Muhamed, Sahabe, Sunnet, Hadith, Identifikim.*

* Autori Dr. Behlul Kanaqi, fakultetin e Shkencave Islame dhe Magjistraturën (hadith) e kreu në Universitetin Ondokuz Mayıs në Samsun, Turqi 1998-2005, ndërsa doktoraturën (hadith) e kreu në universitetin Uludağ, Bursa (Turqi). Ka qenë drejtor i medresesë së sapohapur "Mehmed Fatih" në Tuz 2008-2010, drejtor i revistës "Elif". Tani ushtron detyrën e ndihmësit të Reisit të Bashkësisë Islame në Malin e Zi - marrëdhëniet me Turqi dhe njëkohësisht është profesor i lëndës së hadithit në medrese.

Abstract

With the advent of revelation, the life of the Prophet p.b.u.,h. changed by taking on a different meaning. He was already charged with the task of calling on Islam. As such, everything he said or acted on was of particular importance to the Sahaba. They were very careful to clearly understand everything they heard directly from him or others, and in the case of doubt they confirmed their understanding/interpretation with Muhammed p.b.u.h. himself. Over time, the care shown during the time of Prophet Muhammed became a system that deals with identifying the accuracy of the transmissions described to Prophet p.b.u.h.. This care, shown in the time of Prophet p.b.u.h. over time became a system that deals with identifying the accuracy of the transmissions described to Prophet p.b.u.h. Under this system, hadiths are identified and classified by being named sahih, hasen, daif or mevdu.

Key words: Muhamed, Sahaba, Sunnah, Hadith, Identification,

Hyrje

Hadithi, i cili luan një rol të rëndësishëm në organizimin e jetës shpirtërore dhe materiale të kësaj bote, pas Kuranit, përbën burimin më të rëndësishëm të fesë Islame. Si i tillë, ai luan një rol të veçantë edhe në kuptimin dhe komentimin e ajeteve, në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore mes myslimanëve, ndërtimin e historisë, në kuptimin e vlerave fetare, si dhe në fusha të tjera të ngjashme. Prandaj, hadith i saktë, në një farë mënyre, do të thotë saktësi e sistemit dhe e interpretimeve, të cilat ndërtohen mbi bazën e këtyre haditheve. Pikërisht për këtë arsye, sahabët dhe brezat pas tyre janë treguar të kujdesshëm ndaj haditheve dhe kanë marrë masa për ruajtjen e tyre, si mësimin përmendësh, praktikimin e tyre dhe përcjelljen e haditheve, brezave të ardhshëm. Ky artikull ka për qëllim të bëjë një hulumtim të procesit të zhvi-

llimit të metodologjisë së identifikimit të saktësisë së hadithit, duke u ndalur te forma e fundit, që ka marrë kjo metodologji.

Përpyekjet e para për identifikimin e saktësisë së hadithit

Menjëherë pas fillimit të shpalljes Muhamedi a.s.. nuk ishte më një njeri i thjeshtë. Tashmë ai a.s., ishte ngarkuar me një detyrë të re, thirrjen e njerëzve në Islam. Si të tillë, sahabët e dëgjonin dhe e ndiqnin me vëmendje dhe bënë kujdes, që mësimet nga ai t'i merrnin të sakta, t'i ruanin dhe t'i praktikonin brenda mundësive të tyre. Kjo vërehet në ndjesinë e veçantë të sahabëve ndaj ruajtjes dhe kuptimit të saktë të fjalëve të Pajgamberit a.s., edhe pse mundësia për daljen e haditheve të deformuara apo të sajuara ishte tejet e dobët. Pikërisht kjo ndjesi përbën shkakun kryesor, që çështja e kritikës së hadithit, të merret si një detyrë, që në fillimet e para të Islamit. Si duket ky kujdes ka bërë që sahabët edhe në kohën e Pejgamberit ta pyesin vetë, atë, për vërtetimin e ndonjë fjale apo qartësimin e ndonjë teme, për të cilën nuk kanë qenë të sigurt, duke e bërë kështu si princip kërkimin e burimit për ndonjë lajm që u transmetohej.

Për ta konkretizuar këtë, mund të marim si shembull rastin e Omerit r.a., (v. 23/644) i cili e çoi Hisham b. Hakimin te Pejgamberi a.s., për ta sqaruar çështjen, sipas së cilës Hishami nuk e pati lexuar suren Furkan siç e lexonte Omeri. Po ashtu edhe në rastin me Ebu Musa, i cili pasi i pat thënë Omerit se Muhamedi a.s., kishte thënë: “Nëse dikush prej jush kërkon leje (për të hyrë) tre herë dhe nuk i jepet leje, le të kthehet”. Omeri r.a. kishte kërkuar dëshmitarë. Këto praktika, të cilat kanë dhënë siguri, janë përdorur edhe pas vdekjes së Muhamedit a.s., Kështu që sahabët për të marrë ndonjë informacion në lidhje me ndonjë temë ose për ta vërtetuar informacionin e pranishëm, i janë referuar Kuranit si dhe kanë pyetur ata, që e dinin Sunnetin më së miri. Kështu që, për shpjegimin e temave të ndryshme, shpesh herë pyesnin Aishen r.a., (v. 57/677) e cila ishte prej njohësve të mirë të sunnetit., Si shembull mund të përme-

ndim transmetimin që përcjell Ja' kub b. Sufjan el-Fesevi (v. 277/890) nga Ebu Seleme b. Abdurrahmani: (Ebu Seleme b. Abdurrahman tregon) Hyra te Aisheja r.a. dhe thashë: "O nënë! Xhabir b. Abdullahu thotë se 'Uji është (Gusuli merret) si shkak i ujit (i menisë), si thoni ju? Aisheja r.a. tha: "Xhabiri ka gabuar, a e njeh ai Resulullahun më mirë se unë! Kështu ka thënë Resulullahu: "Nëse vendi i sunnetit hyn në vendin e sunnetit, duhet gusuli..."

Sahabët përveç që e kanë praktikuar vërtetimin e saktësisë së një lajmi, duke pyetur njohësit më të mirë të Sunnetit, ata për këtë qëllim kanë përdorur edhe ndonjë kriter tjetër, që ka qenë i besueshëm për ta. Shkak i kësaj ishte dëshira dhe ndjeshmëria për të bërë identifikimin e duhur të rivajeteve sipas nevojave dhe kushteve të ndryshme të krijuara gjatë procesit historik. Për shembull, Hz. Aisheja e ka zgjidhur problemin e ndonjë hadithi, që e ka parë si të dyshimtë, duke marrë argumente nga Kurani. Ndërsa, nëse Ebu Bekri r.a. dhe Omeri r.a. dyshonin në ndonjë hadith, kërkonin dëshmitarë. Kurse Aliu r.a. (v. 40/661) në kohën e hilafetit të tij, për të identifikuar saktësinë e rivajeteve u kërkonte transmetuesve të betoheshin. Nga kjo shihet qartë se sahabët kanë dhënë shembujt e parë të metodës së identifikimit të haditheve për brezat e ardhshëm. Më vonë, muhadithët kanë marrë Kuranin, Sunnetin e Njohur, si dhe nevojat jetësore si principe kryesore për identifikimin e haditheve të sakta, duke i refuzuar hadithet, që kundërshtonin këta principe. Mirëpo, ngaqë nuk ka qenë e mjaftueshme vetëm kritika e tekstit, ata kanë filluar të bëjnë kritikë edhe ndaj atyre, që kanë transmetuar hadithe. Si përfundim i këtyre përpjekjeve për identifikimin e haditheve të sakta janë munduar të krijojnë një sistem kritikash të hadithit dhe janë kujdesur, që këtij sistemi t'i japin forma të caktuara. Ndër të tjera edhe me mendimin se ndoshta mund t'u hyjë në punë brezave të ardhshëm.

Si përfundim natyral i këtyre përpjekjeve të dijetarëve, kanë dalë formula, sipas të cilave janë përkufizuar hadithet dhe janë ndarë në lloje sipas shkallës së saktësisë. Kështu që forma përfundimtare e përkufizimit të hadithit sahih, që i ka dhënë Ibnu's-Salah (v. 643/1236) përkufizimit të

parë të hadithit sahih të bërë nga Shafiu (v. 204/820) është: “Hadithi sahih është hadithi, të cilin e transmetojnë nga njëri-tjetri transmetues dabit (saktësi) dhe adil (të drejtë) me sened muttasill (të vijueshëm) dhe që nuk është shadh dhe mual-lal.” “Shadh” do të thotë që një ravi thikah të transmetojë hadith në kundërshtim me hadithin e transmetuar nga ravi tjerë thikah; ndërsa “mual-lal” është hadithi, që ka një të metë të fshehtë, të cilën mund ta vërejnë vetëm dijetarët. Përveç përkufizimit të Ibnu’s-Salahut, e shohim se ka edhe përkufizime të tjera të hadithit sahih. Një prej këtyre është përkufizimi i es-Sejjid esh-Sherif el-Xhurxhaniut (v. 816/1413). Ai në veprën e tij et-Ta’rifat hadithin sahih e përkufizon në këtë mënyrë:

“Sahih hadith është hadithi, i cili në fjalët e tij nuk ka banalizim/pri-shje (rekaket) dhe që, kuptimi i tij nuk është në kundërshtim me ndonjë ajet, me rivajetet mutevatir ose me ixhmanë dhe që, transmetohet nga transmetues të drejtë.”

Në ditët tona po ashtu bëhen diskutime në lidhje me përkufizimin e hadithit sahih, duke ofruar sugjerime të ndryshme. Për shembull, një përkufizim tjetër i hadithit sahih, është: “Hadithi sahih është hadithi, i cili transmetohet nga zinxhiri i vijueshëm i transmetuesve të drejtë me kujtesë të fortë, i pastër nga shadh dhe ilet i dhe i cili mbërrin deri te Pej-gamberi a.s., me kuptim (batinen) dhe literalisht (dhahiren)”

Sa u përket kriterëve, që kanë përdorur dijetarët për identifikimin e haditheve sahih, këta kriterë tregojnë ndryshueshmëri. Kështu që, kur e kanë pyetur Abdurrahman b. Mehdiun (135-198) se si i dallon hadithet sahih nga të tjerët, ai ka dhënë këtë përgjigje: “Ashtu sikurse që doktori njeh të sëmurin (edhe unë i dalloj hadithet sahih nga të tjerët). Po ashtu edhe Ahmed b. Salih ka thënë: “Njohja e hadithit ngjanë me njohjen e arit...”. Kurse një fjalë tjetër e Abdurrahmanit është kështu: “Njohja e hadithit është ilham (frymëzim)”.

Siç shihet nga përkufizimet e haditheve sahih, që dhamë më sipër për kritikën e hadithit, janë marrë parasysh raviu, senedi dhe përmbajtja e metnit. Transmetimeve, që nuk i plotësojnë kushtet e këtyre përkufizi-

meve, u bie shkalla e saktësisë, duke rënë në shkallën hasen ose daif. Për shembull, hadithet e transmetuesve, që kritikohen nga aspekti i kujtesës, por, që hadithet e tyre janë muttasil, nuk janë mual-lal dhe shadh quhen hadithe hasen. Ndërsa daif quhet hadithi, i cili humbet në tërësi njërin nga kushtet, që parashtron përkufizimi i hadithit sahih, mirëpo nëse humb më shumë kushte, atëherë, dobësia e tij bëhet më e rëndë. Prandaj dijetarët, hadithin daif e kanë ndarë në disa pjesë, në mursel, munkati, mu'dal, mual-lak, mudel-les, mual-lal, muddarib, maklub, shadh, munker, metruk, mudrexh. musahhah dhe muharref. Ndërsa hadithin mevdu' (i sajuar- apokrif), disa dijetarë e kanë larguar nga klasifikimi i hadithit daif, duke e trajtuar si të veçantë. Ndërsa, disa tjerë e trajtojnë brenda këtij klasifikimi.

Metodologjia e identifikimit të saktësisë së hadithit

Si çdo shkencë, që ka metodat e veta për të arritur te informacioni i saktë, edhe shkencën e hadithit ka metodat e veta për të identifikuar informacionin e saktë. Metodatat, që janë zhvilluar në shkencën e hadithit përmbledhen në dy pika themelore: senedi dhe metni.

a) Kriteret që përdoren për identifikimin e saktësisë së senedit

Në shkencën e hadithit, senedi quhet zinxhiri i transmetuesve nga Pejgamberi a.s., e deri te transmetuesi i fundit. Roli i senedit në identifikimin e hadithit të saktë është shumë i rëndësishëm. Prandaj ka pasur dijetarë, të cilët, senedin e kanë parë si pjesë të fesë. Abdullah b. Mubarak ka thënë: "Sipas meje, senedi është nga feja; po të mos ishte kështu kushdo kishte folur sipas dëshirës...". Gjithashtu nëse shikojmë praktikën e muhadithëve, vërejmë se ata ndonjëherë e kanë vlerësuar hadithin, vetëm, duke u nisur nga senedi, pa marrë parasysh metnin. Për shembull, Ibn Adij dhe Ibn Hibban, Muhammed b. Harbin, e kanë vlerësuar si gënjeshtar dhe sajues dhe si pasojë nuk e kanë pranuar hadithin e tij rreth imanit. Siç shihet, dijetarët i kanë dhënë rëndësi saktësisë së senedit dhe kanë vendosur kriteret të caktuara, të cilat janë përpjekur t'i zbatojnë.

Senedi trajtohet nga dy aspekte: nga aspekti i vijueshmërisë sipas të cilit, transmetuesit duhet ta përcjellin hadithin e caktuar nga njëri transmetues (ravi) deri te tjetri transmetues (ravi) pa shkëputje, duke respektuar disa rregulla të caktuara si dhe nga aspekti i besueshmërisë së transmetuesve, sipas të cilit, transmetuesit duhet t'i plotësojnë po ashtu disa rregulla në mënyrë që të jenë të besueshëm. Nëse në sened nuk ka asnjë lloj shkëputjeje, atëherë ai pranohet si sahih. E nëse ka, atëherë ai vlerësohet si daif.,. Fjalët, të cilat shprehin saktësinë e senedit nga pikëpamja e vijueshmërisë janë: Musned, Muttasil, Muselsel, Muan'an dhe Muen'en.,. Ndërsa fjalët, që shprehin dobësinë e senedit janë: Mursel, Munkati, Mu'dal, Mudel-les dhe Mual-lak.

Duke u nisur nga përkufizimi i hadithit sahih, siç e kemi parë më lart, për të identifikuar besueshmërinë e raviut, duhet shikuar raviun në fjalë a është posedues i dabit (kujtesës) dhe adaletit (drejtësisë). Në fund të këtij procesi nëse transmetuesit kanë kujtesë të mirë dhe janë të drejtë, atëherë hadithi i tyre është sahih nga ky aspekt; mirëpo nëse ka ndonjë të mangësi, atëherë transmetuesit vlerësohen me notë negative. Për të shprehur mangësitë e tyre përdoren këto fjalë: në lidhje me drejtësinë: kidhb, tuhmet-i kidhb, xhehalet dhe bid'at; ndërsa në lidhje me kujtesën: fuhshi galat, gaflet, vehm, muhalefet dhe su-i hifdh. Si përfundim i kësaj, hadithi mund të vlerësohet me shprehjet mevdu, metruk, munker, mual-lal, mudrexh, maklub, muddarib, musahhaf, muharref ose shadh. Përveç që dijetarët janë marrë me hulumtimin e gjendjes së transmetuesit (raviut) dhe i kanë formuluar kriteret, që shprehin dobësitë e raviut, ata janë përpjekur që në sened të identifikojnë edhe shenjat e sajimit. Shenjat e sajimit nga aspekti i senedit në formë përmbledhjeje janë:

1. Rrëfimi i raviut: raviu tregon se ka sajuar një hadith të caktuar apo më shumë. Mirëpo, meqë ekziston mundësia të gënjejë edhe gjatë rrëfimit të sajimit, kjo shenjë duhet të merret me rezervë.
2. Qëndrimi i një fakti, që tregon se hadithi është i sajuar. Si shembull mund të marrim transmetimin e një raviu nga një shejh që jeton në një vend tjetër, të cilin kur nuk e ka parë dhe kurrë nuk e

ka takuar. Me'mun b. Ahmed el-Herevi pretendonte se ka marrë hadith nga Hisham b. Ammari (v. 245/859), mirëpo kur e pyeti Ibn Hibbani (v. 354/965) se kur kishte shkuar në Sham; ai i tha në vitin 250; atëherë Ibn Hibbani e refuzoi, duke i thënë se në atë kohë, Hisham b. Ammari ishte i vdekur.,

3. Raviu, i cili është i njohur si gënjeshtar mbetet vetëm në transmetimin e tij.
4. Lidhja direkte e rivajetit me medhhebin, mendimin apo gjendjen shpirtërore të raviut.

Megjithëse saktësia e senedit është shumë e rëndësishme për besueshmërinë e hadithit ajo nuk është e mjaftueshme. Prandaj përveç senedit të saktë, duhet të jetë edhe metni i saktë, në mënyrë, që hadithi të identifikohet si i saktë/sahih.

b) Kriteret e identifikimit të saktësisë së tekstit/metnit.

Në shkencën e hadithit, teksti është pjesë e hadithit dhe përbën bërthamën e tij. Teksti apo metni përmban fjalët, veprat dhe miratimet në heshtje të Muhammedit a.s., Për ta qartësuar më shumë temën, do t'i japim vend metodës së formuluar nga dijetarët për të zbuluar shenjat e sajimit në tekstin e hadithit, metodë, e cila në të njëjtën kohë vlen edhe si identifikim i saktësisë së tekstit.

Shenjat në tekstin e hadithit të cilat tregojnë për sajimin e tij në mënyrë të përmbledhur janë këta:

1. Teksti kundërshton Kuranin: Ngaqë Pejgamberi a.s., nuk do të fliste kurrë diçka në kundërshtim me Kuranin. Lajme të tilla numërohen si të sajuara. Shembull: "Fëmija i lindur nga zinaja nuk hyn në xhenet." Ky transmetim bie në kundërshtim me Kuranin ku thuhet se askush nuk bart mëkatin e tjetrit.
2. Transmetimi bie në kundërshtim me sunnetin sahih. Nëse transmetimet janë në kundërshtim me hadithet e pranuar si sahih, atëherë ato transmetime numërohen si të sajuara. Shembull: Transmetimi sipas të cilit, ata që i kanë emrat Ahmed dhe Muhammed

nuk hyjnë në zjarr pra xhehenem është në kundërshtim me hadithet, sipas të cilëve, shpëtimi i njeriut bëhet vetëm në bazë të besimit dhe punëve të mira.,

3. Lajmi bie në kundërshtim me ixhmanë: Hadithet që flasin për hila-fetin e Aliut r.a., refuzohen, sepse janë në kundërshtim me qëndrimin e ixhmasë, sipas së cilës nuk kanë arritur hadithe të sakta në lidhje me këtë temë.
4. Transmetimet, që bien në kundërshtim me të dhënat dhe ngjarjet historike, të cilat merren si të sakta: Disa ngjarje, që kanë ndodhur në të kaluarën, tregojnë se disa hadithe janë sajuar. Për shembull, dijetarët e kanë refuzuar dokumentin, të cilin e ka paraqitur populli i Hajberit, duke u bazuar në fakte historike.
5. Një hadith transmetohet vetëm nga një person përkundrejt elementeve tjerë, sipas të cilëve duhej ta transmetonin shumë veta. Si shembull mund të marrim rivajetin sipas të cilit, dielli është kthyer mbrapa pas ikindisë, në mënyrë që, Aliu r.a., ta falë namazin e ikindisë. Arsyetimi i refuzimit qëndron në atë se kthimi i diellit mbrapa pas perëndimit të diellit është një ngjarje, që megjithëse mund të shihet nga shumë njerëz, e transmeton vetëm një person.
6. Shprehjet e transmetimeve, që janë të prishura/shëmtuara (reka-keh/rikkeh): Ngaqë të folurit e Muhammedit a.s., ka qenë i bukur dhe me rregull, banalizimet në shprehjet dhe kuptimet e haditheve, merren si shenjë sajimi. Mirëpo, pasi që, dijetarët e kanë parasysh se shumica e haditheve janë transmetuar me kuptim, atëherë ata më shumë janë marrë me kuptimet e banalizuara, të shëmtuara dhe të prishura, sesa me gabimet gjuhësore.
 - 6.1. Transmetimi, që premtion shpërblime të mëdha për një punë të vogël e dënime të mëdha, po ashtu për një gabim të vogël apo të parëndësishëm. Si shembull mund të marrim hadithin “Kush këndon Kuran, duke filluar nga ‘Kul eudhu birabbinnas e mbrapa’ hidhet në xhehenem me kokë poshtë.

- 6.2. Transmetimi, që përmban shëmti, si për shembull: “Janë katër gjëra, që nuk ngihen me katër të tjera: ‘Toka me ujë, femra me mashkull, syri me shikim dhe veshi me lajm”
- 6.3. Transmetimi, që bie në kundërshtim me dëshminë e vëzhgimit dhe të shqisës: “Gënjeshtarët më të mëdhenj ndër njerëz janë bojaxhinjtë”, ky hadith është refuzuar, sepse ka përgjithësim dhe i hap derë futjes në një kosh të gjithë bojaxhinjtë në këtë rast, gjë që është në kundërshtim me dëshminë e vëzhgimit dhe të shqisave.
- 6.4. Transmetimi, që përshtatet me medhhebin apo ideologjinë e transmetuesit. “Kush çon duart në ruku, nuk i pranohet namazi” ose “Bijtë e Abbasit e kanë haram xhehenemin” Këta hadithe janë refuzuar pikërisht si shkak i sajimit të hadithit në favor të mbështetësve të një medhhebi a lëvizjeje të caktuar.

Përfundim

Në historinë Islame, themelet e metodologjisë së identifikimit të saktësisë së hadithit fillojnë që në kohën e Pejgamberit a.s., për t’u zhvilluar me kalimin e kohës, duke mbërritur në një nivel të caktuar. Ky proces ndërtimi i sistemit të metodologjisë së identifikimit të hadithit, është zhvilluar në përputhje me rrethanat dhe kushtet e krijuara gjatë historisë, duke u ripërtërirë kohë pas kohe. Kështu që, praktikat e përdorura në fillim për identifikimin e haditheve të sakta, me kalimin e kohës janë sistematizuar, duke marrë formën, që kanë sot. Në fillimet e para për ndonjë mëdyshje rreth ndonjë hadithi është pyetur Pejgamberi a.s., ndërsa më vonë sahabët dhe tabiinët e kështu me radhë, duke arritur në një shkallë, në të cilën, përpjekja për identifikimin e saktësisë së hadithit ka kërkuar një sistem më të sofistikuar dhe kompleks. Si pasojë janë bërë formulime dhe përcaktuar kritere me qëllim identifikimi të hadithit të saktë, duke u nisur nga senedi/zinxhiri dhe metni/teksti i vetë hadithit. Kriteret e përcaktuara në lidhje me senedin, si pikë referimi, kanë marrë

vijueshmërinë e senedit dhe besueshmërinë e raviut, gjegjësisht transmetuesit. Ndërsa kriteret e përcaktuara në lidhje me tekstin, si pikë referimi kanë marrë Kuranin, sunnetin sahih, logjikën e shëndoshë, faktet historike dhe shkencore. Si fjalë përmbyllëse mund të themi se praktikantët e dijetarëve të hershëm, gjithmonë u kanë shërbyer si shembull dijetarëve të mëvonshëm në përdorimin e kriterëve për identifikimin e saktësisë së hadithit.

Komentimi i Kuranit nga Hafiz Ali Korça

Dr. Azmir Jusufi*

Abstrakti

Lavdi dhe falënderimi i qofshin Allahut të Lartësuar, i cili ia shpalli Kuranin robit të Tij, si udhërrëfyes për njerëzit, shpëtim për ata që i frikësohen Zotit, ngushëllim për durimtarët, krenari për pasuesit e Islamit. Bekimet dhe paqja qofshin mbi kurorën e pejgamberllëkut, krijesën më të mirë, shpirtin më fisnik, Muhamedin a.s., mbi familjen, shokët dhe pasuesit e tij të ndershëm. Kurani është fjalim që zgjon mallin, që e dëshirojnë shpirtrat, që është ilaç për zemrat dhe dritë e arsyes njerëzore. Një fjalë që zgjon vazhdimisht kureshtjen e njerëzve, e cila lexohet, mësohet, studiohet dhe analizohet thellë. Si të gjitha kombet që e kanë ndjerë nevojën për Kuranin, ashtu edhe shqiptarët që nga dekada e fundit e shekullit të XIX-të dhe vitet e hershme të shekullit të XX-të, ata shfaqën interesim në fushën e komentimit të Kuranit, i cili interesim vazhdon deri më sot. Nga figurat e shquar në fu-

* Autori Dr. Azmir Jusufi ka mbaruar magjistraturën dhe doktoratën në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, lëmi i tefsirit. Është imam i dytë dhe mual-lim në xhaminë "Darusselam" – Arbana në Prizren, si dhe përkthyes dhe interpret gjyqësor. Punon në GC& Consulting. E-mail:azmir.gcda@gmail.com.

shën e komentimit të Kuranit në Shqipëri ishte edhe Hafiz Ali Korça, për të cilën tematikë do të bëhet fjalë në këtë punim.

Fjalë kyçe: *Hafiz Ali Korça, Kuran, tefsir, komentimi simbolik i Kuranit, metafora në komentimin e Kuranit, komentimi shkencor i Kuranit, israiliatet etj.*

Abstract

Glory and praise be to the Almighty Allah, who revealed the Qur'an to his servant, a guide for people, salvation for the God-fearing, comfort for the patient, pride for the followers of Islam. Blessings and peace be upon the crown of prophethood, the best creature, the noblest soul, Muhammad, a.s., upon his honorable family, companions, and followers. The Qur'an is a speech that awakens longing, that souls desire, that is medicine for hearts and light of human reason. A word that constantly awakens people's curiosity, which is read, learned, studied and analyzed deeply. Like all nations that have felt the need for the Qur'an, Albanians since the last decade of the 19th century and the early years of the 20th century, they have shown interest in the field of Qur'an commentary, so this interest has not stopped until today. One of the prominent figures in the field of Quran commentary in Albania was Hafiz Ali Korça, a topic that will be discussed further in the paper.

Keywords: *Hafiz Ali Korça, Qur'an, tafsir, symbolic commentary on the Qur'an, metaphors in the commentary on the Qur'an, scientific commentary on the Qur'an, Israi'liyats, etc.*

Hyrje

Kurani është shpallje e Allahut xh.sh., të zbritur Muhamedit a.s., i cili ngjanë një burimi të pashterur, thellësia e të cilit nuk mund të shihet, por gjatësia e të njëjtit burim i arrin të gjitha kufijtë e mundshëm. Elokuenca e Kuranit që nga fillimi i zbritjes së tij ka qenë ndër temat kryesore të cilat i kanë trajtuar brezat deri më sot. Shoqërimi me Kuranin mbjell qetësi, mall, dhembshuri dhe çdo virtyt të mirë në zemrat e besimtarëve; në të është një thesar me shumë të mira; meditimi mbi atë që thotë i Plotfuqishmi në Fjalën e Shenjtë dhe si e interpretojnë atë mufesirët, ndër të cilët është edhe Hafiz Ali Korça, është një nder dhe kënaqësi e veçantë.

Prandaj, në këtë punim do të bëhet fjalë për një personalitet shumë të njohur ndër shqiptarët, kontributi i të cilit është shumë domethënës në fushën e komentimit të Kuranit Fisnikë ndër shqiptarët në Shqipëri. Bëhet fjalë për alimin e kohës së tij, Hafiz Ali Korçën. Duke pasur parasysh se nuk është shkruar mjaftueshëm për kontributin e dhënë nga Hafiz Ali Korça në fushën e komentimit të Kuranit në gjuhën shqipe, është arsyeja kryesore e përzgjedhjes së temës së punimit.

Në fillim të punimit do të bëhet fjalë për Hafiz Ali Korçën dhe komentimin e Kuranit, komentimin e tij simbolik të Kuranit, përdorimin e metaforës në komentim të Kuranit, qëndrimin e tij ndaj israiliateve (tregimeve nga hebrenjtë), problematika e shkronjave simbolike, shkaqet e zbritjes së Kuranit dhe komentimit shkencor të Kuranit.

Komentimi i Kuranit nga Hafiz Ali Korça

Hafiz Ali Korça, në hyrjen e tefsirit të tij voluminoz, përmendi se kishte shkruar shumë për *tefsir*-komentim dhe interpretim të Kuranit në gjuhën shqipe, duke i mbështetur mendimet e tij në shumë vepra të njohura lëmi të tefsirit, mirëpo, për fat të keq ky tefsir i tij nuk e pa dritën e botimit për arsye financiare, sepse ishte shumë i kushtueshëm e që hafëzi nuk i kishte mundësit që vet ta boton atë, ashtu që e shtynte

botimin e tefsirit me shpresë se një ditë do të përmirësohen kushtet ekonomike të tij dhe të botohet tefsiri në fjalë.

Në *hyrje* të tefsirit të tij ai thotë: “Para dhjetë vjet dyk e vënë shumë llojesh Tefsirë përpara pata shkruar gjer e gjatë mjaft tefsirë, por për qitjen e tij në dritë më duheshin më tepër se dy mijë napoljona...”

Se Hafiz Ali Korça shkroi një tefsir të gjatë, këtë e kuptojmë edhe nga fusnota e parë e sures El-Fatiha, ku thotë: “Shkurtim prej Tefsirit të gjatë që kam shkruar.”

Përkundër gjendjes së vështirë financiare, ai megjithatë, kishte vendosur ta botojë përmbledhjen e tefsirit voluminoz, me qëllim që të jetë sa më i kapshëm për mbarë njerëzit, dhe një kopje të këtij tefsiri e kam edhe unë, por për fat të keq, shumë faqe të tij janë zhdukur... Studiues të fushës të fushës përmendin faktin se tefsirit i humbur autorit Ali Korça ishte i shkruar në më shumë se dymijë faqe.

“*Kurani i Madhënueshëm e thelbi i tij*”, është fillimi i përkthimit të Kuranit në shqip i botuar më 1926 në shtypshkronjën “Ora e Shkodrës” në Shkodër. Ky botim i veçantë i përkthimit të Kuranit përbëhet prej 15 faqesh dhe lë të kuptosh se veprimtaria e tij do të vazhdonte. Megjithatë, sipas të gjitha gjasave veprimtaria është ndërprerë për shkaqe materiale, ashtu që veprimtarinë e përkthimit Hafiz Ali Korça e vazhdoi më pas në revistën “Zani i Naltë”. Ishte përkthimi i shkurtë, mirëpo, duke e lexuar atë, tek lexuesi fitohet bindja e thellë se Hafiz Ali ishte njohës shumë i mirë i gjuhës arabe dhe dijetari që i njihte mirë çështjet islame. Këtë pjesë të përkthimit e karakterizojnë interpretimet shkencore islame, filologjike, semantike dhe historike që e ndihmojnë lexuesin për ta kuptuar drejtë Kuranin.

Ky botim i veçantë përfundon me shënimin e numrit të faqes 15 pa ndonjë shënim tjetër plotësues për vazhdimin apo përfundimin e punës. Me sa duket, ai e vazhdoi botimin e përkthimit pjesë-pjesë. Kjo formë e përpjekjes për ta nxjerrë në dritë përkthimin ishte pasojë e rrethanave të rëndë materiale e politike në të cilat u gjend Hafiz Aliu në vitet 1920-1926. Si duket, edhe kjo mënyrë e punës se Hafiz Aliut për botimin e për-

kthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nuk pati sukses dhe këtë veprimtari do të vazhdonte në revistën “Zani i Naltë”, si komentues e jo si përkthyes.

Këtë vepër të madhe e të rëndësishme jo vetëm nga përmbajtja në fushën e islamistikës, Hafiz Aliu e kishte përfunduar qysh në vitin 1920, mirëpo, për shkaqe materiale nuk kishte filluar botimin e tij. Ky konstatim del prej theksimit të Hafiz Aliut në parathënien e këtij libri, ku thotë: “...Për qitjen e tij (tefsirit) në dritë më duheshin më tepër se dy mijë napolona; pra shtypjen e këti e lashë për një kohë më vonë dhe tani e pashë më *convenable* (munasib) shtypjen e thelbit të H. Kuranit.”

Hafiz Ali Korça dhe komentimi simbolik i Kuranit

Nga reflektimet dhe gjurmët e doktrinës reformiste në mendimin e Hafiz Ali Korçës është komentimi simbolik i disa ajeteve. Është e vërtetë se kjo mënyrë e komentimit simbolik është një lloj komentimi i lejuar sufi dhe e ka bazën e vet në Sheriatin tonë, i cili në shkencën e tefsirit njihet si “Et-tevfik bejne-l-ma'na edh-dhahiri ve ma'na el-batini” (*harmozim i kuptimin ekzotërik të ajetit - dhahir me atë ezotërik - batin*), ose siç deklarojnë disa dijetarë se “çdo ajet ka një kuptim të brendshëm dhe të jashtëm”.

Këtë çështje të tefsirit e kanë studiuar shumë dijetarë, si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët e sotshme, gjegjësisht në të kaluarën e kanë studiuar Imam Gazaliu, Imam Ebu Is'hak Esh-Shatibiu, etj., ndërsa në kohët e fundit me këtë problematik janë marrë: prof. dr. Muhamed Husejn Dhehebiu, prof. dr. Muhamed Abduladhim Zurkaniu, prof. dr. Fehd ibn Abdurahman Er-Rumiu dhe prof. dr. Jusuf El-Kardaviu, etj.

Përkrahësit e këtij lloji të tefsirit argumentojnë me hadithin numër 4970, të cilin e ka shënuar Imam Buhariu në *Sahihun* e tij, ku thuhet: Na ka treguar Musa b. Ismaili i cili thotë: Na ka treguar Ebu Avane duke transmetuar nga Ebu Bishri, e ai nga Se'id b. Xhubejri, e ai nga Ibën Abbasi r.a., i cili ka thënë: “*Omeri më fuste në shoqërinë e pjesëmarrësve të shquar të Betejës së Bedrit. Disave prej tyre kjo nuk u pëlqente, kështu që*

thanë: 'Pse duhet të ulet ky me ne kur edhe ne kemi djem si ai?' Omeri u përgjigj: 'Për të e dini se kush është dhe nga kush është...' Një ditë ai më thirri dhe më mori me vete tek ata. Mendoj se më çoi atë ditë atje vetëm për t'ua treguar... kështu që pyeti: 'Çfarë thoni për fjalët e Allahut xh.sh.?' 'Kur do të vijë ndihma dhe fitorja e Allahut?' Disa thanë: 'Na është urdhëruar ta falënderojmë Allahun kur Ai na ndihmon dhe na jep fitoren.' Të tjerët heshtën dhe nuk u përgjigjën fare. Ai më pyeti: 'O Ibën Abbas, a thua edhe ti kështu?' Unë thashë: 'Jo!', kështu që ai më pyeti: 'Po ti çfarë thua?' Unë thashë: 'Këtu është fjala për vdekjen e të Dërguarit të Allahut a.s., të cilin (Allahu) e paralajmëroi me fjalët: 'Kur të vijë ndihma dhe fitorja e Allahut' është shenjë e vdekjes suaj të afërt.' Omer b. Hattabi i tha: 'Edhe unë i kuptoj këto fjalë siç po thua ti.'"

Ekzistojnë ajete dhe hadithe tjera që i theksojnë dijetarët e që konfirmojnë kuptimin ezoterik apo këtë ngjyrë simbolike në tefsir. Sa i përket kësaj problematike, prof. dr. Hajredin Hoxha në librin e tij *Tefsiri dhe mufesirët shqiptarë në kohën bashkëkohore (shek. 19-20)*, thotë: "Ana e dukshme e Kuranit është ajo që Zoti i Madhërishëm u drejtohet robërve të vet në gjuhën e pastër arabe, e që ka rregulla e parime që na mundësojnë të kuptojmë në mënyrë të shëndoshë. Kuptimi ezoterik (i fshehur dhe i brendshëm) ka të bëjë me dëshirën e Zotit të Madhërishëm dhe me qëllimin për të cilin e ka zbritur Kuranin, dhe këtë e kuptojmë nëpërmes të kuptuarit të parimeve dhe rregullave të tilla gjuhësore krahas dhuntisë hyjnore, e cila, sipas Imam Sujutiut, konsiderohet kusht i rëndësishëm i komentuesit të Kuranit, e që nënkupton Dritën e Zotit të Madhërishëm që e ndez në zemrën e dijetarit dhe njohësit të Zotit të Gjithëfuqishëm, e që ka zemër, mendim dhe sjellje të shëndoshë."

Prof. dr. Hajredin Hoxha, në librin e sipërpërmendur, shënon se Hafiz Ali Korça gjatë komentimit të ajetit nëntëmbëdhjetë të sures El-Bekare, thotë: "Shiu i rreptë dhe retë nënkuptojnë imanin dhe Kuranin, errësira dhe bubullima nënkuptojnë veprat e rënda, si p.sh., namazi, agjërimi, xhihadi kundër jobesimtarëve, largimi nga fetë e vjetra dhe nga pozitrat e kësaj bote, gjë që është shumë vështirë për ta. Kur dëgjonin

çështje të tilla të ahiretit që i ngjanin rrufesë dhe bubullimës, jobesimtarët i vënin gishtat në veshët e tyre që të mos i dëgjojnë”

“Metafora” në komentimin e Kuranit nga Hafiz Ali Korça

Metafora është një krahasim i shkurtuar në të cilin objekti (*imazhi*) i krahasimit, grimca dhe vetia e përbashkët janë hequr. Pra, metaforë është një fjalim i transferuar (greq. *metafora* - transferim), në të cilin ka një ndryshim në kuptimin e një fjale ose një përdorim të pazakontë të një fjale. Ajo e pazakontë mbështetet në vëzhgimin e ngjashmërive ndër-mjet dukurive. “Të përdorësh mirë metaforat do të thotë të jesh në gjendje të vëresh ngjashmëritë”, vuri në dukje Aristoteli.

Përdorimi i metaforës i jep gjuhës dinamikizëm dhe freski, prandaj është mjeti më shprehës i fjalës poetike. Vetë Kurani thotë se ai ia mëson njeriut “atë që ai nuk e di”, dhe për theksimin e tyre, realiteteve të pa njohura ishte e nevojshme metafora.

Kurani përdor fjalë, në kuptimin e tyre themelor, kuptim leksikor. Metafora është e pranishme në Kuran në masën e nevojshme. Megjithatë, ka dijetar islam të cilët janë të mendimit se Kurani nuk përmban metaforë dhe refuzojnë çdo interpretim metaforik. Kuptimi metaforik, sipas tyre, është vëllai i gënjeshtres dhe se Kurani është i pastër nga kjo. Es-Sujuti, megjithatë, pretendimin se mexhazi është vëllai i gënjeshtër e konsideron si të kotë, deklaratë *batil* dhe thotë se me heqjen e metaforës nga Kurani hiqet edhe pjesa e tij e bukur...

Gjatë studimit të librave të Hafiz Ali Korça, kemi gjetur se ai i ka komentuar disa ajete kuranore me kuptim metaforik, ku si shembull mund të përmendim komentimin e tij të fjalës “kafir”, në ajetin 20 të sures El-Hadid, ku thotë: “Fjala kafir (qafir) nuk e ka kuptimin e keq, sepse kafir i thuhet bujkut i cili lëron dhe farën si e hedh në tokë e mbulon që mos të duket. Allahu xh.sh., në Kuran thotë: ‘Si një shi që bije dhe me blerimin e saj bujqit i gëzon...’ (El-Hadid, 20). Fjala *kafir* që përdoret në Kuran përdoret si *mexhaz* (metafore), d.m.th., duke parë nëpër librat e shenjta pro-

fetësinë e vërtetë të H. Muhamedit dhe duke parë muxhizet e tij me sy, si bujqit që e mbulojnë farën me dhe, e mbështjellin të vërtetën dhe nuk e besuan. Shkaku tjetër, çifutët, duke parë se profetësinë e Isait a.s., ashtu edhe profetësinë e Muhamedit a.s., e kishin parë në Tevrat, nga shpirtkeqësija e mohuan, e mbuluan të vërtetën, u bënë kafir. Tjetër, duke qenë se e dinin se Uzejri ishte njeri, thonë se është i biri i Zotit, e duke qenë se e dinin që Isai ishte njeri si të tjerët, e mbuluan të vërtetën e thanë se është bir i Zotit. Këta janë kafira (bujq) të cilën e mbuluan të vërtetën sikur që mbulohet fara në tokë...”

Qëndrimi i Hafiz Ali Korçës ndaj israiliateve (tregimeve nga hebrejët)

Siç dihet, ndër parimet racionale ose nga disiplinat e nevojshme të tefsirit të Kuranit Fisnik, sipas ithtarëve të shkollës reformiste racionale është çështja e refuzimit kategorik të israiliateve dhe mbështetja vetëm në atë që thuhet në Kuran dhe Synet autentik.

Israiliatet janë traditat që nuk janë në Kuran, e që flasin për pejgamberët dhe popujt e mëhershëm të përmendur në Kuran. Dijetarët myslimanë u përballën me një problem: a mund të merren këto tregime si burim shtesë për kontekstin e transmetimeve kuranore apo duhet të refuzohen. Këto tradita përfshijnë disa tregime që ka shumë të ngjarë të kenë origjinën nga traditat gojore të krishtera dhe hebreje dhe *midrashi*.

Përfshirja e israiliateve në tefsire e ka zanafillën që nga koha e sahabëve, kur disa prej tyre, në kërkim të hollësive të thënieve për pejgamberët e popujve të mëparshëm, iu drejtuan asaj që tregojnë pasuesit e Librave të Shenjtë, dhe veçanërisht hebrejët. Sahabët, duke mos ditur hollësitë e ndonjë tregimi kuranor, shpesh i pyesnin ithtarët e Librave të cilët u konvertuan në Islam dhe sollën me vete diçka nga korpusi i besimit të tyre.

Këto ndikime ishin më shumë të dëmshme sesa të dobishme. Kur e hedh një vështrim më të afërt, vërehet se doza e pranimit kritik të israiliateve, që nga koha e parë e Islamit, përkatësisht, sahabëve nuk ka mbe-

tur sepse ka humbur plotësisht. Ne gjejmë shumë tefsirë të mbushur me ngjarje të trilluara dhe transmetime joreale që shkojnë përtej fushëveprimit të botës objektive në të cilën zhvillohen ngjarjet. Kur e shikon, nga një vëzhgues kritik, padyshim të krijohet përshtypja se nuk ka asgjë për të marrë prej kësaj.

Ekzistojnë tre lloje të israiliateve: 1) israiliatet që janë identikë me thënien kuranore; 2) israiliatet që janë diametralisht të ndryshëm nga thëniet kuranore - ajo që vërtetohet se është kundër mësimave themelore të Islamit dhe Kuranit dhe pabazueshmëria e të cilave është vërtetuar, dhe nuk është në përputhje me të menduarit e saktë dhe përfundimet logjike; 3) në këtë lloj përfshihen ato israiliate që flasin për atë që Kurani dhe Hadithi nuk përmendin. Shumica e israiliateve janë tradita apokrifë, prandaj Ahmed ibën Hanbeli tha: "Mos i shkruani ato tradita të çuditshme sepse janë të panjohura dhe shumica e tyre janë transmetuar nga transmetues të panjohur.

Siç mund të kuptohet, edhe në këtë çështje, mos pranimin e israiliateve, Hafiz Ali Korça ka qenë i ndikuar nga shkolla reformiste të Egjiptit, në krye me reformatorin e mirënjohur të botës islame, Muhamed 'Abduhu.

Shkronjat simbolike në komentimin e Kuranit nga Hafiz Ali Korça

Kuptimi i këtyre shkronjave-simboleve i hutoi të gjithë mufesirët nga kohët më të hershme. Me sa duket nuk ka ndonjë traditë se Muhamedi a.s., kishte interpretuar domethënien e këtyre shkronjave, e as që dikush nga sahabët e tij janë marrë me këtë problematik apo edhe e kanë pyetur Pejgamberin a.s., për ndonjë sqarim eventual.

Paraardhësit (selefite) nuk u lëshuan në komentimin e këtyre shkronjave, në lidhje me kuptimin tonë, ato janë si një fjalim i fshehtë midis sundimtarëve dhe guvernatorëve të tyre, të cilin mund ta kuptojë vetëm ai të cilit i ka "çelësat" e këtij fjalimi: *Çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai...* (El-En'am, 59).

Përpyjekjet e shumta të shkencëtarëve evropianë dhe islamë për të depërtuar në kuptimin e simboleve kuranore kanë mbetur, siç dihet tashmë, deri më sot pa ndonjë rezultat të dukshëm. Ndër këto përpjekje, vëmendje të veçantë (për këtë rast) tërheqin ata ekzegetë që u kufizuan në gjetjen në simbole të një ose më shumë shkronjave që përfaqësojnë thirrjen e Zotit. Kështu, inicialet E.L.R., H.M., i N., sipas mendimit të tyre, do të ishin shkurtesa të emrit er-Rahman "Bamirës", në të ashtuquajtur emrat e bukur të Zotit.

‘Aisha ‘Abdurrahman (Bintu Shati) thotë: “Nuk ka dyshim se janë mbajtur shumë qëndrime dhe janë shprehur mendime të ndryshme në lidhje me shkronjat e renditura individualisht në fillim të kapitujve të Kuranit, disa prej të cilave nuk janë të pranueshme, kurse interpretimi i tyre hebrej është veçanërisht i papranueshëm.”

Mahmud Sheltuti, në tefsirin e tij të Kuranit *Komentimi i Kuran-i Kerimit*, thotë se ky stil më herët nuk ishte i njohur tek arabët, e as që këto shkronja kishin ndonjë kuptim tjetër në gjuhën arabe përveç se paraqisnin emërtimet e tyre si p.sh. *huruful-hexhaije* (shkronjat e alfabetit) nga të cilat formohet fjalimi. Nuk ka asgjë autentike e që transmetohet nga Pejgamberi a.s., e që do të shpjegonte se çka nënkuptohet me këto shkronja.

Hafiz Ali Korça duke i komentuar ajetet e para të sures El-Bekare, pikërisht rreth shkronjat e fillimit të sures (shkronjat simbolike/misterioze) الم thotë: “Për fjalën Elif-Lam-Mim dhe për shoqet e saja që ndodhen para disa sureve, fliten shumë fjalë:

1. Janë disa shifra të mbyllura e simbole të fshehura midis Zotit e Pejgamberit të cilat quhen مُشَاهِدَاتٌ (të përafërta);
2. Mendjet me qenë se janë shkallë – shkallë, atë që e kupton Pejgamberi të tjerët s'mund ta kuptojnë. Këto s'janë fjalë të kota, domosdo e kanë nga një thelb. Po ata që thonë se këto shifra i di vetëm Zoti edhe Pejgamberi, nuk i rrëmojnë aspak; ata që thonë se edhe na dimë diçka e mundohen me e qitë një thelb kështu: (الم) “Unë jam Zot fort i ditshëm”.

Shkaqet e zbritjes në komentimin e Kuranit nga Hafiz Ali Korça

Në procesin e hulumtimit dhe gjetjes së kuptimit të ajeteve nga Kurani, rol të rëndësishëm luajnë traditat që përmbajnë informacione në lidhje me ngjarjet, rrethanat dhe situatat në të cilat, ose për të cilat, është zbritur Shpallja, që në këto situata, apo çështje që dalin prej tyre, të japin përgjigje. Njohja e këtyre traditave kontribuon në kuptimin e saktë të tekstit të Kuranit, e me këtë edhe përgjigjen e duhur praktike të atij teksti.

Esh-Shatibiu në librin e tij *El-Muvafekat*, ndër të tjera, thotë: "Kushdo që dëshiron të studiojë Kuranin, është e nevojshme të njohë shkaqet e Shpalljes ..."

Duke pasur parasysh këtë, sigurisht se këtë e kishte në dijeni edhe komentuesi i mirënjohur i Kuranit tek populli shqiptar, Hafiz Ali Korça, prandaj edhe në raste të caktuara gjatë komentimit të tij së ajeteve dhe sureve të Kuranit, i kishte përmendur edhe vetë shkaqet e ajetit apo sures për të cilën bënte komentim.

Prandaj, në vazhdim do të përmendim vetëm disa raste kur Hafiz Ali Korça i përmendi shkaqet e ajetit apo sures së caktuar:

- Kur e komenton suren *El-Kadr*, në fillim të kësaj sure thotë se përmbi zbritjen e kësaj sure janë përmendur disa shkaqe, por vërtetësinë e di veç Zoti.
- Kur e komenton suren *Et-Tekathur* thotë se shumica e tefsirëve përmbi zbritjen e kësaj sure thonë: "Nga Ensarët, nga burrat e Medinës që quheshin ndihmëtarët e Pejgamberit a.s., ndodheshin dy fise që i janë lavdëruar dhe përgëzuar njëri tjetrit me shumicën e pjesëtarëve dhe fisit të gjallë, e kur njëri fis fitonte shumicën me numërim, tjetri tha: "Ejani të shkojmë në varreza e t'i numërojmë burrat që i kemi pasur dhe t'ju tregojmë edhe vendin ku kanë vdekur. Atëherë zbriti për qortim kjo sure."
- Rreth shkaktit të zbritjes së sures *El-Humeze*, thotë: "Disa thonë se Ubejje bir i Halefit, e disa thonë për Ahmesin e disa për Xhemil

Amirin e të tjerë, kur e shihnin Resulull-llahun e qesëndisnin ku me sy e me vetulla e ku pështjellonin buzët. Atëherë zbriti kjo sure.”

- Rreth shkakut të zbritjes së sures *Ez-Zilzal*, thotë: “Disa nga mu'minët mendonin se Zoti i vërtetë si punët e mira të vogla ashtu dhe punët e këqija të vogla nuk i vënë re. Kështu thoshin dhe punëve të vogla nuk u jepnin rëndësi aspak. Atëherë zbriti kjo sure e cila në dy ajetet e fundit thotë se kush punon mirësi, sa rëndon një grimcë e atomit pas peshimit që do të ketë ajo mirësi do t' a sheh mirësinë e saj, ashtu edhe kushdo që të punën një të keqe, sipas rëndësisë që do të ketë ajo grimcë pas peshimit të saj do t' a sheh dënimin, se në këtë botë s'humbet gjë.”
- Gjatë komentimit të sures *Ed-Duha*, krejt në fillim e përmend edhe shkakun e zbritjes së kësaj sureje, ku thotë: “Shkaku i zbritjes së kësaj sureje mendohet a thuhet se ishte vonimi i Vahjit (Shpalljes) për disa ditë. Pra zbritja e kësaj sureje Muhamedit a.s., po i jep një ngushëllim të madh dhe po i jep një kujdes se Zoti me madhësinë e Vetë ka për t'ia plotësuar mirësitë më të mëdha njërën pas tjetrës. Ky vonim i zbritjes së Vahjit ka qenë në fillimin e profetësisë së tij.”

Komentimi shkencor i Kuranit nga Hafiz Ali Korça

Hafiz Ali Korça, duke qenë nën ndikimin e tefsirit shkencorë, ishte i mendimit se ekzistojnë krijesa edhe në planetët e tjera, duke e argumentuar mendimin e tij me ajetin 29 të sures *Esh-Shura*, ku Allahu xh.sh., thotë: **“Një prej shenjave të Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës dhe i qenieve të gjalla, që ka shpërndarë nëpër to; Ai është i Fuqishëm t'i tubojë ata kur të dojë”** (*Esh-Shura*, 29). Ai argumenton se përmendi “në të dyja” – فيهما - nënkupton ekzistimin e krijesave dhe gjallesave në tokë dhe në qiell, dhe se këto krijesa në tokë e në qiell cilëson si “gjallesa” - دواب – që ecin në këmbë ose rrëshqasin.

Në ajetin 164 të sures El-Bekare Allahu xh.sh., urdhëron: *“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt..”*

Sipas Hafiz Aliut, nga ky ajet Allahu xh.sh., na bënë me dije e një mënyrë na urdhëron që të mendojmë rreth krijimit të qiejve e të Tokës dhe fenomeneve të ndryshme në natyrë, e që gjithë kjo është krijimtari e Krijuesit Absolut, Allahut xh.sh. Shenjat që tregojnë njëshmërinë e madhësinë e Zotit, të cilat janë në milion. Sa i përket interpretimi të këtij ajeti, Hafiz Aliu thotë:

- 1) Na urdhëron që të mësojmë astronominë, dhe me anën e saj të kuptojmë krijimin e çuditshëm të Zotit. Allahu xh.sh., në disa vende në Kuran me një mënyrë na urdhëron që të mendojmë për krijimtarinë e Tij. Në ajetin e pestë të sures Esh-Shura thotë: *“Qiejt gati sa nuk çahen nga sipër (prej madhësisë së Allahut).”* Mbreti i të gjithë diturive, Fahrudin er-Raziu thotë se nuk do të ishte për çudi edhe po të kishte njerëz edhe në planetë tjera. Po ashtu, i Lartësuar në ajetin e tridhjetë të sures El-Enbija' urdhëron e thotë: *‘Mushrikët a nuk shohin, a nuk kanë trutë mendojnë që toka e qiejt ishin një copë e ngjitur (e bashkuar) por pas një kohe i ndamë?’* Pra, Kurani na urdhëron me u mëndu e me e kuptua astronominë.
- 2) Krijimi i Tokës. Në 13 vende në Kuran na urdhërohet që të bëjmë udhëtim në të katër anët e tokës, na urdhëron që të mundohemi e të kuptojmë çka ka përmbi të nga çdo pikëpamje.
- 3) Ndryshimi i natës dhe i ditës, të cilat tregojnë njëshmërinë e madhësinë e Zotit. Pas rregullat që i ka vënë Zoti, nuk zgjaten e as nuk shkurtohen as një minutë më tepër.
- 4) Edhe anijet prej disa dërrasash dhe e mbërthyer me disa gozhdë dhe lundron në të katër anët e deteve, tregon madhësinë e Zotit.

Detarët me anën e anijeve shohin shumë sende të çuditshme. Anijet rrugët i shkurtojnë fort. Zoti në këtë ajet na urdhëron që të përgatisim vegla për udhëtim në det, që të mundemi me bërë tregti e gjëra të tjera.

- 5) Na urdhëron që të mësojmë për fizikën, me anën e të cilës kuptohet se Zoti është një dhe i vërtetë.
- 6) Na urdhëron që të mësojmë edhe anatominë e biologjinë, të cilat kanë për mision shenja që na tregojnë se Zoti është një e i vetëm.
- 7) Na tregohet se era e ajri sa gjëra të mëdha e të çuditshme janë. Ai që ka tru, prej kësaj kupton më thellë njëshmërinë dhe madhësinë e Zotit.

Sot aeroplani po e zënë vendin e qilimit të Sylejmanit a.s., mbi të cilin ka udhëtuar.

- 8) Fryrja e erërave e shërbimi i tyre. Muhamedi a.s., urdhëron: “Si mjerë ai që këtë ajet e këndon edhe nuk mendohet e s' tmerrohet!”

Përfundimi

Nevoja për komentimin e Kuranit është e pashmangshme për çdo shoqëri dhe çdo kohë. Për këto fakte ishin të vetëdijshëm edhe dijetarë me origjinë shqiptare, të cilët investuan mundin dhe punën e tyre të palodhshme për të kontribuar në këtë fushë dhe i ofruan popullit të tyre interpretimin e Fjalës së Shenjtë në gjuhën shqipe.

Gjatë jetës dhe veprës së tij, Hafiz Ali Korça luftoi me pasion dhe zëmër për një të nesërme më të mirë të popullit shqiptar në sensibilizimin fetar, duke besuar se një popull që humb besimin do të humbasë edhe atdheun e tij dhe se këta dy faktorë janë të lidhur ngushtë.

Ai u ndesh me vështirësitë e sistemit dhe rendit shoqëror të asaj kohe, thujse gjatë gjithë jetës së tij ishte nën mbikëqyrjen e elitës politike dhe njerëzve në pushtet, por asnjëherë nuk u dorëzua dhe nuk devijoi nga rruga e drejtë, por ishte këmbëngulës në synimin dhe dashurinë ndaj rregullave fetare dhe interpretimi i mesazheve fisnike nga Kurani Famëlartë.

Kurani, si niveli më i lartë i shprehjes artistike, la gjurmë të thella, pra ndikoi në personalitetin e këtij dijetari shqiptar. Si rrjedhojë, njohuritë e tij për fenë ai i transmetoi nëpërmjet *metodës artistike*, përkatësisht figurave letrare stilistike siç janë: *simbolizmi*, *metafora*, etj. Ai përdori vargje si një nga metodat e tij në komentimin dhe përcjelljen e porosive fetare te populli i tij, dhe ishte një poet i kalibrit të lartë.

Myftiu në Malin e Zi me seli në Podgoricë (1887-1912) sipas dokumenteve arkivore

Mr. Ali Bardhi*

Abstrakt

Në këtë artikull, vijuar nga numri i kaluar, kemi trajtuar çështjet, që ndërlidhen me institucionin e Myftinisë nga zhvendosja e tij nga Ulqini në Podgoricë e më pas në Tivar (1887-1912) me theks në çështjen e emërimit të Myftiut, xhamitë, mejtepet, etj., në bazë të dokumentacionit arkivor dhe studimeve të publikuara. Institucioni i Myftinisë i formuar në kuadër të nenit 27, të Kongresit të Berlinit, me të cilin, Perandorisë Osmane i lejohej që të vendoste hierarkinë fetare në Malin e Zi dhe për rrjedhojë, myftinjtë u emëruan nga Shejhu'l-Islami në Stamboll dhe u miratuan nga Krajli i Malit të Zi, në qershorin e vitit 1912, po u vinte fundi, pasi Krajli në mënyrë të një anshme emëroi myfti, kadiun e Tivarit. Perandoria Osmane e kundërshtoi vendimin e njëanshëm, por fakti se në këto momente situata politike në rajon ishte përkeqësuar mjaftë, pasi po përgatiteshin luftërat ballkanike, lindi një

* Autori Mr. Ali Bardhi, është kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame në Ulqin të Malit të Zi. Masterin e ka përfunduar Master Degree-Istanbul të Marmara University, Instituti i Shkencave Sociale Dega Histori Islame në Republikën e Turqisë.
E-mail:islam@t-com.me.

situatë e re, me të cilën, vendimi i Krajl Nikollës mbeti më në favor.

Fjalë kyçe: *Mufti, arkiva, Shejhu'l-Islami, Ulqin, gjykata të sheriatit*

Abstract

In this article, continuing from the previous issue, we have addressed matters related to the institution of the Muftiate, from its relocation from Ulcinj to Podgorica and later to Bar (1887–1912), with an emphasis on the issue of the appointment of the mufti, mosques, religious schools (mejteps), and other related topics, based on archival documentation and published studies. The institution of the Muftiate was established under Article 27 of the Congress of Berlin, which allowed the Ottoman Empire to appoint the religious hierarchy in Montenegro. Consequently, muftis were appointed by the Sheikh al-Islam in Istanbul and approved by the King of Montenegro. However, by June 1912, this arrangement was coming to an end as the King unilaterally appointed the mufti-qadi of Bar. The Ottoman Empire opposed this unilateral decision, but given the deteriorating political situation in the region at that time, with the Balkan Wars looming, a new situation emerged in which King Nikola's decision ultimately prevailed.

Keywords: *Mufti, archive, Sheikhu'l-Islami, Ulcinj, Sharia courts*

Zhvendosja e Selisë së Myftiut në Podgoricë (1887-1912)

Në artikullin e publikuar në numrin e kaluar kemi trajtuar periudhën e Myftiut të Malit të Zi me Seli në Ulqin ndërmjet viteve 1881-1887, kurse në këtë artikull do të përfshijmë periudhën e Myftinisë gjatë viteve 1887-1912, kur Selia e saj zhvendoset nga Ulqini në Podgoricë, e më pas në Tivar.

Referuar të dhënës së Sima Popoviqit, që në vitin 1886 e njofton ministrin për arritjen e lajmit të ardhjes së Myftiut të ri në Ulqin dhe kërkesës së tij (S.P.) Qeverisë së Malit të Zi, për zhvendosjen e Selisë së Myftiut nga Ulqini në Tivar ose në Podgoricë, dhe e dhëna tjetër e tij e një viti më pas, (1887) që Selia e Myftiut të jetë zhvendosur nga Ulqini në Podgoricë, si edhe të dhënat e tjera të Arkivit Osman, na çon në mendimin, që Selia e Myftiut të jetë transferuar në vitin 1887, në kohën e Myftiut, Hasan Ismet Efendiut dhe jo në kohën e Mustafa Hilmiut, siç flitet, pasi ky i fundit në këtë detyrë nuk vjen deri në vitin 1889.

Qeveria malazeze synonte, që ta zhvendoste Selinë e Myftiut nga Ulqini në një vend tjetër me mysliman më pak, larg ndikimit të shqiptarëve, siç edhe u cek në dokumentet e arkivit Osman të publikuar në artikullin e kaluar, që Knjazi nuk mund të pranonte emërimin e një myftiu nga kombi shqiptar, të cilin e cilësoi si komunitet i pa marrë vesh.

Pas diskutimeve diplomatike ndërmjet Perandorisë Osmane dhe mbreërisë Malazeze u arrit konsensusi për çështjen e kombësisë së Myftiut, duke i evituar kandidatët me kombësi shqiptare, me të cilën tagri i emërimit të Myftiut vazhdohet, që t'i mbesë Shejhu'l-islamit dhe më pas, pason zhvendosja e Selisë së Myftiut, pasi siç do të vërehet për të dyja çështjet vërehet arritja e kompromisit ndërmjet palëve.

Vlen për t'u përmendur, që Selia e Myftiut edhe pse ishte transferuar në Podgoricë, që nga viti 1887, Ulqini akoma ruante prestigjin e vet tek institucionet e Perandorisë Osmane, pasi një gjë të tillë e shohim edhe nëpërmjet një dokumenti të arkivit osman të datës, 22.07.1325 h./

31.08.1906 m., në të cilin shënohet “Ülgün müftüsü Hilmi Efendi” që d.m.th. “Myftiu i Ulqinit Hilmi Efendi”.

Pas emërimit të Hasan Ismet Efendiut në detyrën e Myftiut, ai qëndroi rreth dy vite me një pagë prej dymijë e pesëqind (2500) kurushve.

Duke qenë se ai qëndroi vetëm dy vite në detyrën e Myftiut, nuk posedojmë dokumentacion të mjaftueshëm të veprimtarisë së tij. Veprimtaria e tij më tepër duhet të ketë qenë në kuadër të ndreqjes së marrëdhënieve ndërshtetërore. Shohim përpjekjet për hapjen e disa shkollave (mektebeve) në Podgoricë e Ulqin pas një kohe, që kishin qenë të mbyllura.

Sipas një dokumenti të arkivit osman të vitit 1889, të cekur më lart, shohim se ai dha dorëheqje nga detyra e Myftiut pas vdekjes së dy fëmijëve të tij në Podgoricë. Po sipas një shkresë tjetër të Shejhu`l-islamit, Omer Lutfi, dërguar Ministrisë së jashtme, datë 28 shaban 1306 h./27 prill 1889 m., shohim se në këtë datë, Hasan Ismet Efendiut dha dorëheqje nga detyra e Myftiut dhe në vend të tij u emërua Mustafa Hilmi Tikveshliu. Në këtë detyrë myftiu i ri u caktua me një pagë prej 1777,18 kurushëve nga Perandoria Osmane dhe 2000 frangave nga Qeveria malazeze.

Referuar dokumentacionit osman, shohim se Hasan Ismet Efendiut dhe Mustafa Hilmi Tikveshliu, për punën e tyre në Mal të Zi, u akordohen medalje nga Knjazi. Sipas një dosjeje të arkivit osman, të datës 20 korrik 1309 rumi / 2 tetor 1893, shohim se Qeveria e Malit të Zi i kishte akorduar H. Ismet Efendiut, medaljen e Danillos, pas dhënies së dorëheqjes, e cila i erdhi si shkak i vdekjes së dy fëmijëve të tij në Podgoricë. Po sipas një dosjeje tjetër të arkivit Osman, të vitit 1897, shohim lejen e dhënë edhe për Mustafa Hilmiun nga qeveria osmane për marrjen e medaljes së Shën Savës nga Qeveria serbe dhe Danillos nga ajo malazeze, më përpara se të shkarkohet. Kurse më herët, më 19 shaban 1309 h / 19.03. 1892, ai kishte marrë një medalje Mexhid-i Nishan të kategorisë së tretë.

Nga ç'shihet, ndërtime të reja të xhamive dhe mejtepeve/shkollave thuajse nuk ka pasur deri në vitin 1887, kur u normalizuan marrëdhëniet

ndërshtetërore për çështjen e Myftiut, kurse hov morën, pas emërimit të Myftiut të tretë, Mustafa Efendi Hilmiut.

Sipas një dokumenti të datës 05. 08. 1899, shohim kërkesën e bano-rëve të fshatrave Kruç, Krythë dhe Salç, drejtuar Myftiut të myslimanëve të Malit të Zi, për ndërtimin e xhamisë, e që u ndërtua.

Sipas një dokumenti/shkresë të nënshkruar në vitin 1904, nga Myftiu i Malit të Zi, Mustafa Hilmi, të publikuar, shohim se kjo Myftini, e cila administronte tre kadillaqe, numëronte dyzetë (40) xhami. Kadillaku i Ulqinit (13 xhami). Tivari (11 xhami) së bashku me një pjesë të Krajës (7 xhami). Podgorica (7 xhami) së bashku me Spuzhin dhe Nikshiqin me nga një xhami. Kurse nga një shkresë tjetër të Myftiut në vitin 1911, shohim listën e të gjithë imamëve dhe të mësimdhënësve të mejtepeve, Kadillaku i Ulqinit (11 xhami dhe 3 mektebe/shkolla), i Tivarit&Krajë (18 xhami dhe 2 mektebe), i Podgoricës (5 xhami dhe 3 mektebe) e Nikshiqit (1 xhami) dhe e Goriçanit (1 xhami) me gjithsej 36 xhami. Në listën e dytë kemi rënien e numrit të xhamive nga 40 në 36. Më poshtë po paraqesim listën e xhamive:

Lista E xhamive dhe klerikëve (imamëve) pranë tyre në Mbretërinë e Malit të Zi

NR.	KADILUKU I	EMRI XHAMISË SIPAS VENDIT	EMRI DHE MBIEMRI I IMAMIT	VËREJTJE
1	Ulqin	E qytetit	Hafiz Muhamed Elezaga	
2	--	E Meterizit	Hafiz Hasan Guçi	
3	--	E Pashës	Molla Ismail Naza	
4	--	Kryesore	Hafiz Hasan Mavriqi	Sabor / kuvend
5	--	Maje Pazarit	Hafiz Hysein Mujali	
6	--	Lamit	Hafiz Jusuf Cungu	
7	--	Merasë	Hafiz Junus Llunji	
8	--	E Zogajve	Hafit Beg Resulbegoviq	Fshati Zogaj

9	--	E Pistullës	Mulla Jakup Milla	
10	--	Kollonzës	Molla Hysein Bushati	
11	--	E Krruçit	Mulla Musa Bushati	
12	Tivar	E Varoshit	Mulla Mehmet Krçiković	
13	--	E Plloçicës	Sulejman Hoxhiq	
14	--	E Podgradit (Nënqytet)	Hafiz Hysein Karagjuzović	
15	--	E Zalevit	Murteza Karagjuzović	
16	--	E Dobrovodes (Ujëmirës)	Mulla Mehmet Shllaković	Fshat
17	--	E Peçuricës	Mulla Ali Suliçiq	
18	--	E Kunjes	Hafiz Ibrahim Lika	
19	--	E Goranës	Hafiz Hamid Buzuku	
20	--	E Mërkotit	Hafiz Mulla Mehmed Hamziq	
21	--	E Mikuliqit	Selman Omeralloviq	
22	--	E Tugjemilit	Hafiz Muhtar Beg Haveriq	
23	--	E Qyrjanit	Mulla Veli Hoxha	Krajë
24	--	E Runjit	Mulla Sulejman Hoxhiq	
25	--	E Kështenjës	Mulla Sulejman Efendi	
26	--	E Baboshtit	Hafiz Abdyl Efendija	
27	--	E Ftjanit	Mulla Tahir Hoxha	
28	--	E Muriqit Poshtë	Mulla Jakup Podgorica	
29	--	E Muriqit Naltë	Hasan Sabiq	
30	Podgoricës	E Glavatoviqit	Hafiz Husein Averiq	Sabor/kuvend
31	--	Predgradska (Periferisë)	Mulla Murat Haveriq	
32	--	E Re	Mehmed Hoxha	

			Avdagiq	
33	--	E Adroviqit	Haxhi Hafis Sharkiq	
34	--	E Draçit (Durrësit)	Haxhi Zuber Vraniq	
35	--	E Nikshiqit	Mehmed Hoxha Rexhepspaq	Nikshiq
36	--	E Goriçanit	Mahmut Mustaj- grudiq	Fshat në Zetë
				Myftiu i Malit të Zi Mustafa Hilmi

Ekzistojnë disa mendime rreth shkarkimit të Mustafa Hilmiut. Sipas disa të dhënave, ai dha dorëheqjen pasi ndërmjet mbretërisë malazeze dhe tij ka ardhur deri të mosmarrëveshja, e në veçanti pas vendimit të Qeverisë malazeze, se të vdekurit nuk mund të varrosen para kalimit të kohës prej 24 orëve, çka ka qenë kundër dispozitave të sheriatit. Por kjo e dhënë nuk korrespondon me vitet, pasi sipas një dokumenti në arkivin e Cetinës, të vitit 1906, shohim ankesën e Myftiut në drejtim të Ministrisë së Drejtësisë, rreth disa neneve 329, 362, 364, të Kodit Penal, në të cilat përfshihet edhe ndalesa e cekur më lart, për moslejimin e varrosjes para 24 orëve, çka lë të kuptohet, se po të ishte ky shkaku i shkarkimit, atëherë Myftiu duhej që të ishte larguar që në vitin 1906/1907, e jo të pres deri në vitin 1911.

Kurse sipas një dokumenti tjetër të Arkivit të Cetinës, më 23. 05. 1911, sekretari i sheriatit, Nikolla F. Lumoviq i dërgon një shkresë Ministrisë së Arsimit dhe punëve Kishtare në Cetinë, i cili e informon, se Shejhu'l-islami e ka shkarkuar Myftiun Mustafa Hilmiun, e flitet se arsyeja kryesore është, sepse Kadiu i Tivarit, Murteza Karagjuzoviq dhe Jusuf Beg Resulbegoviq, deputet popullor, përfaqësisë osmane në Cetinë i kanë dhënë nënshkrimet kundër punës së rregullt të Myftiut, çka me shumë gjasa, kjo duhet të jetë bërë shkak i shkarkimit të tij.

Ndërkaq sipas dosjes personale të Mustafa Hilmiut në arkivin e Meshihatit në Stamboll, shohim se ai qëndroi në këtë detyrë nga 27 shaban

1306 h. / 27 prill 1889 deri më 09 xhumade`l-ula 1329 h./ 25 nisan 1327 rumi / 08 maj 1911, miladi kur u shkarkua nga Shejhu`l-islami.

Sipas një shkresë tjetër të kësaj dosjeje, dërguar zyrës së Meshihatit Islam në Stamboll më 28 kanun-i sani 1327 rumi / 10 shkurt 1912, ndër të tjerash, citon për disa raportime të bëra në drejtim të tij si jo të drejta. Njëherësh shton se për çështjet gjyqësore të sheriatit të myslimanëve në Mal të Zi, janë përkthyer edhe në gjuhën zyrtare të shtetit. Po kështu nga kjo shkresë, ai vë në pah planet e Qeverisë malazeze, që në mënyrë të njëanshme do që të emërojë Kadiun e Tivarit, Murteza Efendiun, për Myfti të ri. Në shkresën në fjalë ceket se edhe pse qeveria malazeze ka në plan që ta emërojë për Myfti, Murteza Efendiun, me mendimin, që është shtetas i Malit të Zi, popullsia e besimit islam në Mal të Zi në mënyrë kategorike nuk e pranon atë dhe se emërimi i Myftiut është e drejtë e garantuar dhe detyrë e shtetit Osman, në mënyrë që të ruaj influencën e vet.

Menjëherë pas shkarkimit të Mustafa Hilmiut, Shejhu`l-islami i mori masat, duke emëruar për Myfti të ri, Mehmet Murat Efendi Muratagen, i lindur në Podgoricë. Në bazë të dokumentacionit arkivor Osman, shohim se Murat efendi figuron në detyrën e Myftiut të Malit të Zi ndërmjet intervalit kohor gusht, 1911- maj, 1912.

Referuar dokumentacionit arkivor, përsëri u hapën mosmarrëveshje ndërmjet Qeverisë malazeze dhe Shejhu'l-islamit. Sipas një dokumenti të datës 25 shubat 1327 rumi / 9 mars 1912 Shejhu'l-islami e kishte emëruar naibin e kazasë së Palankes Mehmed Murad Efendiun, kurse Qeveria e Malit të Zi donte të emëronte Kadiun e Tivarit, Ali Murteza Efendi Kargjuzoviqin. Shejhu`l-islami ishte kundër vendimit të Krajl Nikollës, pasi në bazë të nenit 27, të Marrëveshjes së Kongresit të Berlinit, çështja e emërimit dhe e shkarkimit të Myftiut, i takon Meshihatit Islam në Stamboll. Për më tepër, Myftiun që emëroi Shejhu`l-islami, ishte i lindur në Podgoricë, gjë që në këtë kohë kishin filluar debatet rreth shtetësisë së Myftiut, njëjtë si për patriarkët, që funksiononin brenda shtetit osman. Por çështja u thellua edhe më tej, sa që në vitin 1912, Ministria e jashtme

osmane i dërgoi ambasadorit të vet në Londër kërkesën për në Konferencën e Londrës, ku referuar marrëveshjes së mëparshme të arritur në Kongresin e Berlinit, ngulej këmbë, që çështja e emërimit dhe e shkarkimit të Myftiut të Malit të Zi, i takonte vetëm Meshihatit Islam në Stamboll.

Nuk kemi të dhëna si ka vijuar më tej situata, të jetë implementuar apo jo vendimi i Shejhu'l-Islamit për marrjen e detyrës së Myftiut nga Mehmet Murat Efendi Podgorica. Për një çast ky dualitet, duket se mbeti i paqartë. Por fakti se në këto momente situata politike në rajon po rëndohej, pasi po përgatiteshin luftërat ballkanike, lindi një situatë e re, me të cilën, vendimi i Krajl Nikolles ishte më në favor. Duke qenë se po fillonin luftërat ballkanike, me të cilën, Perandoria Osmane filloi të humbë administrimin e Ballkanit, shohim se më superior në këtë rivalitet do të mbetet për Myfti, Murteza Karagjuzoviq, ku në mënyrë të njëanshme më 17 qershor 1912, Krajl Nikolla emëroi për Myfti të Malit të Zi. Ai e filloi detyrën e Myftiut, duke e **zhvendosur Selinë e Myftiut nga Podgorica në Tivar**, por pa iu dhënë dekreti (Menshura) nga Shejhu'l-Islami.

Pasi Murteza Efendiu u emërua Myfti i Malit të Zi nga Krajl Nikolla, atij i duhej që të merrte dekretin nga Shejhu'l-Islami. Por ky emërim iu kërkua Vilajetit të Shkodrës. Ndërkaq Vilajeti i Shkodrës pasi konstatoi që emërimi i Myftiut nga Krajli i Malit të Zi, tashmë ishte i padobishëm për Perandorinë Osmane, zyra e Shejhu'l-Islamit nuk e pa të arsyeshme që t'i përgjigjej.

Përfundim

Nga sa u pa në artikullin e publikuar në numrin e kaluar dhe në këtë artikull, referuar dokumentacionit arkivor, shohim se, pa u përcaktuar data e saktë e fillimit, në intervalin kohor mars 1881-qershor 1912, në Malin e Zi ekzistonte institucioni i Myftinisë. Në kuadër të marrëveshjes së Kongresit të Berlinit, tagrin e emërimit të Myftiut e kishte Shejhu'l-Islami në Stamboll edhe miratimi bëhej nga Qeveria e Malit të Zi.

Myftiu administronte jetën fetare islame, si edhe tre kadi (grykëta të shariatit-mahkemei shërijje), në Ulqin, Tivar dhe Podgoricë.




Referuar këtij dokumentacioni arkivor, shohim se në këtë interval kohor në Mal të Zi, janë emëruar këta myfti: Salih ef. Hyli (mars? 1881-1885?), Hasan Ismet Efendi (shtator 1887-prill, 1889), Mustafa Hilmi Tikveshlija (prill, 1889-maj, 1911), Mehmet Murat Efendi Podgorica (gusht, 1911- maj, 1912) dhe nga qershori i vitit 1912, u emërua Ali Murteza Karagjuzoviq, deri në abrogimin e Myftinisë së Malit të Zi, nga Mbretëria SKS.


Përveç kësaj, Selia e Myftiut të Malit të Zi, deri në vitin 1887, ka qenë në Ulqin, e cila pas shumë ngjarjeve u zhvendos në qendrën e dytë islame në Podgoricë, në kohën e Hasan Ismet Efendiut, e cila zgjati deri në qershorin e vitit 1912, kur u zhvendos në Tivar, në kohën kur Krajl i mënyrë të njëanshme emëroi Myfti, Kadiun e Tivarit Murteza Karagjuzoviqin.

Perandoria Osmane e kundërshtoi këtë vendim të njëanshëm, por ndryshimet politike në rajon u bënë shkak, që vendimi i Krajlit të jetë më në avantazh. Çështja u përkeqësua mjaftë, sa që më 1912, Ministria e jashtme osmane, nëpërmjet ambasadorit të vet i dërgon një notë proteste në Konferencën e Londrës, me të cilën pretendonte, që, çështja e emërimit dhe e shkarkimit të Myftiut të Malit të Zi, i takonte vetëm Meshihatit Islam në Stamboll. Por kapitullimi i Perandorisë Osmane bëri, që, kjo çështje tashmë t'i mbetet Qeverisë malazeze.


Në periudhën e cekur më lart kemi një ballafaqim në lidhje me kompetencat e emërimit të Myftiut, qendrën, kompetencat e Myftiut, gjuhësinë, vendin prej nga vjen dhe kombësinë e tij, çështje të cilat mbeten të trajtohen edhe më tej në të ardhmen pikërisht për periudhën 1881-1912.

SHTOJÇË


Vulat e Myftive të Malit të Zi (1881-1912)	
<p>Mungon</p> <p><i>Myftiu i Parë - Myderrizi Salih Efendi Hylja (mars 1881-janar-shkurt? 1885)</i></p>	 <p><i>Myftiu i dytë - Sejjid Hasan Ismet Efendi (shtator 1887-prill 1889)</i></p>
 <p><i>Myftiu i tretë - Mustafa Hilmi Tekveshi (prill 1889-maj 1911)</i></p>	 <p><i>Myftiu i katërt - Mehmed Murat Efendi, (gusht 1911-maj 1912).</i></p>




Myftiu i pestë - Karagjoz-Zade Ali Murteza
Më përpara Naibi (Kadiu) i Kazasë së Tivarit




Murteza Karagjuzoviq
(kiril)



Naibi (Kadiu) i Kazasë së Ulqinit
Hafiz Hysein Sidki
(Mujali)




Nr. I.
Dokument i datës 8 muharrem 1305/26 shtator 1887 nëpërmjet të cilit shohim përfundimin e procedurës së emërimit të Myftiut të ri, Hasan Ismet ef.



Nr. II.
Viti 1886 – Administratori i Ulqinit, Simo Popoviq, propozon që Qendra e Bashkësisë Islame të Malit të Zi të mos jetë më, në Ulqin, por të zhvendoset në Tivar ose Podgoricë.


Arkivi Shtetëror i Malit të Zi. Shih www.arkiva.me Marrë, më 27.05.2024.



HR. TH.00088.00086.001

Nr. III.

Dokument i datës 28 shaban 1306 h./27 prill 1889 m., ku shihet dorëheqja e Hasan Ismet Efendiu nga detyra e Myftiut të Malit të Zi, dhe marrja e vendimit nga Shejhu'l-islami (Omer Lutfi) për të emëruar Mustafa Hilmi Tikveshliun, myfti të Malit të Zi.



Nr. IV.

Dokument i vitit 1912, i Ministrisë së Jashtme Osmane, dërguar Ambasadës së saj në Londër për ta paraqitur në arenën ndërkombëtare në Konferencën e Londrës, ankesën rreth emërimit të Myftiut, me të cilën kundërshton emërimin e padrejtë të Myftiut nga Krajl Nikolla, duke deklaruar se ishte në kundërshtim me vendimet e Kongresit të Berlinit.

Kontributi i Daut Efendi Boriçit për Gjuhën Shqipe

Ademir Xama*

Abstrakt

Një nga pasuritë tona kombëtare, ndoshta dhe më e lashta, është edhe gjuha shqipe. Për të ruajtur gjuhën shqipe kontribuan ndër shekuj shumë figura të shquara të dijes e të pendës. Një ndër ta është edhe Daut Efendi Boriçi. Mulla Dauti kishte një detyrë shumë fisnike në arsim. Ai fillon karrierën si mësues, për t'u emëruar drejtor i shkollës Ruzhdije në vitin 1865, e më pas, nga viti 1870 deri në vitin 1879, inspektor i arsimit fillor në Vilajetin e Shkodrës. Duket se Mulla Dauti gjatë detyrave si mësues, drejtor, e më pas si inspektor i arsimit, konstaton nevojën, që populli kishte për shkrim dhe lexim të gjuhës shqipe. Edhe pse në Shkodër

* Autori Ademir Xama lindi në Shkodër 19.10.1988. Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Shkodër. Në vitet 2003 – 2005 ka mbaruar Institutin "Ebu Hanife" në programin e studimeve Islame dhe Gjuhë Arabe në Bulqizë. Nga viti 2005 është Imam Hatib i xhamisë së lagjes bahcallëk në Shkodër. Nga viti 2015 angazhohet si përgjegjës i departamentit të ftesës dhe edukimit pranë shoqatës Ardhmeria dega Shkodër. Në vitin 2015 – 2019 ka kryer programin për specializim në programin Da`va dhe Edukim në Stamboll në organizatën "Federation of islamic organisation in Europ". Në vitet 2017-2023 ka mbaruar studimet Bachelor në Fakultetin e Studimeve Islame në programin Teologji Islame në Prishtinë. Aktualisht është student në nivelin master në Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë. E-mail: ademirxama@gmail.com.

në ato vite sipas dëshmive flitej shqip dhe kur ishte nevoja edhe osmanisht, arabisht dhe persisht. Ndikim tek Mulla Dauti duket se kishin njerëzit e dijes, siç ishte Hasan Tahsini, me të cilin u takua para se të kthehej në Shqipëri gjatë studimeve të tij në Stamboll. Ai abetaret e tij i bazon në shkronjat e gjuhës osmane-arabe, ku dhe krijon edhe 7 shkronja të tjera për nevoja të gjuhës shqipe.

Fjalet kyqe: *Gjuha shqipe, Abetaret e Daut Boricit, Abetaret e para shqip, karakteristikat e abetareve, Abetare me shkronja osmane, etj.*

Kush ishte Daut Efendi Boriçi?

Daut Boriçi, sipas autobiografisë së tij, u lind në Shkodër më 20 dhjetor të vitit 1825. Vetë ai shënon, se mësues mejtepi të parë ka pasur Mulla Ferhatin, hoxhë nga Shkodra, që ka jetuar në periudhën kohore 1772-1844. Kjo shkollë fillore gjëndeje në Pazar të Vjetër dhe Dauti, tetë vjeçar, frekuentoi bashkë me të vëllanë, Salihin.



Sipas shënimeve të të atit, Dauti, pasi mbaroi shkollën fillore, fëmijërinë e kaloi pranë familjes. Në autobiografinë e vet, Dauti shënon se që në vitin 1839, kishte filluar të mësonte arabishten dhe të merrte mësim teologjie nga myderrizët e mirënjohur shkodranë të Medresesë së Qafës, institucion i themeluar nga Mehmet Pashë Plaku dhe nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Mustafa Pashës, edhe kur ai ndodhej larg Shkodrës, si dhe nga dora e pedagogëve të respektuar, Salih Ef i Madh, Mulla Ahmet Hadri dhe Mulla Sylo Fakja. Më 26 maj 1848, u emërua imam i xhamisë së Draçinit, dhe, që në atë kohë u quajt Mulla Dauti. Pas dy vitesh shërbimi, me 1850 u nis për Stamboll dhe me 21 tetor u regjistrua në me-

dresenë Çifte-Bash Kurshun, një nga medresetë e Mehmetit II. Pasi mbaroi studimet dhe u kthye në vendlindje, filloi karrierën e mësuesisë në shkollën “Ruzhdije” në Pazar të Vjetër, hapur në vitin 1858. Shkollës “Ruzhdije” i përgjigjet shkolla e sotme tetëvjeçare, që për kohën ishte shkollë e tipit më të përparuar, e ndjekur nga shumë bij të familjeve të qytetit, kryesisht myslimanë, pa përjashtuar edhe familjet e krishtera.

Kontributi i Daut Boriçit për Gjuhën Shqipe

Ai është autor i botimit të abetares së parë turqisht – shqip në themel të një alfabeti me shkronja arabe. Duke qenë se ndalohej botimi i broshurave në gjuhën shqipe, ai e botoi pa emër. Kjo vepër përmbante 226 fjalë, emra, mbiemra, folje e fjalë të tjera dhe 25 fjali. Përveç kësaj vepre, Daut Boriçi ka lënë dhe vepra të tjera në gjuhën shqipe, si gramatika e gjuhës shqipe, vepër kjo e papërfunduar prej tij, fjalori turqisht – shqip, dhe dy përpjekje për abetare të ndryshme nga ajo e para.

Studiuesit flasin për tri abetare të Daut Boriçit, i cili në fundin e viteve 1860, harton abetaret e para:

1. Abetare shqip litografuar në Stamboll më 1861 (ribotuar më 1869).
2. Abetare shqip e ndryshme prej së parës, dorëshkrim.
3. Abetare shqip, ndryshe prej tri të parave. Abetarja e parë e D. Boriçit është një abetare shqip - turqisht, me shkronja arabe, turke dhe krijime origjinale të autorit, prej 32 faqesh, e hartuar sipas metodës sintetik. Alfabeti i saj ka 37 shkronja, nga të cilat 28 janë të alfabetit arab, 2 janë marrë nga osmanishtja dhe 7 i ka krijuar vetë. Në faqet e saj lexojmë: **"Xen me shkru shqip..."**.

Studiuesit e abetareve shqipe, na bëjnë me dije se: “Daut Boriçi hyri në rolin e korifeut si didakt, si tekstolog dhe si organizator i arsimit popullor. Ai zuri në Veri këndin e trinomit, që kishin plotësuar më pare, Naumi në Jug dhe Kristoforidhi në kërthizë të Shqipërisë”. Gjatë hulumtimeve, kam gjetur të shkruar me dorën e këtij njeriu të ditur edhe urtësi të shumta, që vlejné në jetën e shqiptarëve, si: **“Shkrimi ngelet në libër, ndërsa autori shkrihet në dhé”, “Mëso o bir, se injoranca**

është turp. Atë s'e pranon veçse gomari", "Thotë Resulull-llahi (s.a.v.s): Ai që vdes në rrugën e kërkimit të dijes, vdes shehid".

Ashtu siç thuhet në Historinë e Shqipërisë, *"...kleriku patriot mysliman, Daut Boriçi, botoi me 1869, në Stamboll një abetare të gjuhës shqipe, e cila duke përdorur alfabetin arab, përpiqej të fitonte për çështjen kombëtare shtresa e gjerë e popullatës myslimane, pa rënë në sy të censurës."*

Po përmendim disa mendime dhe analiza në lidhje me abetaren e Daut Boriçit me shkronja arabe. Pikërisht Daut Boriçi botoi abetaren turqisht-shqip në themel të një alfabeti të hartuar prej tij me shkronja arabe. Dhe këtë e botoi pa emër të vetin e pa datë, sepse ishte e ndaluar shtypja e një broshure në gjuhën shqipe, qoftë edhe me alfabet arab. Ndërsa një këndvështrim tjetër jep Myftiu i shkodrës, Imam Muhamed Sytari "Alfabeti shqip me shkronja arabe, natyrshëm përkthen orientimin e natyrshëm fetar islam të këtij dijetari të shquar, që në të vërtetë ishte orientimi i pjesës më të madhe të popullatës shqiptare dhe trend i kohës." Edhe Nathalie Clayer jep mendimin se: "Nëse mbështetësit e alfabetit latin vinin në dukje identitetin evropian, një identitet shqiptar dhe një dallim kundrejt turqve, cili ishte pozicioni i partizanëve të alfabetit arab? Ajo, që konstatohet menjëherë është se identiteti i pare, që ata vinin në dukje ishte identiteti fetar mysliman. Ne fakt, alfabeti arab ishte pazgjidhshmërisht i lidhur me frymën e Kur'anit... Partizanët e tij flisnin haptazi për shkronjat e Kuranit të lavdishëm dhe fisnik".

Në hyrje, autori e justifikon kështu zgjedhjen e tij: "Duke qenë se shqiptarët mësojnë me alfabetin arab, që përdoret nga myslimanet, nuk e pashë të nevojshme të krijoja shkronja të tjera për alfabetin e shqipes, dhe kështu, në hartimin e këtij alfabeti, kam marrë si bazë alfabetin arab, por kam bërë disa modifikime siç e kërkon natyra e shqipes. Sipas biografisë administrative të Daut Boriçit, ai kishte shkruar dy broshura të destinuar për mësimin e gramatikës dhe sintaksës së gjuhës shqipe në shkollat rryzhdije.

Daut Boriçi përmendet se në fillim të vitit 1882, u kishte propozuar autoriteteve osmane, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit Publik, të shtype-shin abetare dhe gramatika të gjuhës shqipe me shkronja arabe.

Ndjenja kombëtare e shqiptarëve mysliman dhe e shqiptarëve në përgjithësi ishin të orientuara në mbrojtjen e unitetit kombëtar shqiptar. Andaj, kur kihen parasysh të dhënat, që u sollën në frymën fetare e moralizuese të gjuhës shqipe me alfabet arab, përkatësisht në kulturën shqiptare të provincës islame, nuk do parë vetëm me qëllimin e Levizjes Kombëtare për shpëtim nga Perandoria Osmane, por do parë edhe rolin e saj mobilizues të masave kundër robëruesve të rinj, të krishterë evropianë, të dëmshëm për ardhmërinë shqiptare.


Përpjekja e Boriçit për t'ua mësuar fëmijëve dhe më gjerë gjuhën shqipe me shkronja arabo-turke, duke qenë medresist i Stambollit dhe punonjës i Administratës Osmane, mendojmë se duhet konsideruar si përpjekje e madhe në kushtet e pushtimit, gjetje e një rruge efektive për të mbajtur gjallë dhe për të shkruar gjuhën shqipe. Porosia e tij drejtuar nxënësve shqiptarë: "*... xen me shkru shqip...*" që lexojmë në faqen 32, të abetares, është vazhdim i kredos së tij politike, është plan-programi i punës së tij për ta bërë gjuhën shqipe si gjuhë mësimi.

Këto burime të islamit parashihnin mundësinë e përhapjes së diturisë në gjuhë të popujve. Andaj përdorimi i alfabetit arab në letërsinë (gjuhën) shqipe kur nuk ekzistonte alfabeti në nivel të kombit, nuk paraqet element të huaj në kulturën shqiptare.

Abetaret e Daut Boriçit

Rreth botimeve të abetares, si dhe rreth veprave të tjera, Prof. Dr. Jup Kastrati ka dhënë një informacion më të gjerë në "Buletinin për shkëmbimin e eksperiencës" të vitit 1954, Shkodër, Nr. 9, fq. 7, duke e paraqitur të plotë në veprën e tij "Figura të ndritura të Rilindjes Kombëtare". "*Shqiptari me mënyrën e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, mbrenda pak kohe mundet me shkru gjuhën e vet...*". Këtë deklaronte, si kredo politike, Daut Boriçi, në librin e tij. "ABETARE SHQIP"

*Xen me shkruie shqip ** Edhe turçen (turqishten) xen (mësoje)



- 1) “Alfabet shqip” me shkronja turqishte. Litografue në Stamboll më 1861. Në faqen 32, në mes të tjerash, lexohen edhe këto: “Punën shikoje, se marrohe mandej; xen me shkruie shqip”.
- 2) Një ribotim tietër është ai i vitit 1869.
- 3) “Abetare shqip” E ndryshueme prej së parës. Dorëshkrim. Teksti nis me këto fjalë të shkrueme nga autori: “Shqiptari, me mënyrën e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, brenda pak kohe mundet me shkruie gjuhën e vet...”
- 4) “Abetare shqip”, e ndryshueme prej tri të parave. Në verso të fletës së katërt lexojmë konceptin e një letre, që i dërgon nga Stambolli,

djalit të vet. Duket se ky dorëshkrim asht hartue pas pak kohë, që u internue në Turki, d.m.th. rreth vitit 1881.

- 5) “Gramatikë shqipe” (e vogël). Njohuri të përgjithshme numrin, gjininë, etj. Vepra asht e pakryeme. Dorëshkrim...
- 6) “Fjalor turqisht-shqip”. Dorëshkrimi ruhet në Arkivin e Shtetit. Vepër e papërfunduar.

Përveç këtyre la dorëshkrim një autobiografi dhe dy ditare, njeri i vitit 1884-1850, tjetri i vitit 1893-1895.

Karakteristikat e Abetareve të Daut Boriçit

Gjatë punës për hartimin e historisë së “Abetareve shqipe...” në bashkëpunim me Prof. Dr. Shefik Osmanin, ne jemi marrë edhe me abetaret e tij, por tani po japim në mënyrë të përmbledhur punën, që ka bërë Daut Efendi Boriçi në këtë fushë.

“Shqiptari me mënyrën e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, mbrenda pak kohe mundet me shkruë gjuhën e vet”. Këtë deklaronte, si kredo politike, në librin e tij **“Abetare shqip”** më 1869.

Pas “Ëvetareve...” të Naum Veqilharxhit, pas abetareve të Kristoforidhit dhe atyre të Daut Efendi Boriçit, shpalosej programi i madh i zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe. Boriçi në mes të 37 shkronjave, 7 i hartoi vetë, nga ato fonema, që i korrespondonin shqipes. Me këtë hap që bëri, ai provoi se shqipja ka veçoritë e veta, se alfabetet e grafitë e tjera nuk i plotësonin kërkesat gjuhësore të saj, se nga ana didaktike duheshin hedhur hapa të tjerë. Ndaj vepra e Boriçit përputhet me atë të Veqilharxhit dhe me atë të Kristoforidhit, duke përbërë atë trinom, që ka për bazë abetaret e para, mbi të cilën është ndërtuar tërë fondi i artë e abetareve shqipe. Në shtypin tonë janë dhënë mendime për abetaret dhe ribotimet e bëra nga ky autor. Daut Efendi Boriçi hartoi dhe botoi këto abetare shqipe:

“Abetare shqip” me shkronja arabo-turke, litografuar në Stamboll, më 1861. Ribotim i saj më 1869. **“Abetare shqip”**, e ndryshme prej së parës.

“Abetare shqip” e ndryshme prej dy të parave.

Nga transkriptimi i plotë i abetares së parë të viteve 1861 dhe 1869, mund të themi se ajo është një abetare shqip-turqisht, me shkronja arabo-turke dhe me krijime origjinale të autorit, pa asnjë shënim në frontespice, pa vit e vend botimi, siç bëheshin nganjëherë këto lloj botimesh në Lindje.

OSMANISHI	ARABISHI	TE KRIJUARA NGA D. BORIÇI	TE KRIJUARA NGA AL SHQIP	1.	2.	3.	4.
ا	ا		ə/a	ا	ا	ا	rr
ب	ب		b	ب	ب	ب	z
پ	-		p	پ	پ	پ	zh
ت	ت		t	ت	ت	ت	s
ث	ث		th	ث	ث	ث	sh
ج	ج		xh	ج	ج	ج	s(t)
چ	-		ç	چ	چ	چ	d(f)
-	-	خ	c	خ	خ	خ	t(f)
ح	ح		h	ح	ح	ح	dh
خ	خ		kh	خ	خ	خ	ayn
د	د		d	د	د	د	gh
ذ	ذ		dh	ذ	ذ	ذ	g
ر	ر		r	ر	ر	ر	f
				ق	ق	ق	kl(f)
				ك	ك	ك	k

- Kolona 1 është alfabeti Osman
- Kolona 2 është alfabeti Arab
- Kolona 3 janë shkronjat e krijuara nga Daut Boriçi
- Kolona 4 janë shkronjat Shqip

1.	2.	3.	4.
گ	-	-	g
-	-	ن	ng
ل	ل	-	l
-	-	ز	zj
م	م	-	m
ن	ن	-	n
-	-	د	nd
و	و	-	v
ه	ه	-	h
ی	ی	-	j

Është hartuar sipas metodës sintetike. Pikënisje janë marrë njësitë e vogla të gjuhës, tinguj-shkronjat. Kështu teksti me paraqitjen e të gjitha shkronjave të alfabetit, të cilat vendosen në katër kolona, ku shkronja është në pozicione të ndryshme: më vete, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Alfabeti i kësaj abetareje ka 37 shkronja, nga të cilat 28 janë marrë të alfabetit arab, 2 i ka marrë nga osmanishtja dhe për të plotësuar nevojat e gjuhës sonë, 7 shkronja i ka krijuar vetë. Si mësues dhe si didakt, mendojmë se ka bërë një punë të kujdesshme me shkronjat e reja, që më tepër përdor shenja të vogla, si, shtim ose heqje pikash, shenja didaktike, etj. Për të arritur tek fjalët, autori përdor rrugën tradicionale, duke kaluar nga shkronjat në rrokjet. Kështu fillon me rrokje të thjeshta (*po, jo, si, ku* etj.), në fjalë njërrrokëshe (*mish, det, Reç-emër fshati*) dhe vijon me fjalë, por më tepër se tre-katër dhe me bashkëtingëllore të njëpasnjëshme si: (*shejt, mret*). Shkalla e vështirësisë vjen, duke u rritur, por shembujt janë ndërtuar edhe me vlera edukative. Për përvetësimin e me-

kanizmit të lexim-shkrimit, autori përdor rrugë, që ndiqen edhe sot, leximi i fjalëve me çifte, me ngjashmëri ose nëpërmjet shëmbëllimit, si: *bjeshk(ë)-pjeshk(ë)*; *Pashk(ë)-bashk(ë)*; *kumbull-kungull*, *krue-gzue*, etj. Në abetaren e Daut Efendi Boriçit gjejmë kryesisht fjalë të fjalorit aktiv të moshave dhe mjedisëve të ndryshme shkodrane. Po konkretizojmë me fjalorin, që përdor Boriçi në abetaren e tij, sipas fushave: – nga mjedisi i afërt, – nga mjedisi i largët, – nga bota e kafshëve, – nga bota e bimëve, – pjesë të trurit të njeriut, – mjete pune, – ushqime të njeriut etj.

Studiuesit e ndryshëm kanë dhënë mendime për gjuhën e autorit, vlerat e saj. Botimi i një abetareje shqipe në vitin 1861 (1869) është nga ngjarjet më të shënuara në historinë tonë për disa arsye:

Së pari: Me sa dimë deri tani, kjo është e para abetare shqipe, që botohet në zonën e Veriut. Boriçi, me sa duket, nuk i njihte “Ëvetaret...” e Veqilharxhit. Po ashtu mendoj se nuk ishte në korrent të punës, që sapo kishte bërë ose po bënte Kristoforidhi. Mungesa e ndonjë teksti pararendës ishte në dëm të punës së tij. Abetaret turke, që i njihte mirë, i shërbenin fare pak, për arsye e veçori të tjera, që ka gjuha shqipe.

Së dyti: Abetarja, ndonëse e botuar me alfabet arabo-turk, është me përmbajtje krejtësisht shqiptare dhe me krijime origjinale të autorit. Kjo dëshmon për një hap në fushën e arsimit kombëtar, me bazë, gjuhën shqipe.

Së treti: Duke e parë në një vështrim më të gjerë, vërejmë se në fjalorin e saj përfshihen edhe emra të besimit katolik (Kel) si dhe emra të festave fetare të këtij besimi (Pashkë). Prania e këtyre emrave në një tekst të shkruar nga një klerik-mysliman, por që edhe më vonë do të kishte edhe postin e Kryetarit të Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën, dëshmon për përpjekjet e bëra për ngritjen e rrjetit arsimor pa dallim feje.

Së katërti: Abetarja e Boriçit përshkohet nga fizionomia e edukatës morale e kohës. Mesazhet, që ajo transmeton, i përkasin moralit klasik, të cilat jepen në formë këshillash, shpesh kategorike, si:

Mos rri pa punë, Shko n'shkollë, Mos prito, Ndigjo kshillat e mira, Kur t'flasish mendo, Mos rrej, etj.

Së pesti: Në kuadrin e mësimëve për edukimin atdhetar, arsimor e qytetar, që përmban ky tekst mësimor, është edhe porosia e dhënë në mënyrë urdhërore: “**...xen me shkrue shqip**”. Kjo do të thotë se Daut Efendi Boriçi njih si gjuhë mësimi, gjuhën amtare, shqipen. Kështu në atë kohë, kur Shqipëria ishte e pushtuar, ai vë turqishten, si gjuhë të dytë, duke shkruar: “**...edhe turçen xen**”.

Së fundi: Botimi i një abetareje në gjuhën shqipe, më 1861 ose më 1869, si tekst i litografuar, me tirazh të konsiderueshëm, kopjet e të cilit i gjetëm pas më shumë se një shekulli në disa familje dhe në fondet e bibliotekave, të bindin se në shkollat e trevës së Shkodrës dhe të territoreve, që mbulonte D. Boriçi, si drejtues i vijaletit të Shkodrës, është përdorur abetarja e tij.

KRONIKĚ

Aktivitete e Fakultetit të Studimeve Islame

Mr. Vedat Shabani*

RI-AKREDITIMI INSTITUCIONAL

1 korrik 2024 – 31 dhjetor 2024

Duke pasur parasysh se procesi i ri-akreditimi është një proces, i cili realizohet për çdo tre vjet, theksojmë se ri-akreditimi i fundit institucional dhe i programeve është valid deri më 31.09.2025. FSI, gjegjësisht dekanati i Fakultetit ka bërë të gjitha përgatitjet, siç është përgatitja e Raportit të Vetëvlerësimit (RVV), formimi i komisioneve dhe përgatitjeve të tjera, që ndërlidhen me këtë proces. Këto përgatitje FSI i ka realizuar sipas afateve të parapara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe më 30. 07. 2024 ka aplikuar për Ri-akreditim të Programeve të Studimit dhe Ri-akreditimit Institucional. Pas shqyrtimit të aplikacionit nga AKA, në mbledhjen e datës 23.09.2024, FSI njoftohet se aplikacioni për ri-akreditim institucional është aprovuar. Si rezultat i këtyre angazhimeve, më

* Autori Mr.Vedat Shabani, studimet themelore i ka vazhduar në Fakultetin të Studimeve Islame të Prishtinës, ku edhe diplomoi më 2006 në lëndën e tefsirit. Studimet postdiplomike i ka vazhduar në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Juridik, drejtimi civil dhe më 2013 ka mbrojtur me sukses temën e masterit. Ligjëron lëndën e Drejta Civile në Fakultetin të Studimeve Islame në Prishtinë dhe njëherit është edhe sekretar i Fakultetit. E-Mail: Vedat.Shabani@fsi-edu.ne

21.11.2024, u realizua vizita e ekspertëve ndërkombëtar për Ri-akreditimin Institucional të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

Ekspertë të angazhuar nga ana e Agjencionit të Kosovës për Ri-Akreditim Institucional ishin:

1. Prof. Dr. Melita Kovacevic,
2. Prof. Dr. Magdalena Platis, dhe
3. Ms. Marija Vasilevska në cilësinë e studentit ekspert.

Ndërsa pjesëmarrës në emër të Agjencisë së Kosovës për Akreditim ishin:

Leona Kovaci, dhe Ilirjane Ademaj Ahmeti.

Më 18.12.2024, FSI pranon vendimin nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, përmes të cilit njoftohet se FSI është ri-akredituar në nivel institucional për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028). Ndërsa sa i përket ri-akreditimit të programeve të studimit, të nivelit BA dhe MA, jemi në proces të pritjes së caktimit të vizitës nga AKA.

KONFERENCA SHKENCORE, TRYEZA, LIGJËRATA, TRAJNIME

Në vazhden e aktiviteteve të Fakultetit të Studimeve Islame në fuqishën e ngritjes së kapaciteteve shkencore dhe hulumtuese janë edhe aktivitetet në vijim, të cilat janë realizuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit kalendarik 2024:

Më 17.08.2024, në Fakultetin e Studimeve Islame ishte për vizitë profesori i mirënjohur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Prof. Jonathan AC BROWN, i cili mbajti një ligjëratë para audiencës në sallën e konferencave në FSI me titull: “Trashëgimia e Profetit Muhamed a.s.”.

Më 24.09.2024, në Konferencën Ndërkombëtare me titull: “Drejt Përsosmërisë: “Harmonizimi i Politikave të Sigurimit të Cilësisë me Strategjinë Institucionale dhe angazhimin e Palëve të Interesit”, të organizuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, nga FSI në këtë konferencë morën pjesë Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, Mr. Vedat Shabani dhe Mr.

Muzaqete Kosumi. Kjo konferencë kishte mbledhur së bashku palë të interesit lokal dhe ndërkombëtar të përfshirë në arsimin e lartë, udhëheqës institucionalë, ekspertë, akademikë, hulumtues dhe praktikues të ndryshëm nga fusha e Arsimit të Lartë, së bashku me studentë dhe punëdhënës, për të eksploruar kolektivisht trendët më të fundit, sfidat dhe praktikatat në menaxhimin strategjik të cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Më 26 dhe 27 shtator 2024, në Sarajevë u mbajtën takimet e para të profesorëve të fakulteteve islame nga Ballkani. Nikoqirë të kësaj konference rajonale ishin Drejtoria për Arsim dhe Shkencë e Bashkësisë Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë. Konferenca ishte një mundësi e mirë e shkëmbimit të përvojave, si dhe për një bashkëpunim më intensiv mes fakulteteve islame dhe paraqet një fazë të re në bashkëpunimin akademik dhe shkencor, qoftë në drejtim të shkëmbimit të studentëve e të profesorëve, qoftë edhe të programeve të përbashkëta studimore. Nga FSI në këtë konferencë ishte pjesëmarrëse, Mr. Besa Ismaili Ahmedi.

Më 18.12.2024, Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, realizoi programin për nder të ditës botërore të Gjuhës Arabe. Ky manifestim u hap me lexim të Kuranit, ku më pas fjalën e mori Dekani i Fakultetit, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, si dhe profesorët e Gjuhës Arabe Dr. Sumeja Jonuzi dhe Dr. Ziber Lata. Ky manifestim vazhdoi me një video, e cila trajtoi historikun e përhapjes së Gjuhës Arabe në Kosovë, duke u fokusuar në kontributin e Medresesë Alauddin, Departamentit të Orientalistikës dhe Fakultetit të Studimeve Islame. Programi vazhdoi me poezi, monolog, ilahi, mrekulli gjuhësore dhe mjekësore nga Kurani Famëlartë, si dhe dhjetë vargje nga dhjetë poezitë e varura në Qabe në kohën para Islame.

Vizitat dhe bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar

Më 12. 09. 2024, në FSI ishte për vizitë ish-Kryetari i Dijanetit të Turqisë, tani president i “Instituti i Mendimit Islam” me seli në Ankara, Prof. Dr. Mehmet Görmez. Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i “Memorandumit të Mirëkuptimit” ndërmjet Fakultetit të Studimeve Islame dhe Institutit të Mendimit Islam me seli në Ankara. Ky memorandum, përveç tjerash, do të fokusohet në këto çështje:

1. Organizimin e konferencave, simpoziumeve, forumeve dhe punëtorive të përbashkëta në fushat e mendimit dhe qytetërimit islam;
2. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore për të çuar përpara kauzën e mendimit dhe qytetërimit islam;
3. Botimin e publikimeve të përbashkëta në fusha të përbashkëta dhe me përfitime reciproke;
4. Shkëmbimin e vizitave dhe materialeve me interes të përbashkët, si dhe çështje të tjera;

Më 17. 10. 2024, Dekani i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani, ka pritur në takim ish-sekretarin e Organizatës për Bashkëpunim Islamik, Prof. Dr. Ekmeleddin Ihsanoglu. Dekani Hasani informoi mysafirin me historikun e FSI-së, stafin akademik, programet, të cilat ofron FSI, si dhe me kontingjentin e dorëshkrimeve, të cilat FSI i posedon në bibliotekën e saj. Me këtë rast, Prof. Dr. Ekmeludin Ihsanoglu mbajti një ligjëratë interaktive para stafit akademik të FSI-së, duke përmendur edhe kontributin e Dr. Rexhep Bojës në themelimin dhe mbarëvajtjen e këtij institucioni akademik, si dhe kontributin e tij në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar karshi çështjes së Kosovës.

Nga 28.10.2024 deri më 31.10.2024, një delegacion i Qendrës për Studime të Larta të Islamit, Shkencës dhe Qytetërimit (CASIS), i përbërë nga drejtori i Qendrës, Dr. Mohd Hilmi Bin Ramil, dhe ish-drejtori, tani profesor në këtë qendër, Prof. Asoc. Dr. Khalif Muammar A. Harris, kanë qëndruar në një vizitë katër ditore në FSI. Qëllimi i kësaj vizite ishte funksionalizimi i marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet FSI-së dhe UTM-CASIS, të nënshkruar më 13.12. 2023, e cila ka të bëjë me zhvillimin e

programeve studimore post-diplomike (MA & PhD) të cilat do të organizohen nga FSI në bashkëpunim me Uiversiti Teknologi Malaysia.

Më 05.11.2024, Udhëheqësi i Ekipit të Programit SHER z. Aqim Emurli, Koordinatori Tematik z. Nehat Dervishi dhe znj. Donjeta Ibra, Menaxhere e Zyrës, vizituan Fakultetin e Studimeve Islame (FSI), ku u pritën nga Dekani, Prof. Assoc. Dr. Islam Hasani, prodekani, Prof. Ass. Dr. Lulzim Esati, dhe sekretari, Mr. Vedat Shabani. Gjatë takimit, z. Emurli nënvizoi përkushtimin e Programit SHER për promovimin e qëndrueshmërisë në arsimin e lartë dhe ndërtimin e kapaciteteve kërkimore, që përputhen me Strategjinë e Arsimit të Kosovës 2022-2026.

Më 14.11.2024, një delegacion i lartë nga fusha e arsimit i Turqisë, vizitoi Fakultetin e Studimeve Islame. Delegacioni përbëhej nga: Enver Osman Kaan, kryetar i Akademisë Diyanetit në Ankara; Mehmet Nezir Gul, zëvendës drejtor për arsim dhe edukim në Ministrinë Arsimit të Turqisë; dhe Yashar Keskin, Drejtor i Shkollës Imam Hatip Lisesi “Shehid Omer Halis Demir” në Ankara. Delegacioni shoqërohej nga atasheu i Diyanetit turk në Kosovë, z. Bunyamin Albayrak, si dhe atasheu për çështje të arsimit në Ambasadën e Turqisë në Kosovë, z. Veysel Erdel.

Më 26. 12. 2024, në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës, për vizitë ishte znj. Kelsey De Rinaldis, përfaqësuese e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, e shoqëruar nga znj. Remzije Potoku. Mysafirët u pritën nga dekani i FSI-së, Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani me bashkëpunëtorë, i cili fillimisht u shprehu mirëseardhje në FSI dhe në vazhdim i informoi ato, me të arriturat e fundit të FSI-së, në fushën e Arsimit të Lartë, siç është çështja e ri-akreditimit dhe e bashkëpunimit të FSI-së, me institucionet e tjera, me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë institucion. Qëllimi i vizitës ishte që të prezantojnë programet, të cilat lidhen me fushën e Arsimit të Lartë dhe të cilat Ambasada e SHBA-së, ofron për institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë. Ato inkurajuan menaxhmentin e Fakultetit që të aplikojnë në programet ku vlerësojnë se mund të kenë dobi dhe përfitime prej tyre.

Nënshkrimi i marrëveshjeve & memorandumeve të bashkëpunimit

Më 12.09.2024, u arrit nënshkrimi i “Memorandumit të Mirëkuptimit” ndërmjet Fakultetit të Studimeve Islame dhe Institutit të Mendimit Islam, me seli në Ankara.

Më 24. 12. 2024, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame u realizua nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet “Sustainable Higher Education and Research – SHER”, dhe Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës. Ky Memorandum është një arritje e radhës e Fakultetit të Studimeve Islame, i cili është realizuar pas një sërë takimesh dhe bisedash mes menaxhmentit të FSI-së, dhe Udhëheqësit të Programit SHER, z. Aqim Emurli dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ky Memorandum, përveç mbështetjes për forcimin e kapaciteteve strategjike dhe institucionale dhe përmirësimit të performancën akademike e kërkimore, një fokus të veçantë do ta ketë edhe në mbështetjen e FSI-së, për procesin e rishikimit të statutit, mbështetje në zhvillimin e dokumentit të ri strategjik, mbështetje në harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me statutin e ri dhe nëse është e nevojshme, mbështetja e zhvillimit të rregulloreve të reja, si dhe mbështetje për organizimin e ngjarjeve, seminareve dhe të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve që lidhen me zhvillimin e gjithmbarshëm të FSI-së. SHER është projekt i shtetit të Austrisë, i cili kontribuon për një politikë dhe kornizë ligjore të forcuar dhe të qëndrueshme për Arsimin e Lartë, e që gjithashtu lehtëson arsimin cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, nxit kërkimin dhe inovacionin, ndërkom-bëtarizimin dhe punësimin dhe promovon barazinë gjinore dhe misionin e tretë të universiteteve.

AKTIVITETE TË STUDENTËVE

Më 14. 10. 2024, Unioni Studentor i Fakultetit të Studimeve Islame, së bashku me koordinatoren për marrëdhënie me jashtë, znj. Muzaqete Kosumi, morën pjesë në sesionin informativ të Erasmus+ për të rinjtë, që u mbajt në Europe House Prishtinë. Ky event u organizua për të prezantuar mundësitë e projekteve të zhvillimit të kapaciteteve për të rinjtë dhe programet e lëvizshmërisë Erasmus+.

Më 21.10.2024, studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Studimeve Islame, nën udhëheqjen e profesoreshës së lëndës së tefsirit, Prof. Ass. Dr. Valmire Batatina Krasniqi, nisën hapat e parë drejt ambientimit me çështjen e hulumtimit shkencor. Hulumtimi shkencor është njëra ndër pikat shumë të rëndësishme në fushën e Arsimit të Lartë. Kjo çështje është prej kërkesave të ekspertëve për akreditim. Prandaj vlerësojmë se është një hap shumë me rëndësi përmbushja e kësaj pike nga profesorët dhe studentët tanë. Ky hulumtim do të përfshijë studimin e librave të vjetër të tefsirit, të cilët gjenden në bibliotekën e FSI-së, të shkruar në gjuhën arabe dhe osmane dhe njohjen më të thellë me to. Do të shqyrtohet periodha kur janë shkruar, autori, vendi i botimit, shtëpia botuese dhe të dhëna të tjera, që lidhen me librat.